



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

***“AUDITIM FINANCIAR DHE
PËRPUTHSHMËRIE (Prokurimet) NË
BASHKINË MAT”***

Tiranë 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

]

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	Përmbledhje Ekzekutive	18-21
II	Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit	03-17
III	Hyrja	22-26
IV	Përshkrimi i Auditimit	27-132
V	Gjetjet dhe Rekomandimet	133-144
VI	Anekse	145-222



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standartet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.
AK	Autoritet Kontraktor
LPP	Ligji për Prokurimin Publik



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.a. Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe monitorimi i tyre nga auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullave të institucionit dhe parimeve për një qeverisje të mirë në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Mat dhe ligjit nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe zbatimi i procedurave të prokurimit publik dhe të kontratave të lidhura. Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, aktrakordimet me thesarin duke shkarkuar 72 transaksione financiare nda data baze i thesarit, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur tre zonat e llogarive, 600 “paga”, 602 “shpenzime operative” dhe 230- 231 “investime, si dhe 20 procedura prokurimi, me vlerë 270,335,715 lekë ose 88% të fondit limit të prokuruar për periudhën objekt auditimi.

I.b. Përmbledhje e gjetjeve kryesore.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Në Bashkinë Mat gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregojnë se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen deri në një farë mase. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nga ku rezultoi se:</p> <p>Është hartuar Rregullorja e funksionimit të Njesisë, pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh.</p> <p>Nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut sipas nenit 21. Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.</p> <p>Në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprime me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njesisë.</p>	26-27	E LARTË.	<p>Nga Bashkia Mat të merren masa për njohjen nga menaxhimi dhe stafi i institucionit i MFK dhe komponentëve të tij, për ngritjen e një strategjie të risqeve e përcaktim të kordinatorit të riskut me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njesisë</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
2	NJABnë ushtrimin dhe realizimin e funksionit të saj është bazuar në ligjin organik të AB, në MAB dhe në standardet e auditimit, por pavarësisht kësaj në auditimet e ushtruara nuk ka vlerësuar si duhet riskun në fushat e auditimit që janë me risk më të lartë si fusha e prokurimeve, planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, e planifikim-zhvillimit të territorit dhe e administrim-menaxhim i aseteve pronë e bashkisë për të cilat nuk janë zhvilluar auditime të thelluara. Gjithashtu nuk ka nxjerrje përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në të gjitha rastet, nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer në kundërshtim me kërkesat e MAB i miratuar me UMF nr. 100, datë 25.10.2016, Kap. II, pika 10.	28-29	I MESHËM	Nga Bashkia Mat dhe veçanërisht nga Titullari i Njësisë të Vetqeverisjes Vendore, të merren masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për cdo auditim.
3	Karta e Auditimit të NjAB nuk është përgatitur dhe miratuar tek titullari i Bashkisë Mat, në kundërshtim me nenin nr. 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, ku përcaktohet që “Karta e Auditimit” është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, në të cilën përcaktohen statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm”, si dhe në kundërshtim me pikën 2.5, Kapitulli II të MAB.	28-29	E LARTË	Nga Bashkia Mat, strukturat përgjegjëse, të hartohet “Karta e Auditit”, nga përgjegjësi i NjAB, dhe të miratohet ajo tek Kryetari i Bashkisë Mat.
4	Plani Strategjik edhe pse është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2017-2019, ai nuk është përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6. Planifikimet vjetore të auditimeve për vitin 2017, dhe 2018 edhe pse janë përgatitur rregullisht, ata nuk janë përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.2 Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2017 dhe 2018, dhe pasqyrat shoqëruese, janë dërguar në afat, por pjesa përshkruese e raportit nuk është përgatitur sipas standardeve që përcakton MAB, Kapitulli III, pika 3.6. Struktura e projektraportit dhe e raportit përfundimtar të auditimit nuk është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur nga MAB në Kapitullin IV, pika 4.1.12, Hapi 11.	28-29	E LARTË	Nga Bashkia Mat, Plani strategjik, planifikimi vjetor, raportimi vjetor, dhe projekt raportit, e raportit përfundimtar, si dhe gjithë dokumentacioni tjetër i nevojshëm në procesin auditues të NjAB, të përpilohen në përputhje me MAB,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
5	<p>Nuk janë çelur dosjet e përhershme për çdo njësi publike të audituar, për ti shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.</p> <p>Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësisë publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, në kundërshtim me ligjin 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.</p>	28-29	E LARTË	<p>Nga Bashkia Mat, NjAB të çelen dosjet e përhershme për çdo subjekt të audituar, duke i pasuruar ato me materiale nga auditimet e reja, me qëllim që kjo ti shërbej auditimeve pasardhëse të këtij subjekti.</p> <p>Pas përfundimit të auditimit të brendshëm të subjekteve publike, të kryhet inventarizimi i dosjes koherente për çdo auditim, dhe të arkivohen ato në zyrën e arkivtë, në përputhje me ligjin 9154, datë 06.11.2003.</p>
6	<p>Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” pika 40, dhe ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19.</p> <p>Në këtë Njësi të Qeverisjes Vendore, nuk aplikohen programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar.</p> <p>Nga auditimi i dokumentacionit nuk rezultojnë jetë nxjerrë urdhër nga titullari i njësisë së qeverisjes vendore për të caktuar koordinatorin e riskut. Nga intervistimi i Zj. D. K., me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës në bashkinë Mat, pranon se ajo e kryente këtë detyrë, por prej saj nuk na u paraqitën të dhëna lidhur me identifikimin dhe menaxhimin e riskut.</p> <p>Nuk ka akt të titullarit të njësisë për miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut për bashkinë Mat, veprim që bie në kundërshtim me nenin 21 pika 2, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.</p> <p>Nuk rezultojnë asnjë akt tjetër nxjerr nga titullari i njësisë për përgatitjen dhe ndjekjen në vazhdimësi të manualit të proceseve të punës për njësinë vendore, për miratimin e gjurmëve të auditimit, veprim që bie në kundërshtim me nenin 16 pika 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010.</p> <p>Nga ana e titullarit të Bashkisë Mat, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, por njësitë organizative kanë të përcaktuar detyrat e tyre në rregulloren e funksionimit të brendshëm të institucionit.</p> <p>GMS, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, kërkesë e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr 8 dt. 29.3.2012 “Procedurat e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V.</p>	28-29	E LARTË	<p>Titullari i njësisë së qeverisjes vendore, ose nëpërmjet nëpunësit autorizues, të hartojë dhe miratojë akte të brendshme administrative të nevojshme për funksionimin normal të menaxhimit financiar dhe kontrollit, brenda kuadrit rregullator të Ministrisë së Financave, si dhe të monitorohet funksionimi i GMS në vazhdimësi.</p> <p>Nga Grupi Menaxhimit Strategjik, të hartohet e miratohet Plani Strategjik në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr 8 dt. 29.3.2012 “Procedurat e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
7	<p>Z. L. Xh., me arsim të lartë, i diplomuar në Universitetin Bujqësor Tirane në vitin 1981, në degën “Ekonomist Kontabël”, është rekrutuar me Vendimin nr. 327, datë 01.06.2016, dhe është “komanduar” në detyrën e Audituesit pranë Sektorit të Auditit të Brendshëm, pa ju nënshtruar procesit të konkurrimit, dhe pas kësaj me Vendim të kryetarit të bashkisë nr. 576, datë 26.09.2016 është komanduar (transferuar përkohësisht) në detyrën e Përgjegjës të Njësisë AB Bashkia Mat, pa qen i pajisur me certifikatën e audituesit, (edhe aktualisht rezulton pa certifikatë). Veprim që bie në kundërshtim me nenin 22, pika 1, të ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 i ndryshuar, si dhe duke mos respektuar nenin 48, pika 1, germën “a”, të po këtij ligji, si dhe në kundërshtim me pikën 3, paragrafi II, të VKM nr. 83, datë 03.02.2016.</p> <p>Zj. F. Th., me arsim të lartë, diplomuar në Universitetin e Tiranës në vitin 1984, në specialitetin Financë, është emëruar në detyrën e audituesit të NJAB në Bashkinë Mat me Vendim të kryetarit të bashkisë nr. 407, datë 06.07.2016, duke qenë e pa pajisur me certifikatën e audituesit, dhe brenda periudhës 2 vjeçare nuk është pajisur me të, veprim ky që bie në kundërshtim me nenin nr. 11, pika 2, germa “ç”, e Ligjit nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”.</p>	28-29	E LARTË	<p>Z. L. Xh., i caktuar përkohësisht me detyrën e Shefit të Sektorit të Auditit të Brendshëm, të largohet nga kjo detyrë, sepse në kundërshtim me nenin 48 pika 1, germën “a”, të ligjit nr. 152, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i ka kaluar të gjitha afatet ligjore për të drejtuar këtë sektor si “punonjës i caktuar në detyrë përkohësisht”.</p> <p>Zj. F. Th. aktualisht me detyrën e audituesit në NJAB, të transferohet nga kjo detyrë, për shkak se nuk është certifikuar si e tillë nga organet kompetente, në kundërshtim me nenin nr. 11, pika 2, germa “ç”, e Ligjit nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik”</p>
8	<p>Në pasqyrat financiare, lidhur me përllogaritjen e kuotave të amortizimit u konstatua se, aktivet që i përkasin llog.(209); “Amortizimi aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara” pasqyrohet në vlerën e akumuluar kontabile (-5,875,991 lekë) me rritje periudha raportuese (-3,257,743 lekë) e llog.(219); “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” pasqyrohet në vlerën e akumuluar kontabile (-614,577,386 lekë) me rritje periudha raportuese për (-92,489,153 lekë). Në njësinë publike bashkia Mat, të dhënat kontabile të evidentuara në aktiv të pasqyrës financiare evidentojnë se; amortizimi vjetor i përllogaritur për aktive (të trupëzuara dhe patrupëzuara) është rritur me shumën -95,746,896 lekë (-3257743) dhe (-92489153), ndërsa në PSH (Formati nr.3/1), Klasa (68).III-“Kuota e amortizimit dhe shuma të parashikuara”, kjo llogari pasqyrohet me gjendje 0 (Zero), në këto kushte shumat e amortizimit vjetor të përllogaritura nuk janë kontabilizuar dhe nuk janë të evidentuara në PSH</p>	33-38	I MESHËM	<p>Njësa publike Bashkia Mat, Sektori financës e konatabilitetit të marr masa për përllogaritjen e saktë të testeve e normave të amortizimit dhe kontabilizimin që i përket aktive të trupëzuara dhe patrupëzuara, deri në momentin aktual, duke paraqitur si shpenzim në pasqyra e shpenzimeve me sistemin kontabël në mbylljen e pasqyrave financiare periudha raportuese 2018 e në vazhdim.</p>
9	<p>Në pasqyrat financiare llog.(202) “Studime e projekte” në vlerë kontabile 32,577,436 lekë e analizuar për 35 projekte ndërtimore e 3 studime të financuara në vite të mbartuara nga (ish/Komunat) të administruara në njësi publike Bashkia Mat u konstatua se, administrimi projekteve e studimeve të investuara nuk janë dokumentuar nëpërmjet procesit të inventarizimit fizik të tyre, në mospërputhje me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe</p>	33-38	I MESHËM	<p>Njësi publike Bashkia Mat, Sektori i financës e konatabilitetit të marr masa me qëllim që të verifikohet saktësia llog.(202) “Studime e projekte” dhe të administrohet nëpërmjet procesit të inventarizimit fizik gjendja dhe vlera e projekteve e studimeve të financuara në vite.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	<i>pasqyrat financiare</i> ” i ndryshuar, neni 7, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ”, Kap (III), pikat 26, 35/b, 35/c dhe Kap (IV), pika 73 dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 “ <i>Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël</i> ”, Kap (II), pika 1.			
10	Në pasqyrat financiare llog.(211) “ <i>Pyje, kullota, plantacione</i> ” vlera kontabile 12,303,824 lekë pa ndryshuar përfaqëson vlerën e ekonomivënë(<i>pyllëzime arrose, pyje e kullota, sisteme gjelbërimiti</i>) dhe llog.(212) “ <i>Ndërtime konstruksione</i> ” vlera kontabile 975,556,334 lekë të transferuar në pronësitë në njësi të publike bashkia Mat, nga (<i>ish/Komuna</i>) në kuadër të reformës administrative territoriale u konstatua se; zyra e financës e kontabilitetit për këto astet nuk disponon regjistra, kartela llogarie e dokumentat kontabile me të dhëna të domosdoshme mbi objektet me qëllim të evidentohen të dhënat e nevojshme si; (<i>viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria dhe projekti objektit ndërtimor, etj</i>), asete të cilat nuk janë regjistruar në ZRPP Burrel në pronësitë në njësi të publike bashkia Mat, ndërsa për periudhën raportuese nuk është kryer inventarizimi fizik dhe këto kushte pasqyrimi në aktiv të bilancit pa të dhëna kontabile e dokumenta justifikuese, janë në mospërputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “ <i>Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël</i> ” dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “ <i>Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial</i> ”, Kreu (V); (VI) pika 2, Kreu (VII) pika 1; 2; ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “ <i>Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare</i> ” i ndryshuar, neni 7, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “ <i>Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik</i> ”, Kap (III), pikat 26, 35/b, 35/c dhe Kap (IV), pika 73 dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 “ <i>Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël</i> ” Kap (II), pika 1.	33-38	I LARTË	Njësia publike Bashkia Mat, Sektori i financës dhe kontabilitetit të marr masa me qëllim të saktësohen llog.(211) dhe llog.(212) me qëllim justifikimi veprimeve kontabile me dokumenta të nevojshme justifikuese tekniko-ligjore për regjistrimin në ZRPP Burrel në pronësi të njësisë publike Bashkia Mat dhe pasqyrimin me dokumenta ligjor të këtyre aseteve.
11	Në pasqyrat financiare me analizë në aktiv llog.(401-408) “ <i>Furnitor e llogari të lidhura me to</i> ” përfaqëson detyrime të pa likuiduara në kohë për furnizime, shërbime e punime, për periudhat raportuese 2017 dhe 2018, detyrime të cilat duhet të likujdohen për efekt e brenda periudhës raportuese buxhetore 2018 e mbrrapa në buxheti periudhës 2019 për 56 subjekte vlera 13,581,247 lekë e llog.(467) “ <i>Kreditor të ndryshëm</i> ” për detyrime të lindura nga 9 subjekte të cilët kanë fituar vendim gjykatave në vite me formë të prerë deri në datë 31.12.2018 vlera 48,587,939 lekë, në mospërputhje me UMF (<i>plotësues</i>) nr.02, datë 10.01.2018 “ <i>Për buxhetin e vitit 2018</i> ”, pikat 82-91 “ <i>Detyrime të prapambetura Njësive të Vetëqeverisjes Vendore</i> ” e UMF (<i>plotësues</i>) nr.01, datë 17.01.2019 “ <i>Për buxhetin e vitit 2019</i> ”, pikat 106 deri 110 “ <i>Detyrime të prapambetura Njësive të Vetëqeverisjes</i>	33-38	I LARTË	Njësia publike Bashkia Mat, Sektori Financë, bazuar në UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “ <i>Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura</i> ” dhe UMF (<i>plotësues</i>) nr. 02, datë 10.01.2018 “ <i>Për buxhetin e vitit 2018</i> ”, pika 82-91 “ <i>Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore</i> ”, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit të .Bashkisë, material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për likuidim, duke zbatuar për të gjitha radhën e pagesave vlera totale prej 48,587,939 lekë e rakorduar kjo shumë me pasqyrën e dërguar në Ministrinë e Financave me shkresë përkatëse, si dhe të nxirret përgjegjësia për to.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	<i>Vendore”, pika 116 deri 117 “Raportimi detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.</i>			
12	<p>Për vitin 2017, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 83,780,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 70,833,337 lekë ose 85%, me mosrealizim në shumën 12,946,663 lekë.</p> <p>Për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 92,990,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 59,879,235 lekë ose 64%, me mosrealizim në vlerën 33,110,765 lekë.</p> <p>Në fund të vitit 2018 rezultojnë debitorë për taksat dhe tarifa vendore 287 subjekte të biznesit të vogël dhe 51 biznesit të madh, llogaritet <i>mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 23,675,418 lekë.</i></p> <p>Taksa e ndërtesës për objektet që do të zhvillojnë biznes për vitin 2017, është planifikuar në vlerën 1,490,280 lekë dhe është realizuar në vlerën 381,980 lekë ose 25%, ndërsa për vitin 2018, është planifikuar në vlerën 1,378,332 lekë dhe është arkëtuar 936,475 lekë ose 67% e planit vjetor.</p> <p>Për vitin 2017, kanë ushtruar aktivitet 490 subjekte të biznesit të vogël dhe 100 subjekte të biznesit të madh, për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksat e tarifave vendore, ndërsa për vitin 2018, kanë ushtruar aktivitet 550 subjekte të biznesit të vogël dhe 134 subjekte të biznesit të madh për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksat e tarifave vendore.</p> <p>Janë evidentuar 16 subjekte të cilat ushtrojnë veprimtari biznesi pa qenë të rregjistruar në QKR. Nga mosrregjistrimi i këtyre subjekteve llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë në vlerën 185,238 lekë.</p>	39-46	I LARTË	<p>Bashkia Mat, nëpërmjet Drejtorisë së Tatimit Taksave e Tarifave të marrë masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore të pa arkëtuara në vlerën 89,881,808 lekë për sektorin e biznesit dhe të vlerës 8,317,400 lekë nga familjarët, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar. Nga Drejtoria e Taksave të nxirren njoftim vlerësimet tatimore dhe për arkëtimin e detyrimeve të mësipërme të ndiqen rrugët e mëposhtme:</p> <p>a) T'u ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka.</p> <p>b) T'i ridërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme).</p> <p>c) Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të fillojë llogaritja e gjobës në masën 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë (gjobë).</p> <p>ç) Në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet e akumuluar në vite, nga ana e Bashkisë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike) të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</p> <p>d) Drejtoria e Taksave në Bashkinë Mat të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të familjarëve, taksës së tokës nga fermerët. Në zbatim të udhëzimit plotësues të MF nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë dhe bizneset me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga KB, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimi me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifave etj.</p> <p>Drejtoria e Tatimit Taksave në Bashkinë Mat të marrë masa, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore duke kërkuar regjistrimin e 16 subjekteve në QKR dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e detyrimeve në vlerën 185,238</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
13	<p>Në Bashkinë Mat në fund të vitit 2018 rezultuan debitorë për taksa dhe tarifa vendore për 51 subjekte (b.Madh) në vlerën 11,355,573 lekë dhe 287 subjekte (b.Vogël) në vlerën 12,319,845 lekë. Në fund të vitit 2018 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 287 subjekte të biznesit të vogël dhe 51 biznesit të madh, llogaritet <i>mungesë të ardhurash me efekt negative në vlerën 23,675,418 lekë.</i></p> <p>Drejtoria e Tatim Taksave për arkëtimin e debitorëve nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenin 90, 91, të ligjit nr. 9920 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve.</p>	39-46	I LARTË	<p>lekë, të cilët kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar.</p> <p>Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Mat të marrë masat, për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 51 subjekte (b.Madh) në vlerën 11,355,573 lekë dhe 287 subjekte (b.Vogël) në vlerën 12,319,845 lekë bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920.</p> <p>a - Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.</p> <p>b - Të dërgojë në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.</p> <p>c - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.</p> <p>d-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative të bëhet kallëzim penal.</p> <p>b - Zyra e taksave dhe tarifave vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të kryej rakordim me të gjitha subjektet që zhvillojnë në territorin e saj, aktivitet minerar dhe veçanërisht fabrika pasurimi, për përcaktimin e saktë të detyrimeve të pa paguara që kanë ndaj Bashkisë, si edhe ndaj ish komunave, lidhur me taksat dhe tarifat vendore. Pas këtij rakordimi të hartoj listën përfundimtare të debitorëve për këto subjekte dhe të marrë masa për arkëtimin e tyre.</p>
14	<p>Kanë kryer aktivitet 7 (shtatë) subjekte private për “shfrytëzim fondi pyjor dhe kullor ” dhe nuk kanë paguar detyrimet në shumën 2,947,905 lekë, e cila do të konsiderohet mungesë të ardhurash me efekt negativ. Konkretisht:</p> <p>1. Subjekti “T. A. Sha (Ulëz)”, për kontratën e Qerasën.618 rep dhe nr. 44 kol, datë 04.09.2009, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullor për ndërtim të stacionit të</p>	39-46	I LARTË	<p>Bashkia Mat të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktor ku kanë kryer aktivitet subjekte private për “shfrytëzim fondi pyjor dhe kullor ” dhe nuk kanë paguar detyrimet në shumën 2,947,905 lekë.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>antenave, nga ku ka rezultuar se nuk ka likuiduar detyrimet e vitit që ka lenë KLSH në shumën prej, gjithsej në vlerën 78,445lekë.</p> <p>2. Subjekti “A. Sha (Ulëz)” për Kontratën e Qerasë nr ska, datë 19.12.2008, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor për ndërtim të stacionit të antenave, nga ku ka rezultuar se nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2017-2018 në shumën prej, gjithsej në vlerën 560,000lekë.</p> <p>3. Subjekti “A. Sha (Lis)” për Kontratën e Qerasë nr.3029 rep dhe nr.1024 kol, datë 07.09.2009, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor, për ndërtim të stacionit të antenave, nga ku ka rezultuar se nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2018, në shumën prej, gjithsej në vlerën 170,000lekë.</p> <p>4. Subjekti “K. I. Sha (Ulëz)” për Kontratën e Qerasë nr. ska, datë 05.08.2012, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor për ndërtim të linjave të tensionit të lartë, nga ku ka rezultuar se nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2018-2019 në shumën prej, gjithsej në vlerën 300,000 lekë.</p> <p>5. Subjekti “V. A. Sha (Lis)” për Kontratën e Qerasë nr.1865 Prot, datë 23.07.2018, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor për ndërtim të stacionit të antenave, nga ku ka rezultuar se nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2018 në shumën prej, gjithsej në vlerën 300,000 lekë.</p> <p>6. Subjekti “P. E. Shpk” për Kontratën e Qerasë nr.ska, datë 06.05.2013, 16.05.2013, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor për ndërtim hidrocentrali, nga ku ka rezultuar se subjekti “P. E. shpk” nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2018, në shumën prej, gjithsej në vlerën 830,500lekë.</p> <p>7. Subjekti “S.'G.M. Shpk” për Kontratën e Qerasë nr.ska, datë 22.08.2014, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor, për ndërtim hidrocentrali, nga ku ka rezultuar se subjekti “S.'G.M.Shpk” nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2017, 2018, në shumën prej, gjithsej në vlerën 708,960lekë.</p>			
15	<p>Për vitet 2017-2018 objektet ndërtimore të ndara sipas kategorive të cilat janë pajisur me leje legalizimi nga Drejtoria Rajonale ALUIZNI Mat, për të cilat është përlogaritur taksa ndikimit në infrastrukture nga D.P.T.SH.I.P janë 119 objekte banimi, 26 objekte social-ekonomike dhe 6 objekte të kombinuara.fiskale për vitin 2018”. Për vitin 2017, kanë rezultuar 46 shkresa për ndërtimet informale në territorin e Bashkisë nga të cilat për vitin 2017 kanë paguar 27 persona në</p>	39-46	I LARTË	<p>Nga Bashkia Mat, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe në bashkëpunim me ALUIZNI-n Mat dhe ZVRPP Mat të merren masa të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar si dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së infrastrukturës.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>vlerën 858,170 lekë. Diferenca prej 19 personave janë njoftuar me shkresë zyrtare por nuk kanë bërë pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë.</p> <p>Për vitin 2018 kanë rezultuar proceduar 105 shkresa dhe është përlogaritur taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi për ndërtimet informale nga të cilat për vitin 2018 kanë paguar 32 persona në vlerën 985,331 lekë. Diferenca prej 73 personave janë njoftuar me shkresë zyrtare por nuk kanë bërë pagesat e TNI.</p>			
16	<p>Bashkia Mat, ka dërguar në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësorin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, pa informacionin e Drejtorive vartëse, ndërsa sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, në kundërshtim me pikën 15, germa b, të UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”.</p>	39-46	I LARTË	<p>Bashkia Mat të marrë masa, të dërgoj në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësorin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe informacionin e Drejtorive vartëse.</p>
17	<p>Drejtoria e Financës, sistemi kompjuterik nuk e ka të certifikuar nga kompani e licencuara për ruajtjen e të dhënave, pasi sistemi kompjuterik nuk mbron asetet dhe nuk ruan integritetin e të dhënave. Mos certifikimi i sistemit kompjuterik për mbrojtjen e të dhënave dhe të integritetit të tyre, vjen në papajtueshmëri me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”.</p>	39-46	I LARTË	<p>Drejtoria e Financës të marrë masa, të certifikoj sistemin kompjuterik nga kompani të licencuara për ruajtjen e të dhënave, të mbroj sistemin kompjuterik dhe asetet duke ruajtur integritetin e të dhënave, financiar dhe çdo informacion origjinal, plotësues dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike.</p>
18	<p>Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Mat, nuk ka hapur regjistra për abonentët familjarë, mungojnë njoftim detyrimi për taksat dhe tarifrat vendore, për evidentimin e numrit të familjeve që duhet të paguajnë, veprim në papajtueshmëri me pikën 7 neni 3, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar.</p>	39-46	I LARTË	<p>Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Mat të marrë masa, për krijimin e regjistrit elektronik me të dhëna, për hapjen e kartelave individuale të abonentëve familjarë, hartimin e regjistrit themelorë të abonentët familjarë për taksat e tarifrat vendore, duke evidentuar detyrimet për çdo taksë.</p>
19	<p>Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion Shkolla 31 Korriku Burrel”, për vlerën prej 61,819,333 lekë, me BOE të shpallur fitues “V. N. I.S. dhe “N. shpk”, për vlerën prej 61,580,780 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 238,500 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE dhe 1 BOE është shpallur fituese BOE e cila nuk plotësonte kriteret e veçantë, konkretisht pikën 5.3 të DST pasi nga dy teknike ndërtimi vetëm</p>	46-119	I LARTË	<p>Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën 61,580,780 lekë, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>njëri ka certifikatë të IQT dhe nga tre manovratë asnjëri nuk ka certifikatë të IQT; pikën 5.5 pasi nga 4 elektricitetë 2 nuk kanë certifikatë nga IQT, po ashtu nga 4 hidraulikë dy janë pa certifikatë nga IQT, dy saldatorët janë pa certifikatë nga IQT, një karpentier dhe 4 specialistë janë po ashtu pa certifikatë nga IQT; pikën 8.3 pasi nuk ka paraqitur certifikatën e normativitetit EN 13830:2003; pikën 9.3 për certifikatën EN 605981:2008+A11:2009, pasi rezulton në gjuhën franceze dhe e pa përkthyer si dhe me vulë të palexueshme noterimi; pikën 10.3 dhe 10.4 lidhur me plotësimin e dokumentit për kaldajën, direktiva 97/23/EC, si dhe për servisin e autorizuar, pasi dokumentet janë në gjuhën angleze, gjermane dhe turke, të pa përkthyer; pikën 12.4 nga ku rezulton se ka paraqitur kontratë për prova laboratorike dhe dokumente teknike në gjuhën italiane, të pa përkthyer; pikën 6 të DST lidhur me numrin e fuqisë punëtore për vitin 2014, 70, vitin 2015 90 dhe vitin 2016, 11, si dhe janar-qershor 2017 110 punonjës, pasi për vitet 2014-2016, asnjëri nga bashkimi i operatorëve nuk plotëson këtë kriter, por vetëm të bashkuar, kur kriter synon bashkimin e kapaciteteve dhe eksperiencave në punë dhe nuk mund të konsiderohet bashkimi i kapaciteteve njerëzore për vitet e shkuara, por vetëm për vitin 2017.</p> <p>Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE “V. N. I.S. dhe “N. shpk” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën 61,819,330 lekë, veprime në pajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshua.</p>			<p>nuk çënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.</p>
20	<p>Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i kanalit vaditës, fshati Derjan (i pjesshëm)”, për vlerën prej 16,666,666 lekë, me BOE të shpallur fitues “V. N. I.S. dhe “N” shpk, për vlerën prej 16,458,763 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 207,903 lekë, procedurë në të cilën kanë marrë pjesë 4 OE dhe 2 BOE është s’kualifikuar me të drejtë për mungesë dokumentacioni OE me ofertë ekonomike më të ulët “B.-I.” shpk, për vlerën prej 12,515,490 lekë dhe është kualifikuar BOE që nuk plotëson po të njëjtin kriter si dhe OE i skualifikuar: Pika 2.3.3, për numrin mesatar të punonjësve prej 75 nga janar 2014 deri më shkurt 2017. Po ashtu kur BOE i shpallur fitues nuk</p>	46-119	ILARTË	<p>Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për zhdëmtimin e vlerës prej 2,743,534 lekë, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit (<i>Titullari i AK z. N. R. dhe anëtarët e KVO z. J. K. dhe z. E. Ç.</i>), duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>plotëson as kriteret 2.3.2/3, pasi certifikata ISO 1452-1:2009 është e papërkthyer në gjyhën shqipe; Pika 2.3.4, lidhur me mjekun e përgjithshëm pasi mjeku i paraqitur ka leje individuale për ushtrim profesioni me datë të paverifikueshme duke mos vërtetuar afatin e fillimit dhe mbarimit të saj; Pika 2.3.4, lidhur me inxhinierin e ndërtimit i cili rezulton me dëshmi të sigurimit teknik jashtë afave të vleshmërisë ndërsa për inxhinierët e tjerë u mungon dëshmia e sigurimit; Pika 12.3.8, lidhur me makinerinë për shtrim betoni, pasi nuk rezulton të ketë paraqitur një pajisje të tillë; si dhe pikën 2.3.3 pasi nuk plotëson numrin mesatar të punonjësve (75) Në këto kushte, KVO duhet ta kishte s’kualifikuar këtë operator ekonomik dhe duhet të kishte shpallur fitues OE “B.-I.” shpk</p> <p>Mos shpallje fitues i OE me ofertë më të ulët apo edhe mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE “V. N. I.S. dhe “N.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen Standarde të Tenderit, si dhe nga s’kualifikimi i OE “B.-I.” shpk, me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 13,715,229 lekë, duke shkaktuar përdorim e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 2,743,534 lekë (diferencë ndërmjet ofertës fituese dhe asaj të s’kualifikuar), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014.</p>			
21	<p>Në procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbimi i Patrimin në Bashkinë Mat”, për 5 vjet dhe për vlerën prej 73,385,319 lekë, me OE të shpallur fitues “I. C.” shpk, për vlerën prej 71,400,669 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 1.984,620 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, konkretisht pikën 3 të DST pasi nuk ka paraqitur asnjë kontratë punësimi për inxhinier kimist; pikën 4 të DST pasi nuk ka paraqitur asnjë kontratë të vlefshme pune për mjekun e përgjithshëm; pikën 9 të DST pasi nuk ka paraqitur certifikatë ISO 50001:2012, pikën 10 të DST pasi nuk ka paraqitur certifikatën ISO 3834-2:2015; pikën 13/4 lidhur me mjetin teknologjik për pastrimin e rrugëve, pasi nga dokumenti fotografik mjetit i mungon fshesa qendrore rul; si dhe pikën 15 pasai nuk ka paraqitur dokumentacion mbi diponueshmërinë e 100 kontenierëve Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE “I. C.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe</p>	46-119	I LARTË	<p>Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën 71,400,669 lekë, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	efektivitet, në vlerën 71,400,669 lekë , veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014.			
22	<p>Në procedurën e prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i veprave të marrjes të kanalit ujitës batër e madhe”, për vlerën prej 7,025,000 lekë, me BOE të shpallur fitues “R. & F.” shpk, për vlerën prej 5,995,984 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 1.069,016 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 1BOE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, konkretisht pikën 2.3.2 të DST pasi nuk ka paraqitur asnjë punonjës me dëshmi kualifikimi të lëshuar nga IQT; pikën 2.3.5 të DST, pasi nuk ka paraqitur mjetin fadromë me goma, eskavator i kukuar me çekiç pneumatik rezulton pa një të tillë, për 2 kamionat përvec lejeve të qarkullimit mungojnë dokumentet e tjera provuese; për dy autobetoniere është paraqitur kontratë qirajë për mjete të treguara në shtetin e Kosovës, por u mungon vula apostile.</p> <p>Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE “R. & F.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën 5,995,984 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014.</p>	46-119	I LARTË	Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën 5,995,984 lekë , duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.
23	<p>Në procedurën e prokurimit me objekt: “Mirëmbajtje kanale vaditëse”, për vlerën prej 4,056,545 lekë, me OE të shpallur fitues “N.” shpk, për vlerën prej 3,898,480 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 158,065 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 1 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, konkretisht pikën 2.3 të DST pasi të dy inxhinierët nuk kanë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik; pikën 4 të DST, pasi dy kamionat e paraqitur e kanë kapacitetin mbi 15 ton kur janë kërkuar deri në 15.</p> <p>Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE “N.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën 3,898,480 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014.</p>	46-119	I LARTË	Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën 3,898,480 lekë , duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.
24	<p>Në procedurën e prokurimit me objekt: “Punime rrugore Lagjia Drita”, për vlerën prej 13,190,233 lekë, me OE të shpallur fitues “E.” shpk, për vlerën prej 13,098,531 lekë,</p>	46-119	I LARTË	Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>ose më pak se fondi limit për shumën 91,702 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, konkretisht pikën 4.4 të DST, pasi automakinistit i ka skaduar dëshmia e aftësisë profesionale; pikën 7 të DST pasi nuk është paraqitur një eskavator me zinxhirë nga dy të kërkuar, si dhe se kamioni me targa AA417IS i ka skaduar certifikata për transport mallrash si dhe polica e sigurimit.</p> <p>Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE “E.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën 13,098,531 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014.</p>			<p>mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën 13,098,531 lekë, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.</p>
25	<p>Në procedurën e prokurimit me objekt: “Ujësjiellësi i fshatit German”, për vlerën prej 8,956,950 lekë, me OE të shpallur fitues “N.” shpk, për vlerën prej 8,834,175 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 122,775 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 1 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, konkretisht pikën 2.3.11 të DST, pasi ka dorëzuar dokumentacionin për PE 100 RC HDP, në gjuhë të huaj dhe të papërkthyer.</p> <p>Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE “N.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën 8,834,175 lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014.</p>	46-119	I LARTË	<p>Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën 8,834,175 lekë, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.</p>
26	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës, i dokumentacionit të administruar në dosjen teknike me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku”, të lidhur ndërmjet AK Bashkisë Mat dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V. N. I.S” & “N.” SHPK, u konstatua se: Për zërin “Furnizim dhe instalim kaldajë për ngrohje me ujë me lendë djegëse peletkomplet me instrumentat matës dhe të kontrollit të parametrave të ujit të ngrohtë, Q niminale 250,000 kilokalori/orë, përfshirë montimin e të gjithë tubacioneve dhe pajisjeve deri në dalje nga dhoma e djegjes” është llogaritur me TVSH, duke i konsideruar punime ndërtimi punimet e furnizimit dhe instalimit të pajisjeve dhe për pasojë, janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve në vlerën 480,000 lekë si rrjedhojë e</p>	120-132	I LARTË	<p>Nga Bashkia Mat të merren masa për arkëtimin nga OE “V. N. I.S” & “N.” Shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 480,000 lekë pa TVSH, të përfutur tepër si rrjedhojë e përfshirjes së TVSH-së së pajisjeve në situacionin e punimeve për kontratën me objekt “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku”.</p> <p>Nga Bashkia Mat, të merren masa për arkëtimin nga BOE “V. N. I.S” & “N.” Shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës 350,496 lekë pa TVSH, të përfutur tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku”.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Ref. Raportin Përfund	Rëndësia	Rekomandimi
	<p>përfshirjes së TVSH-së së pajisjeve në situacionin e punimeve për kontratën bazë, vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.</p> <p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku”, realizuar nga BOE “V. N. I.S” & “N” SHPK, u konstatua se zëri i punimeve “(3.620) Shtresë pllaka betoni C 16/20 t=6 cm, oborri” është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën 350,496 lekë pa TVSH duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.</p>			
27	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës Derjan”, realizuar nga BOE “V. N. I.S & N.” SHPK, u konstatua se zërat e punimeve: “7(2.278) Shtresë zhavorri nën kanal t = 10 cm” dhe “Punime në kalimin këmbësorësh Hd = 2 m B = 2 m” janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën 315,525 lekë pa TVSH duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.</p>	120-132	I LARTË	<p>Nga Bashkia Mat, të merren masa për arkëtimin nga BOE “V. N. I.S” & “N.” Shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës 315,525 lekë pa TVSH, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës Derjan”.</p>
28	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rikonstruksion “Lagjia Drita”, realizuar nga OE “E.” SHPK përfaqësuar nga Z. R. D., u konstatua se zërat e punimeve: “Beton C 16/20 për fiksime bordure”, “Bordurë betoni C 16/20 20x35 cm” janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën 211,960 lekë pa TVSH duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.</p>	120-132	I LARTË	<p>Nga Bashkia Mat, të merren masa për arkëtimin nga OE “E.” Shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës 211,960 lekë pa TVSH, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion “Lagjia Drita”.</p>

I.c. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinionimi i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Për drejtimin e Bashkisë MAT.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare¹ të Bashkisë Mat për vitin ushtrimor, nga 1 Janar 17 deri 31 dhjetor 17, të cilat përfshijnë pasqyrën e gjendjes ekonomike, pozicionit financiar (hyrjeve dhe daljeve (pagesave) në para, pasqyra e amortizimit, shënimet shpjeguese që shoqëronin këto pasqyra.

¹ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Në opinionin tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të sinqertë të pozicionit financiar të performancës financiare dhe lëvizjet e mjeteve monetare për Bashkinë Mat më 31.12.17, kjo referuar Ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Udhëzimit të Minisitrisë së Financave “Për procedurat e përgatitjes dhe mbylljes së paqyrave financiare për institucionet qendrore, njësitë e qeverisjes vendore, njësitë e tyre të varësisë dhe njësitë e zbatimit/implementimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë huaj”, përveç aspekteve që adresohen në bazën për theksim të çështjes.

Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes:

Sipas mendimit tonë, përveç çështjes së theksuar në paragrafin e “Bazës për Opinionin e pakualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare më datë 31 dhjetor 2017, referuar Ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinion e pakualifikuar:

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për çështje specifike që bëjnë pjesë në pasqyrat financiare të cilat nuk janë materiale, dhe nuk kanë ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit dhe në vendimmarrjen e përdorueseve të pasqyrave financiare. Opinionin e dhënë për “*Theksimi i çështjes*” e mbështesim në faktin se:

a- Në llogaritë e poshtëshënuara të AQT, janë bërë hyrje dhe janë kontabilizuar vlerat, në një kohë që nuk është bërë regjistrimi i tyre si pasuri e Bashkisë Mat, konkretisht llogaritë me vlerat përkatëse sa vijon:

Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”, në shumën 26,247,728 lekë

Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”, , në shumën 12,303,824 lekë

Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”, në shumën 97,556,334 lekë

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”, në shumën 1,697,884,537 lekë

b- Në Llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë në bilancet e viteve 2016-2017 detyrimet e pa likuiduara për vendimet gjyqësore në vlerën 30,655,159 lekë. Gjatë vitit 2017-2018 janë likuiduar për shlyerjen e detyrimeve të lindura nga vendimet gjyqësore të formës prerë 12,722,199 lekë, pavarësisht se nuk janë përfshirë në bilancin e viteve të mësipërme. Vlera e detyrime për vendimet gjyqësore të formës se prerë me datë 31.12.2018 është 17,932,960 lekë, vlerë e cila duhet të përfshihet në bilancin e vitit 2018, të trajtuar gjerësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Mat²

²ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Ne kemi audituar përputhshmërinë³ e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë).

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e Bashkisë Mat, gjatë periudhave ushtrimore 6 muhori i dytë i vitit 2016, 2017 dhe 2018.

Opinion i kualifikuar/me rezervë.

Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së Bashkisë Mat, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Kualifikuar”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura.

Baza për opinion e kualifikuar:

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përsa i përket, menaxhimit financiar dhe kontrollit, transaksionet e kryera për zbatimin e buxhetit dhe prokurimeve, nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor financiar në fuqi. Kemi konstatuar se:

- 1-** Në Bashkinë Mat, sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregojnë se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen jo plotësisht. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- 2-** Detyrimet e faturuara dhe të pa likuiduara për fondet e bashkisë, buxhetit të shtetit dhe të rajoneve në fund të vitit 2018 për 61 subjekte janë **në vlerën 30,798,523 lekë** dhe 17,932,960 lekë nga vendimet gjyqësore të formës së prerë;
- 3-** Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi;
- 4-** Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej **debitorë 338 subjekte për vlerën 23,675,418 lekë** (nga të cilat 287 biznes i Madh dhe 51 biznes i Vogël);
- 5-** Nga auditimi në lidhje me debitorët familjarë u konstatua se janë planifikuar të ardhura për 10,967 familje për vitin 2017 dhe 2018 dhe nga planifikimi vjetor i taksave dhe tarifave lokale për vitin 2017, është 33,165,331 lekë dhe është arkëtuar 2,999,640 lekë, ose 0.9 % e planit vjetor. Ndërsa për vitin 2018, janë planifikuar 22,981,000 lekë dhe janë realizuar 3,048,344 lekë, ose 13 % e planit vjetor;
- 6-** Nga verifikimin e listave të subjekteve debitorë në vite, konstatohen subjekte aktiv dhe me detyrime. Kështu sipas të dhënave kemi 338 subjekte aktiv me detyrime, e barabartë me 49.4% të numrit total të subjekteve 683 (viti 2018 ose 590 të vitit 2017) gjë e cila tregon punën e pamjaftueshme të Sektorit të Taksave në arkëtimin e detyrimeve debitorë;
- 7-** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Mat, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve që rrjedhin nga 7 (shtatë) kontratat e lidhura me subjektet për shfrytëzimin e sipërfaqeve të fondit pyjor e kullosor për ndërtimin e antenave dhe HEC^{eve}, **për vlerën 2,947,905 lekë**, dhe 16 subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitetet pa qenë të regjistruar në QKR për vlerën **185,239 lekë**;

³Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

8- Nga auditimi mbi përputhshmërinë⁴ e procedurave të prokurimit publik, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti Bashkia Mat, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), bazuar në ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, “Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë”, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura, të cilat konsistojnë:

- Shkelje të kuadrit rregullator në fuqi në fushën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, lidhur me kriteret e vendosura në DST nga ku rezultoi se nuk kanë gjetur zbatim aktet ligjore e nënligjore të fushës së prokurimit publik, duke mos i argumentuar këto kërkesa në lidhje të ngushtë me objektin e kontratës, veprim në kundërshtim me nenin 26, pika 5, nenin 61, pika 2, paragraf i të VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për arsye të skualifikimit të operatorëve ekonomikë si pasojë e kriterëve të vendosura në DST dhe devijimeve të vogla të parashikuara në ligj, dhe OE të shpallur fitues edhe pse në kushtet e mosplotësimit të DST, pa ekonomikitet, eficence dhe efektivitet në vlerën 150,574,446 lekë, nga 306,851,049 lekë e cila përbën 49 % e vlerës së kontratave të lidhura dhe në 1 (një) rast për diferencën e ofertës në vlerën prej 2,743,534 lekë, si rezultat i kualifikimit dhe shpalljes fitues të OE apo BOE të cilët nuk kanë plotësuar kërkesat e DST, në të njëjtat kushte me OE e s’kualifikuar por me ofertë ekonomike më të lartë se ato të s’kualifikuar dhe konkretisht:

“Rikonstruksion Shkolla 31 Korriku Burrel”, për vlerën e kontraktuar prej 61,580,780 lekë

“Shërbimi i Patrimin në Bashkinë Mat”, për vlerën e kontraktuar prej 71,400,669 lekë

“Rehabilitimi i veprave të marrjes të kanalit ujitës batër e madhe”, për vlerën prej 5,995,984 lekë

“Mirëmbajtje kanale vaditëse”, për vlerën e kontraktuar prej 3,898,480 lekë

“Punime rrugore Lagjia Drita”, për vlerën e kontraktuar prej 13,098,531 lekë

“Ujësjiellësi i fshatit German”, për vlerën e kontraktuar prej 8,834,175 lekë

“Rikonstruksion i kanalit vaditës, fshati Derjan (i pjesshëm)”, për vlerën e kontraktuar prej 16,458,763 lekë dhe dëmin ekonomik prej 2,743,534 lekë, nga skualifikimi i padrejtë i OE me dokumentacion të rregullt ligjor.

- Në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve, në 3 raste u konstatuan shkelje për volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt dhe pagesë e gabuar e vlerës të TVSH^{së}, të cilat kanë shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të njësisë vendore në vlerën totale 1,357,981 lekë dhe konkretisht për objektet:

“Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku”, për vlerën prej 480,000 lekë

“Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku”, për vlerën prej 350,496 lekë

“Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës Derjan”, për vlerën prej 315,525 lekë

“Rikonstruksion “Lagjia Drita” 211,960 lekë

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standarteve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga subjekti i audituar njësisia e VQV Bashkia Mat, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi

⁴ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH-së”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Mat

Drejtimi i Bashkisë Mat, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II.HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1434/1, datë 29.12.2018, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 07.01.2019 deri më datë 28.02.2019, në subjektin Bashkia Mat për periudhën nga 01.01.2017- 31.12.2019, u krye auditimi “Auditim financiar dhe përputhshmërie” nga Grupi i Auditimit.

Titulli: Auditim financiar dhe përputhshmërie në BashkaMat.

Marrësi: Bashkia Mat.

Objektivat dhe qëllimi: Dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të BashkisëMat për vitin 2017 dhe 2018 dhe dhënia e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me kuadrin rregullator në fuqi. Auditimi u shtri në vlerësimin e pasqyrave të Bashkisë Mat.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 1320), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Ai promovon përgjegjshmëri ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre, duke identifikuar dobësitë dhe devijimet nga ligjet dhe rregulloret, si dhe duke vlerësuar rregullshmërinë aty ku kuadri ligjor rregullator rezulton i pamjaftueshëm dhe/ose i papërshtatshëm.

Mashtrimi dhe korrupsioni, për shkak të natyrës së tyre, përmbajnë elementë që janë në kundërshtim me transparencën, përgjegjshmërinë dhe administrimin e mirë.

Auditimi ka përfshirë veprimet e kryera nëpërmjet bankës, hartimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe mbledhja e të ardhurave, menaxhimin financiar dhe kontrollin, hartimi e zbatimi i buxhetit, auditimin e kontrollit të brendshëm. Gjithashtu auditimi ka përfshirë edhe zbatimin e procedurave të prokurimit, zbatimin e kontratave të punimeve.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Mat.

Identifikimi dhe përshkrimi i çështjes:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Mat janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe në të njëjtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të Bashkisë Mat, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në Ligjin e Buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin e Prokurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

-ISSAI 200 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare,

-Standarde Ndërkombëtare Auditimit (ISA), Federata Ndërkombëtare Kontabilistëve IFAC,

-Manuali Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,

-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI^t, INTOSAI “Për implementimi Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar”,

-Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),

-Në praktikat më të mira të fushës,

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,

-Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,

-UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.

-UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.

-Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare:

Administratori i Përgjithshëm (*Nëpunësi autorizues*) z. N. R. - Kryetar i Bashkisë Mat dhe (Nëpunësi zbatues) znj. D. K. - Përgjegjëse e Financës, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Administratori i përgjithshëm dhe Drejtori i Financës, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Mat.

Bazuar në pikën 6 e nenit 34, të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku thuhet se: “Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore”.

Neni 91. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: pika 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;

b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;

ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

Neni 65 “Administrata e njësisë administrative”, pika 1 “Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori”.

Përgjegjësitë e audituesvetë KLSH për auditimin e pasqyrave financiare:

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Mat dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Parimet e auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë,
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre,
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar,

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme,

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël,

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura,

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion,

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitetet, pasivitetet dhe interesat e kapitalit janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH^{së} nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:

-ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

-ISSAI 200 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC,
- Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar”,
- Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),
- Në praktikat më të mira të fushës,
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”,
- Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar,
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.
- UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007.
- Ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Në gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej 2%, për vitin 2017 vlerën 14,501 mijë lekë dhe për vitin 2018, në shumën 18,836 mijë lekë dhe për tu konsideruar, pasi gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm kanë risk të ulët deri në të moderuar. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

4. Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

5. Konfirmim nga të tretët, Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduara) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

6. Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabile. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i Përgjithshëm:

Aktiviteti i Bashkisë Mat.

Misioni për njësinë që auditohet është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

Objektivat burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

Organi përfaqësues i Bashkisë është këshilli bashkiak.

Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit tyre.

Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.

Sa më sipër organizimi dhe funksionet në NJQVV, burojnë nga kërkesat e ligjit nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

A- Planifikimi dhe identifikimi riskut; Strategjia dhe vlerësimi i riskut; Ekzekutimi i procedurave të testimit; Përgatitja e dokumenteve standarde të auditimit dhe komunikimi i tyre në mënyrë të vazhdueshme me subjektin e audituar.

A.1 Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

1. KLSH konstaton senë drejtim të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh, nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut, nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i tyre. Është hartuar Rregullorja e funksionimit të Njësisë, pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës, por në të nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprime me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Situata

Në Bashkinë Mat gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregojnë se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen pak. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nga ku rezultoi se:

Në lidhje me mjedisin e kontrollit. Është hartuar Rregullorja e funksionimit të Njësisë, pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh.

Në lidhje me menaxhimin e riskut: Nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të koordinatorit të riskut sipas nenit 21. Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

-Në lidhje me informacionin dhe komunikimin: Në rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprime me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Kriteri

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Impakti

Mos identifikimi dhe menaxhimi i risqeve, mos trajnim për rritjen profesionale të stafit si dhe mos perfeksionimi i sistemeve të IT për ofrimin e informacionit, ndikojnë në arritjen e objektivave të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

institucionit. Mosfunksionim i sitemit të brendshëm. Risku i brendshëm është i lartë.

Shkaku

Mosnjohje e plotë e koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”si dhe nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave.Mosnjohje nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, me nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm. I lartë.

Rëndësia

Rekomandimi:

Nga Bashkia Mat, nëpërmjet Nëpunësit Autorizues dhe strukturës së Auditit të Brendshëm, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe stafi i MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve e përcaktim të kordinatorit të riskut me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Afati për zbatim

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2- NJABnë ushtrimin dhe realizimin e funksionit të saj është bazuar në ligjin organik të AB, në MAB dhe në standardet e auditimit, por pavarësisht kësaj në auditimet e ushtruara nuk ka vlerësuar si duhet riskun në fushat e auditimit që janë me risk më të lartë si fusha e prokurimeve, planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, e planifikim-zhvillimit të territorit dhe e administrim-menaxhim i aseteve pronë e bashkisë për të cilat nuk janë zhvilluar auditime të thelluara. Gjithashtu nuk ka nxjerrje përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Situata

1) Karta e Auditimit, nuk është përgatitur dhe miratuar tek titullari i Bashkisë Mat, në kundërshtim me nenin nr. 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, ku përcaktohet që *“Karta e Auditimit” është një akt administrativ që miratohet me urdhër të titullarit të njësisë publike, në të cilën përcaktohen statusi organizativ, qëllimi, misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm.”*

si dhe në kundërshtim me pikën 2.5, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

2) Plani Strategjik edhe pse është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2017- 2019, ai nuk është përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Aditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6

3) Planifikimet vjetore të auditimeve për vitin 2017, dhe 2018 edhe pse janë përgatitur rregullisht, ata nuk janë përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Aditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

4) Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2017, dhe 2018, dhe pasqyrat shoqëruese, janë dërguar në afat, por pjesa përshkruese e raportit nuk është përgatitur sipas standarteve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.6.

5) Struktura e projektraportit dhe e raportit përfundimtar të auditimit nuk është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur nga MAB në Kapitullin IV, pika 4.1.12, Hapi 11

6) Nuk janë celur dosjet e përhershme për cdo njësi publike të audituar, për ti shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3

7) Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivën e njësisë vendore, në kundërshtim me ligjin 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Për vitin 2017 janë planifikuar për tu kryer 16 auditime gjithsej, prej të cilave 13 auditime të kombinuara, dhe 3 auditime për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Për vitin 2018 sipas planifikimit vjetor janë parashikuar 14 subjekte për tu audituar, prej të cilave 13 auditime të kombinuara, dhe 1 auditim për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

Kriteri

Ligji nr. 114/2015 datë 06.11.2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, VKM nr.212, datë 30.03.2012, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrisë të Financave me nr. 100, datë 25.10.2016, “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”

Impakti

Mos thellimi në problematikat e trajtuara sipas fushave në auditimet e kryera si dhe mos nxjerrja e përgjegjësive e mos marrja e masave për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke mos realizuar kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Shkaku

Mungesa e kontrollit të cilësisë së auditimeve të kryera.

Rëndësia

I mesëm.

Rekomandimi:

Nga Bashkia Mat të merren masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim.

Afati për zbatim

Në vazhdimësi.

Komente nga subjekti i audituar: Në kundërshtimet e paraqitura nga Bashkia MAT, shoqëruar me shkresën përcjellëse nr. 08/4, datë 07.05.2019, të administruara nga KLSH me nr. 1434/4, datë 13.05.2019, janë paraqitur observacione nga Përgjegjësi i Sektorit të Rrugëve Bashkiake, z. P. D.

Per sa i perket rekomandimeve mbi shpenzimet e karburantit te pa justifikuara dhe te terhequra nga z. D. N. ne sasine 1200 litra me mjetin rrul dhe z.B. XH. me mjetin ziz ne sasine 123.44 litra, sasi te harxhuara gjate punimeve te kryera per vitin 2016.



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Ju bejm me dije se z. D. N. me mjetin rrul per periudhen qershor,korrik,gusht sipas situacionit me zerat.

1.Cilindrim rruge me cakull me rrul sipas situacionit eshte harxhuar 920 litra

Situacioni i periudhes Shtator-Tetor me zerat

1.Cilindrim rruge me cakul me rrul eshte harxhuar 285 litra,punimet jane kryer ne fshatin Baterr e Vogel.

Ndersa z. B. XH. me mjetin ziz ka harxhuar karburantin me zerin trasnport sipas flete-udhetimeve ,ka pershkuar 458 km x 27 litra/100 km =123.56 litra.

Sqarojme se keto flete-udhetime nuk jan perfshire ne kontrollin e auditit te brendshem,megjithese atyre ju eshte derguar dokumentacioni i plote.

Nje kopje e dokumentacionit (situacion,flete-udhetim dhe preventiv) ndodhen ne zyren e finances. Bashkangjitur keni dhe nje kopje te ketyre dokumentave.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Nga grupi i auditimit merret në konsideratë sqarimi lidhur me konsumin dhe dokumentimin e karburantit. Pavarësisht sa sipër, ju risqarojmë se konstatimi nuk ka ardhur si rezultat i punës audituese të grupit të auditimit, por si konstatime të bëra nga zyra e auditit të brendshme në Bashkinë Mat. Grupi i auditimit të KLSH, vetëm ka cituar gjetjet dhe rekomandimet e auditit të brendshëm, si dhe masat e marra në zbatim të tyre nga titullari i bashkisë dhe strukturave përgjegjëse të ngarkuara prej tij për ndjekjen dhe zbatimin e tyre.*

A/3.2. Auditim mbi organizimin, mbajtjen e kontabilitetit, hartimin e saktësinë e veprimeve rregulluese dhe mbyllëse për paraqitjen e pasqyrave financiare.

I. *Nga auditimi i pasqyrave financiare, lidhur me përlllogaritjen e kuotave të amortizimit u konstatua se, aktivet që i përkasin llog.(209); “Amortizimi aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” pasqyrohet në vlerën e akumuluar kontabile (-5,875,991 lekë) me rritje periudha raportuese (-3,257,743 lekë) e llog.(219); “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” pasqyrohet në vlerën e akumuluar kontabile (-614,577,386 lekë) me rritje periudha raportuese për (-92,489,153 lekë). Nënjesinë publike bashkia Mat, të dhënat kontabile të evidentuara në aktiv të pasqyrës financiare evidentojnë se; amortizimi vjetor i përlllogaritur për aktive (të trupëzuara dhe patrupëzuara) është rritur me shumën -95,746,896 lekë (-3257743) dhe (-92489153), ndërsa në PSH (Formati nr.3/1), Klasa (68).III-“Kuota e amortizimit dhe shuma të parashikuara”, kjo llogari pasqyrohet me gjendje 0 (Zero), në këto kushte shumat e amortizimit vjetor të përlllogaritura nuk janë kontabilizuar dhe nuk janë të evidentuara në PSH (Formati nr.3/1).*

Situata

Të dhënat kontabile të evidentuara në aktivi pasqyrave financiare evidentojnë se; amortizimi vjetor i përlllogaritur për aktive (të trupëzuara e të patrupëzuara) është rritur me shumën -95,746,896 lekë (-3,257,743) dhe (-92,489,153), ndërsa në PSH (Formati nr.3/1) Klasa (68).III-“Kuota e amortizimit dhe shuma të parashikuara”, kjo llogari pasqyrohet me gjendje 0(Zero), në këto kushte shumat e amortizimit vjetor të përlllogaritura nuk janë kontabilizuar dhe nuk janë evidentuara në PSH (Formati nr.3/1), në këto kushte në se kontabilizimi shpenzimeve të amortizimit do të bëhej në mënyre korrekte dhe rezultati nga funksionimi në Llog.(85) “Rezultati nga funksionimi” e pasqyruar me vlerë kontabile +87,587,305lekë duhet të jetë me diferencë ndërmjet kësaj shume dhe vlerës së përlllogaritur të kuotës së amortizimit për periudhën raportuese



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

prej (-95,746,896 lekë) me diferencë shuma prej -8,159,591 lekë(+87587305 - 95746896).

Njësia publike bashkia Mat në pasqyrat financiare ka përllogaritur, rregjistruar, kontabilizuar norma për amortizimin e aktiveve të evidentuara në (*Formati nr.7*), ndërsa nuk ka testuar në se normat e amortizimi janë të sakta, njëkohësisht nuk janë evidentuar humbjet e rezultuara nga zhvlerësimi i aktiveve.

Kriteri

UMF nr.14, datë 28.12.2006 “*Për përgatitjen e raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësisve që varen prej tyre*”, ndryshuar, Kreu II, pika 1/4 “*Amortizimi vjetor*”; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”.

Impakti

Krijimi i një vleree përllogaritur saktë në aktivet, për rrjedhojë edhe të fondit bazë dhe pasivit të bilancit kontabël, diferenca të akumuluar nëçdoperiudhë raportuese.

Shkaku

Interpretimi gabuar i UMF nr.14, datë 28.12.2006 në lidhje me përllogaritjen konatabilizimin e testeve e normave të amortizimit për aktivet e “*të trupëzuara dhe pa trupëzuara*”.

Rëndësia

I mesëm.

Rekomandimi:

Njësia publike bashkia Mat, Sektori Financës e Konatabilitetit të marr masa për përllogaritjen e saktë të testeve e normave të amortizimit dhe kontabilizimin që i përket aktive të trupëzuara dhe patrupëzuara, deri në momentin aktual, duke paraqitur si shpenzim në pasqyra e shpenzimeve sistemikontabël në mbylljen e pasqyrave financiare periudha raportuese 2018 e në vazhdim.

Afati për zbatim

Brenda vitit 2019.

2. Nga auditimi pasqyrave financiare lidhur me llog.(202) “*Studime e projekte*” në vlerë kontabile 32,577,436 lekë e analizuar për 35 projekte ndërtimore e 3 studime të financuara në vite dhe të mbartuara nga (*ish/Komunat*) të administruara në njësia publike bashkia Mat u konstatua se, administrimi projekteve e studimeve të investuara nuk janë të dokumentuara nëpërmjet procesit të inventarizimit fizik të tyre, në mospërputhje me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar, neni 7, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kap (III), pikat 26, 35/b, 35/c dhe Kap (IV), pika 73 dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”, Kap (II), pika 1.

Situata

Të dhënat e gjendjessë llog.(202) “*Studime e projekte*” të pasqyruara në aktivin e pasqyrave financiare në vlerën 32,577,436 lekëe ndarë:

-Në 35 projekte ndërtimore me vlerë kontabile 32,402,436 lekë dhe 3 studime hidrogeologjike dhe ambjenti me vlerë 175,000 lekë.

-Për këto asete nuk evidentohet fakti në se vërtetë janë aktive për të cilat është përllogaritur testim amortizimi, ndërsa nuk është pasqyruar norma e amortizimit, si dhe nuk është mbajtur e administruar kartelë llogarie. Klasifikim më i saktë i këtyre aseteve duhet të kalojnë dhe administrohen në llog.(486) “*Shpenzime të periudhave të ardhëshme*”.

Kriteri

-ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin e pasqyrat financiare*” i ndryshuar, neni 7; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kap (III), pikat 26, 35/b, 35/c dhe Kap



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

(IV), pika 73 dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap (II), pika 1.

Impakti

Nuk është unifikuar dhe verifikuar, lista e studimeve dhe projekteve të mbartura nga ish/komunat, pas përfundimit të reformës territoriale në Njësinë publike bashkia Mat.

Shkaku

Administrimi i projekteve e studimeve të investuara, apo në proces nuk janë të dokumentuara nëpërmjet procesit të inventarizimit fizik të tyre.

Rëndësia

I mesëm.

Rekomandimi:

Njësia publike bashkia Mat, Sektori i financës e kontabilitetit të marr masa me qëllim që të verifikohet saktësia llog.(202) “Studime e projekte” dhe të administrohet nëpërmjet procesit të inventarizimit fizik gjendja dhe vlera e projekteve e studimeve të financuara në vite.

Afati për zbatim

Brenda vitit 2019.

3.Nga auditimi pasqyrave financiare lidhur me llog.(211) “Pyje, kullota, plantacione” vlera kontabile 12,303,824 lekë pa ndryshuar që përfaqëson vlerën e ekonomive në (pyllëzi me arvore, pyje e kullota, sisteme gjelbërimi) dhe llog.(212) “Ndërtime konstruksione” vlera kontabile 975,556,334 lekë të transferuara në pronësi të njësisë publike bashkia Mat, nga (ish/Komuna) në kuadër të reformës administrative territoriale u konstatua se; zyra e financës e kontabilitetit për këto astet nuk disponon regjistra, kartela llogarie e dokumentat kontabile me të dhëna të domosdoshme mbi objektet me qëllim të evidentohen të dhënat e nevojshme si; (viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria dhe projekti objektit ndërtimor, etj), asete të cilat nuk janë regjistruar në ZRPP Burrel në pronësi të njësisë publike bashkia Mat, ndërsa për periudhën raportuese nuk është kryer inventarizimi fizik dhe në këto kushte pasqyrimi në aktiv të bilancit pa të dhëna kontabile e dokumenta justifikuese, janë në mospërputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu (V); (VI) pika 2, Kreu (VII) pika 1; 2; ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap (III), pikat 26, 35/b, 35/c dhe Kap (IV), pika 73 dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” Kap (II), pika 1.

Situata

Nga auditimi pasqyrave financiare dhe dokumentacioni mbështetës i tyre u konstatua se, në kuadër të reformës administrative territoriale për këto astet të transferuara në njësia publike bashkia Mat, nuk disponohen regjistra, kartela llogarie e dokumentat kontabile tekniko-ligjore me të dhëna të domosdoshme e nevojshme për secilin objekte të dhëna si; (viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria, skica dhe projekti objektit ndërtimor, etj), ndërsa këto asete nuk janë regjistruar në ZRPP Burrel në pronësi të njësisë publike Bashkia Mat dhe për periudhën raportuese 2017 për të saktësuar gjendjen nuk është kryer inventarizimi fizik, në këto kushte pasqyrimi në aktiv të bilancit është bërë pa disponuar të dhëna kontabile e dokumenta justifikuese, në mospërputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu (V); (VI) pika 2, Kreu (VII) pika 1; 2 dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap (III), pikat 26, 35/b, 35/c dhe Kap (IV), pika 73 dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve e rregullave kontabël” Kap (II), pika 1.

Kriteri

Ligji nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare” i ndryshuar neni 7; dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap (III), pikat 26, 35/b, 35/c dhe Kap (IV), pika 73 dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” Kap (II), pika 1.

Impakti

Këto asete janë të trashëguar nga ish/Komunat në kuadër të reformës administrative territoriale, ndërsa për këtë periudhë raportuese nuk është kryer procesi I inventarizimit fizik të tyre për vlerat e kontabilizuara gjendje kontabile e mbartur në pasqyrat financiare të periudhës raportuese 2017.

Shkaku

Mos administrimi aseteve si, pasojë e transferimit të tyre në njësi publike Bashkia Mat, pa dokumenta tekniko-ligjore dhe pa inventarizim fizike të tyre.

Rëndësia

I lartë.

Rekomandimi:

Njësi publike bashkia Mat, Sektori i finacës dhe kontabilitetit të marr masa me qëllim të saktësohen llog.(211) dhe llog.(212) me qëllim justifikimi veprimeve kontabile me dokumenta të nevojshme justifikuese tekniko-ligjore për regjistrimin në ZRPP Burrel në pronësi të njësisë publike Bashkia Mat dhe pasqyrimin me dokumenta ligjor të këtyre aseteve.

Afati për zbatim

Menjëherë.

4. Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se, njësi publike bashkia Mat me analizë në aktiv llog.(401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to” përfaqëson detyrime të pa likuajuara në kohë për furnizime, shërbime e punime, për periudhat raportuese 2017 dhe 2018, detyrime të cilat duhet të likuajohen për efekt e brenda periudhës raportuese buxhetore 2018 e mbrapa në buxheti periudhës 2019 për 56 subjekte vlera 13,581,247 lekë dhe llog.(467) “Kreditor të ndryshëm” për detyrime të lindura nga 9 subjekte të cilët kanë fituar vendim gjykatave në vite me formë të prerë deri në datë 31.12.2018 vlera 48,587,939 lekë, në mospërputhje me UMF (plotësues) nr.02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe UMF (plotësues) nr.01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106 deri 110 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pika 116 deri 117 “Raportimi detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.

Situata

Nga auditimi i dokumentacionit mbështetës konstatohet se, detyrimet afatshkurtra në llog.(401) “Furnitorë e llogari të lidhura me to” gjendje në datat 31.12.2017 dhe 31.12.2018 të pa likuajuara, por të kontabilizuar nga njësi publike bashkia Mat, ndaj 69 subjekteve për fatura të mbritura për furnizime e investime të administruara llog.(401-408) dhe llog.(467) “Kreditor të ndryshëm” të detajuara për subjekte, faturë, emërtim objekti dhe të mbartura nga periudhat parardhëse janë sa më poshtë;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

- periudha 2015 pa likujduar 2 subjekte vlera 39,097 lekë.
- periudha 2016 pa likujduar 8 subjekte vlera 1,207,690 lekë.
- periudha 2017 pa likujduar 45 subjekte vlera 12,334,460 lekë.
- periudha deri 31.12.2018 pa likujduar 61 subjekte me 30,798,523 lekë.

Nga këto janë të trashëguara edhe nga ish/Komunat për investime gjendje e mbetur e pa financuar pavarësisht kërkesave nga njësia publike Bashkia Mat për vazhdimin dhe përfundimin e financimit, pasi këto vepra janë përfunduar dhe janë marrë në dorëzim. Ndërsa vlera 30,798,523 lekë fatura të pa likuiduara për blerje mallrash dhe shërbimesh pjesë e gjendjes kontabile në pasqyrat financiare gjendje në datë 31.12.2018 rezulton e shtuar në vlerën 13,217,036 lekë nga likuidimet në vazhdim të periudhës 2018 dhe vlera e mbetur e pa likuiduar edhe përperiudhën 2019, në mospërputhje me UMF (plotësues) nr.02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe UMF (plotësues) nr.01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106 deri 110 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pika 116 deri 117 “Raportimi detyrimeve të prapambetura në njësive të qeverisjes vendore”.

Kriteri

Gërma “gj” neni 12, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Impakti

Njësia publike bashkia Mat krahas faturave të palikujduara të administruara prej saj ka trashëguar edhe nga ish/Kkomunat fatura të pa likuiduara për blerje mallra, shërbime dhe punëgjendje kontabile në pasqyra financiare periudha raportuese 31.12.2018 gjendje e shtuar në vlerën 13,217,036 lekë nga likuidimet në vazhdim të vitit 2019 e mbetur e pa likuiduar.

Shkaku

Trashëgimi faturave të pa likuiduara nga gjendja paguese e njësisë publike bashkia Mat.

Rëndësia

I lartë.

Rekomandimi:

Njësia publike bashkia Mat, Sektori financë bazuar në UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” dhe UMF (plotësues) nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pika 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për likuidim, duke zbatuar për të gjitha radhën e pagesave vlera totale prej 48,587,939 lekë e rakorduar kjo shumë me pasqyrën e dërguar në Ministrinë e Financave me shkresë përkatëse, si dhe të nxirret përgjegjësia për to.

Afati për zbatim

Menjëherë.

Komente nga subjekti i audituar: Në kundërshtimet e paraqitura nga Bashkia MAT, shoqëruar me shkresën përcjellëse nr. 08/4, datë 07.05.2019, të administruara nga KLSH me nr. 1434/4, datë 13.05.2019, janë paraqitur observacione nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës zj. D. K. Në faqet 122-123 të projekt raportit nr 1434/3 prot date 04.04.2019 janë bërë krahasimi i të dhënave të Pasqyrave financiare vjetore dhe inventarizimit fizik të kryer nga komisionet e inventarizimit fizik për vitin 2017 ku janë konstatuar disa diferenca:
Në radhë të parë ju informojmë se të gjitha fletët e inventarizimit i janë dorëzuar nga Komisionet e inventarizimit specialistit të inventarizimit Z.Y. B. i cili nuk ka pranuar që ti administroje si



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

dhe nuk ka hartuar përmbledhësen e inventarizimit, megjithëse kam insituar disa herë duke i dërguar edhe emaile si dhe kam vënë në dijeni për këtë problem Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Kryetarin e Bashkisë.

Përsa i përket diferencave ju sqarojmë si më poshtë:

- Llogaria 202 studime e kërkime diferenca prej 1953 mije leke janë projekte të trashëguara nga ish Bashkia Burrel që Specialisti i Inventareve nuk i ka përfshirë në inventar të zyrave të Administratës së Bashkisë
- Llogaria 210 Toka troje e terrene diferenca prej 26 096 mijë lekë janë diferenca të përfshira në Pasqyrat Financiare vjetore por të papërfshira në pasqyrën e inventarizimit fizik 2017 nga Njesitë Administrative Rukaj, Macukull dhe Baz.
- Llogaria 212 Ndërtime e Konstruksione diferenca prej 536 806 mije leke janë investime të realizuara në Bashkinë Mat gjate viteve 2016-2017 të përfshira në Pasqyrat Financiare vjetore por papërfshira në pasqyrën e inventarizimit fizik 2017.
- Llogaria 213 Rrugë, rrjete e vepra ujore diferenca prej 384 081 mije leke janë investime të realizuara në Bashkinë Mat gjate viteve 2016-2017 të përfshira në Pasqyrat Financiare vjetore por papërfshira në pasqyrën e inventarizimit fizik 2017.
- Llogaria 214 Instalime teknike, makina pajisje e vegla pune diferenca prej 366 mijë lekë është e pasakte pasi po të krahasojmë Pasqyrat Financiare vjetore dhe pasqyrën e inventarizimit fizik 2017 është e barabartë.
- Llogaria 218 Inventar ekonomik diferenca prej 245 mijë lekë janë inventar ekonomik i bërë hyrje në fund të viti 2017 por i likujduar në vitin 2018 dhe i përfshirë në llogarinë 231 në Pasqyrat financiare vjetore të viti 2017.
- Llogaria Mjete transporti diferenca pozitive prej 1 532 mijë lekësh është një furgon i bërë hyrje në fund të viti 2017 por i likujduar në vitin 2018 me vlerë 246 mijë lekë si dhe vlera prej 1 286 mije lekë makina e ish komunes Derjan të cilat do të sistemohen në Pasqyrat Financiare vjetore të vitit 2017.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga grupi i auditimit merret në konsideratë sqarimi lidhur me dorëzimin e fletë vetë inventarizimit Specialistit të Komisionit të Inventarizimit, në përgjegjësi të sëcilit ka qenë administrimi, përpunimi dhe hartimi i inventarit përmbledhës të inventarizimit. Po ashtu janë marrë në konsideratë edhe sqarimi lidhur me diferencat e llogarive 202, 210, 212, 213, 214, 218 dhe llogari a mjete transporti.

B. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit me ndryshimet e tij.

-Për vitin 2017, buxheti i Bashkisë Mat, është miratuar me vendimin e Këshillit të Bashkisë nr.10, datë 20.02.2017, konfirmuar me shkresën e Prefektit të Qarkut Dibër me nr.302/1, prot. datë 27.02.2017. Gjatë vitit, buxheti i janë bërë ndryshime sipas miratimit me vendime të Këshillit të Bashkisë. Gjatë vitit janë bërë shtesë buxhetit të miratuar me VKB nr.57, datë 02.11.2017, për shumën 6,139 mijë lekë për përbalimin e rritjes së pagave sipas Institucioneve që paguhen me transfertat specifike, konfirmim nga Prefekti Qarkut Dibër.

-Në total buxheti për Bashkinë Mat, është programuar në shumën 518,487 mijë lekë, nga të cilat 85,796 mijë lekë, janë me burim financimi nga të ardhurat e veta dhe diferenca 432,691 mijë lekë, me burime financimi nga buxheti i shtetit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Më hollësisht, burimet e financimit janë si vijon:

A-Të ardhurat nga tatim taksat lokale të planifikuara për vitin 2017 janë 79,369 mijë lekë.

B-Të trashëguara: 6,426 mijë lekë.

-Totali i të ardhurave 85,796 mijë lekë,

-Mjete në ruajtje (Garanci punimesh) 27,048,324 lekë.

C-Transferta e pa kushtëzuar 170,926 mijë lekë.

D-Transfertat e kushtëzuara në total 125,544 mijë lekë, me destinacione si vijon:

-Transferta të kushtëzuara për funksionet e reja (Arsimi, shërbimi i kullimit dhe ujitjes, shërbimi pyjor, rugë rurale dhe MZSH-ja) 125,544 mijë lekë (Gjendje civile + QKB 7,335 mijë lekë, 1,350 mijë lekë shpërblime lindje, (Ndhma ekonomike + paaftësi) 304,712 mijë lekë, transporti mësuesve dhe nxënësve; 4,236 mijë lekë dhe FZHR 46,860 mijë lekë.

Realizimi i treguesëve të buxhetit, sipas aktit të rakordimit me degën e thesarit, janë si në pasqyrën që vijon: *Realizimi i buxhetit sipas natyrës së shpenzimeve paraqitet në 000 lekë.*

Nr	Emërtimi i artikullit të shpenzimeve	Viti 2017		
		Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat	204,049	185,140	91
2	601 Sig. shoqërore dhe shëndetësore	34,571	31,500	91
3	602 Shpenzime operative	104,650	83,489	80
4	604 Transfertat sporti	13,765	11,974	87
5	606 Shpërblim lindje, shpërbl pension & emergjen. civile	7,157	4,642	65
6	606 Ndhma ekonomike & PAK	304,712	304,711	100
7	230 Studime projektme	19,440	19,440	100
8	231 Investime objekte	178,846	124,673	70
	Shuma	867,190	765,569	91
9	466 Mjete në ruajtje	27,048	9,913	

Procedurat e programimit të buxhetit për vitin 2017

-Projektet e reja të propozuar për financim, kanë kaluar më parë procedurën e miratimit në kuadër të (Programimit të buxhetit afatmesëm) PBA-së për vitet 2018-2020, në zbatim të kërkesa vetë Udhëzimi plotësues MF nr. 08, datë 13.01.2017, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017”.

-Bashkia Mat, ka miratuar buxhetin me VKB nr.10, datë 20.02.2017, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me nr.302/2 prot.datë 27.02.2018 duke qënë në shkëlqje të afateve ligjore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 32, ku përcaktohet afati i miratimit të buxhetit vjetor, brenda muajit Nëntor të vitit paraardhës, UMF nr. 8, datë 29.3.2012 “Procedurat e përgatitjes së buxhetit afatmesëm”, kap. V, pika 92 dhe ligjit nr. 68-2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 33.

-Në zbatim të kërkesa vetë ligji nr. 9936, datë 26.6.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 është bërë detajimi i fondeve buxhetore dhe janë miratuar nga në punës i autorizues.

-Bashkia Mat, gjatë hartimit dhe miratimit të buxhetit të vitit 2017, ka zbatuar kërkesat e ligjit nr.130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017” duke përdorur 131,986 mijë lekë ose 25.4% të transfertës së pakushtëzuar për investimet publike.

Është krijuar fondi reserve dhe fondi i kontigjencës deri në masën 2.65% të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Fondi reserve dhe fondi i kontigjencës i planifikuar nga ana e Bashkisë Mat është në masën 4,520 mijë lekë. Fondi rezervë dhe i kontigjencës prej 4,520 mijë lekë është përdorur sipas rasteve të propozuara dhe të miratuara me VKB. Kështu me VKB nr.61, datë 02.11.2017 konfirmuar nga prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.1777/1, datë 13.11.2017, është përdorur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

ky fond për paga, sigurime shoqërore dhe emergjenca civile për efekt të mos realizimit të të ardhurave.

Analiza mbi realizimin e treguesëve të buxhetit viti 2017.

Realizimi i investimeve për vitin 2017, është programuar 131,986 mijë lekë, realizuar në masën 78,133 mijë lekë ose 59.2%, diferenca mosrealizimi, ka ardhur si rezultat i realizimit me vonesë të procedurave të prokurimit dhe për rjedhojë nuk ka qënë e mundur përdorimi i tyre brenda vitit ushtrimor.

Në programimin dhe zbatimin e buxhetit, u konstatuan këto shkelje:

-Nuk është bërë miratimi faktik i realizimit të treguesve të buxhetit në ecurinë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 47, konkretisht:

- Realizimin e buxhetit për 12-mujorin, nuk është shqyrtuar në Këshillin e Bashkisë.

Ndërsa raportimi për mbylljen e buxhetit të vitit 2017 nuk është miratuar.

-Të gjitha objektet e tenderuara për vitin 2017, nuk janë miratuar më pare nga Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe në kuadër të miratimit të Programeve Buxhetore Afatmesëm, në kundërshtim me kërkesat e UMF Plotësues me nr. 1, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, pika 12-e dhe UMF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standart të përgatitjes, programimit të buxhetit afat mesëm”, Kap. V, pikat 94, 109, 116.

-Për vitin 2018, buxheti i Bashkisë Mat, është miratuar me VKB nr. 75, datë 29.12.2017, ikonfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibërshekresë nr.12/1, datë 09.01.2018. Gjatë vitit, buxhetit i janë bërë ndryshime sipas miratimit me VKB. Me VKB nr.36, datë 18.05.2018 konfirmuar me shkresë të Prefektit të Qarkut Dibër nr.778/1, datë 23.05.2018, është miratuar shtesë buxheti për vitin 2018 në shumën 100, 940 mijë lekë për fonde trashëguar nga viti 2017.

-Në total buxheti i programuar për Bashkinë Mat, bashkë me njësitë vartëse, është gjithësej 498,478 mijë lekë nga të cilat nga të ardhurat lokale:

A-Të ardhurat nga tatim taksat lokale për vitin 2018 janë 100,940 mijë lekë.

Të ardhura të planifikuara 92,990 mijë lekë.

-Të trashëguara: 7,950 mijë lekë.

B-Transferta e pa kushtëzuar për vitin 2018 (Granti) 178,112 mijë lekë

-Transferta e pa kushtëzuar & specifike e trashëguar nga viti 2017 shuma 79,637mijë lekë

D-Transfertat specifike për vitin 2018 në total 139,788 mijë lekë, me destinacion.

-Transferta të kushtëzuara ndihmat ekonomike+paafhtësi 279,760 mijë lekë, Gjendja civile & QKB në shumën 7,352 mijë lekë, shpërblime lindje në shumën 475 mijë lekë, Emergjenca civile për familjet e dëmtuara nga tërmeti në shumën 61,147 mijë lekë si dhe fonde nga FZHR 56,250 mijë lekë.

Fondi rezervë dhe i kontigjencës prej 4,500 mijë lekë është përdorur sipas rasteve të propozuara dhe të miratuara me VKB. Kështu me VKB nr.104, datë 19.11.2018 konfirmuar nga prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr.1875/1, datë 04.12.2018, është përdorur ky fond për paga, sigurime shoqërore dhe emergjenca civile për efekt të mosrealizimit të të ardhurave.

Realizimi i treguesve të buxhetit, sipas aktit të rakordimit me degën e thesarit, janë si në pasqyrën që vijon në 000 lekë:

Nr	Emërtimi i artikullit të shpenzimeve	Viti 2018		
		Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzime për pagat & sigurime	244,173	217,290	89
2	602 Shpenzime operative	142,549	95,378	67
3	606 Ndihma ekonomike	279,760	279,747	100
4	230 Studime projektme	5,000	0	0
5	231 FSHZH	56,250	56,196	100



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

6	231 Investime objekte	84,199	27,161	32
7	600 Gj Civile & QKB	7,302	7,165	98
8	606 Emergjenca(Shp per termetet)	61,147	61,147	100
9	Shperblime lindje	475	475	100
10	600 Shpenzime për pagat & sigurime	244,173	217,290	89
	Shuma	880,855	744,612	
11	466 Mjete në ruajtje	21,823	9,515	
	TOTAL	902,678	754,127	

Procedurat e programimit të buxhetit për vitin 2018

-Projektet e reja të propozuar për financim, **kanë kaluar më pare procedurën e miratimit në kuadër të PBA-së për vitin 2019-2021**, në zbatim të kërkesave të Udhëzimit plotësues të MF nr. 9, datë 20.03.2018, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”.

Fondi rezervë është përdorur sipas rasteve të propozuara dhe të miratuara me VKB.

-Në zbatim të kërkesave të ligji nr.139/2015 “Për veteqeverisjen vendore”, Neni 34/6, buxheti i miratuar **është i balancuar me tëardhurat me shpenzimet**.

Është krijuar fondi reserve dhe fondi i kontigjences deri në masën 3% të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

Fondi reserve dhe fondi i kontigjences i planifikuar nga ana e Bashkisë Mat është në masën 4,500mijë lekë ose 2.5% e transfertës së pakushtëzuar.

-**Për vitin 2018** është miratuar buxheti me VKB nr.75, datë 29.12.2017 dhe i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me nr.12/1, datë 09.01.018 dhe është Brenda afateve ligjore.

-Në zbatim të kërkesave të ligji nr. 9936, datë 26.6.2006 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 është bërë detajimi i fondeve buxhetore dhe janë miratuar nga nëpunësi autorizues.

Bashkia Mat me VKB nr.14 datë 16.03.2018 dhe i konfirmuar nga Prefekti Qarkut Dibër me nr.115/1, datë 17.03.2018, ka miratuar ‘Raportin e Vlersimeve dhe parashikimeve afat mesme të të Ardhurave të Bashkisë Mat për periudhën 2019-2021.

-Në zbatim të kërkesave të ligji nr. 68 datë 27.04.2017 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 48 është bërë miratimi faktik i realizimit të treguesëve buxhetorë, është raportuar në mbledhjet e KB analiza e realizimit të buxhetit për 8-mujorin e pare të vitit 2018 dhe është dërguar në Ministrinë e Financave.

-Në lidhje me rregullshmërinë dhe ligjshmërinë e administrimit të aktiveve, saktësinë e mbajtjes së ditarëve për azhurnimin e veprimeve ekonomike rezultoi që:

Administrimi i aktiveve, qarkullimi dhe kontabilizimi i tyre është bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr.83, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, si dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2007 për institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësisve që varen prej tyre si dhe të njësisve të menaxhim/zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të huaj” të ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007. Mbajtja e kontabilitetit është realizuar me regjistrimet në ditar, duke i kontabilizuar në llogaritë përkatëse të gjitha veprimet dhe faktet ekonomike që i përkasin kësaj njësie shpenzuese. Janë mbajtur libri i arkës për arkëtimet dhe pagesat, ditari i bankës, ditari i magazinës, libri i pagave, ditari i veprimeve të ndryshme, kartelat e llogarive si dhe janë hartuar pasqyrat financiare vjetore. Për çdo regjistrim kontabël janë shënuar origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik dhe kontabilizimi i veprimeve është bërë në llogaritë përkatëse bazuar në planin kontabël.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

-Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës në lekë dhe në valutë, në përputhje me disiplinën financiare. Transaksionet financiare nëpërmjet arkës.

Me arkë janë kryer transaksione financiare të kufizuara vetëm për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Mat, për të cilat janë prerë mandate arkëtimi të plotësuara me të gjitha ekstremitetet dhe për pagesat janë prerë mandat-pagesat përkatëse në bazë të dokumenteve justifikues. Për veprimet me arkën është mbajtur libri i arkë, po kështu është mbajtur ditari arkës në formën klasike kontabël. Shumat e arkëtuara gjatë ditës janë derdhur në Bankë rregullisht. Përfshirja e shumës së të ardhurave në pasqyrat financiare është bërë duke u bazuar në vijueshmërinë kontabël dhe në përputhje me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, si dhe të UMF nr. 26, datë 27.12.2007. Nga Sektori i Financës janë kryer akt-rakordimet mujore dhe vjetore me Degën e Thesarit për të ardhurat. Gjithashtu të gjitha të ardhurat e arkëtuara janë bërë derdhje në Bankë në mënyrë periodike dhe arka rezulton me gjendje 0 në fund të çdo muaji. Nga dokumentacioni i arkës, që ju vu në dispozicion grupit të auditimit vihet re një numër i madh veprimesh nëpërmjet arkës me lekë në dorë, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

-Administrimi vlerave monetare në bankë.

Transaksionet e kryera nëpërmjet veprimeve të bankës rezultuan të jenë konform akteve ligjore. Hartimi i urdhër shpenzimeve është bërë mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës e justifikues, formati i tyre është sipas UMF dhe në të është aplikuar rregullisht sistemi i firmës së dyfishtë duke u nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues. Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktoheshin qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikues. Urdhër shpenzimet ishin konfirmuar dhe nga Specialistët e Degës së Thesarit dhe ishin likuiduar brenda limiteve të përcaktuara nga çelja e fondeve. Transaksione në valutë në euro dhe në dollarë, nuk u konstatua të këtë veprime të tilla, për periudhën objekt auditimi.

Për vitin 2017 kemi 13 procedura blerje me vlera të vogla me diferencë nga fondi limit në shumën 403,310 lekë.

Për vitin 2019 kemi 22 procedura blerje me vlera të vogla me diferencë nga fondi limit në shumën 1,037,067 lekë. (sipas pasqyrës)

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Është miratuar buxheti i detajuar sipas procedurave ligjore dhe në përputhje me hapat e duhura ligjore dhe hallkat ku duhet të kaloj, si dhe në përputhje me PBA dhe ligjin e Buxhetit dhe ka miratime nga Këshilli Bashkiak. Ka tre ndryshime në buxhet gjatë vitit 2018 dhe janë miratuar para zbatimit të tyre në buxhet. Për shpenzimet e reja kapitale janë zbatuar hallkat e miratimit për përfshirjen në buxhet. Janë ruajtur në buxhetim respektimi i radhës së financimit sipas ligjit ku shpenzimet në vazhdim kanë prioritet.

Në vitin 2017-2018 ka bllokim të limitit nga MFE. Në vitin 2017 ka krijuar problem më të madh pasi kanë qenë fondet dhe nuk është bërë likuidimi për efekt të limitit, ndërsa në vitin 2018 problemi ka qenë më i vogël pasi nuk kanë qenë dorëzuar as faturat për një pjesë të madhe të shpenzimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Shlyerja e detyrimeve të prapambetura, për vitin 2018 është lënë për pagesë 8,000,000 lekë dhe për vitin 2019, është 15,000,000 lekë. Janë ndjekur të gjitha hapat dhe me dokumenta justifikues dhe autorizues në dosje.

Urdhërat e prokurimit janë rregjistruar në sistemin e thesarit me vlerë të plotë dhe janë me vullë thesari përpara fillimit të procedurës dhe brenda afateve ligjore. Nuk ka urdhëra të prokurimit me vonesë dhe as me vlera me të vogla se realja dhe as të rregjistruara disa herë. Ka patur për shpenzimet ndërsa për të ardhurat është bazuar në plan. Ka dhe investime të shtrira ndër vite ku urdhërat janë miratuar dhe për vitin pasardhës bazuar në buxhetin afatmesëm. Ka 5 Urdhëra Prokurimi që janë të shtrirë nga 2018 në 2019 dhe i përkasin investimeve.

Kontratat nuk janë rregjistruar brenda afateve ligjore në sistemin e thesarit ndërsa në vlera kanë qenë të sakta. Janë të dorëzuara në sektorin e financës me vonesë nga sektori juridik. Ka patur fonde në thesar në momentin e hedhjes së kontratës. Ka kontrata të rregjistruara me vonesë, për shkak të sekuestrove të vazhdueshme. Kontratat lidhen në bazë të ofertës fituese. Nuk ka kontratat të copëtuara, vetëm për vlerën e faturës, për të bërë të mundur pagesën e saj në sistemin e thesarit. Kontratat shumëvjeçare janë rregjistruar pranë thesarit në vlera të detajuara sipas viteve përkatëse (pastrami dhe mirëmbajtja e varrezave). Rreth 3 kontrata nuk janë hedhur në thesar pasi janë të bllokuar fondet nga sekuestro vendime gjyqësore.

Ka fatura të likujduar me vonesë jashtë afateve 30 ditore, për mungesa dokumentacioni, sekuestro etj. Ka fatura të copëtuara në investime për arsye mungese celje fondi nga buxheti i shtetit. Janë të rregjistruara detyrimet të gjitha sipas faturave. Faturat paguhën në momentin e paraqitjes së bashku me dokumentacionin përkatës në Sektorin e Financës.

Në vitin 2017 ka 13,581 mijë lekë dhe pjesa tjetër 33,267 mijë lekë, në llogarinë 407. Në vitin 2018 ka 48,731 mijë lekë në llogarinë 401. Në debi të llogarisë 486 janë të gjitha faturat e kaluara me vonesë dhe në kredi të llogarisë 467 janë detyrimet e tjera. Vlera e detyrimeve është e saktë pasi çdo 3 mujor, Sektori i Financës raporton në MFE.

B/1.4. “Auditim mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave të institucionit dhe të njësive të varësisë”.

4. KLSH konstatoi se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e debitorëve nuk ka ndjekur në mënyrë të mjaftueshme procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 90, 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI.

Situata

Për vitin 2017, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 83,780,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 70,833,337 lekë ose 85%, me mosrealizim në shumën 12,946,663 lekë.

Për vitin 2018, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 92,990,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 59,879,235 lekë ose 64%, me një mosrealizim në vlerën 33,110,765 lekë. Nga të dhënat e pasqyrës si më sipër konstatohet se disa taksa e tarifa në krahasim me planin kanë tejkalime, kjo tregon që planifikimi i të ardhurave të Bashkisë për periudhën 2017 objekt auditimi është planifikuar 2% më shumë se plani i vitit 2016 dhe për vitin 2018 është planifikuar 2% më shumë se plani i vitit 2017.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksa e ndërtesës për objektet që do të zhvillojnë biznes për vitin 2017, është planifikuar në vlerën 1,490,280 lekë dhe është realizuar në vlerën 381,980 lekë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

ose 25%, ndërsa për vitin 2018, është planifikuar në vlerën 1,378,332 lekë dhe është arkëtuar 936,475 lekë ose 67% e planit vjetor.

Planifikimi është bërë mbi bazën e genplaneve të hartuara nga grupet e punës për verifikimin në terren të tyre dhe jo sipas të dhënave të ZVRPP, të rasteve për të cilat ka informacion. Nga sektori i tatimeve është kërkuar informacion zyrtar mbi sipërfaqet e objekteve të hipotekuara si biznes, por nuk është marrë asnjë përgjigje.

Kontrollet e bëra për grumbullimin e taksave, rakordimi me agjentet tatimor, problemet e dala dhe masat e marra.

Për vitin 2017, kanë ushtruar aktivitetet 490 subjekte të biznesit të vogël dhe 100 subjekte të biznesit të madh, për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksa e tarifa vendore.

Për vitin 2018, kanë ushtruar aktivitetet 550 subjekte të biznesit të vogël dhe 134 subjekte të biznesit të madh për të cilat janë planifikuar të ardhura për taksa e tarifa vendore.

Nga auditimi i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi rezulton se nga Sektori i Tatim Taksave për abonentët familjarë ka regjistra të përditësuara, për evidentimin e vlerës së detyrimit që ato kanë dhe vlerën e detyrimit të mbetur; është plotësuar dhe dërgohej tek abonentët familjarë njoftim detyrimi për taksat e tarifatat vendore, për evidentimin e numrit të familjeve që duhet të paguajnë, vlerën e paguar dhe vlerën e mbetur.

Nga të dhënat rezulton se me urdhër bllokimet bankare janë dërguar bankave të nivelit të dytë për bllokim llogarish të disa prej subjekteve të biznesit të madh dhe të vogël, që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore. Bazuar në afatet ligjore të përcaktuara në paketat fiskale për mbledhjen dhe transferimin në buxhet të ardhurave nga taksat vendore si dhe në akt rakordimet dhe të dhënat nga financa, rezulton se në total vlera e akt rakordimeve me xhirimet e bëra të konfirmuara nga financa përputhen.

Nga grupi i auditimit u bë verifikim për disa subjekte për taksat dhe tarifatat vendore ku rezultuan:

Debitorët e biznesit të Madh për 51 subjekte në vlerën **11,355,573 lekë**, (Njësia Administrative Burrel, për 25 subjekte në vlerën 6,495,316 lekë, Njësia Administrative Komsit, për 11 subjekte në vlerën 1,575,435 lekë Njësia Administrative Lis, për 12 subjekte në vlerën 1,808,518 lekë, Njësia Administrative Macukull, për 1 subjekte në vlerën 35,000 lekë, Njësia Administrative Ulez, për 5 subjekte në vlerën 1,266,070 lekë, Njësia Administrative Derjan, për 1 subjekte në vlerën 131,576 lekë, Njësia Administrative Rukaj, për 1 subjekte në vlerën 43,658 lekë,) sipas pasqyrës I si më poshtë:

Për debitorët e biznesit të Vogël për 287 subjekte në vlerën **12,319,845 lekë**, (Njësia Administrative Burrel, për 220 subjekte në vlerën 10,008,304 lekë, dhe Njësia Administrative Lis, për 19 subjekte në vlerën 406,945 lekë, dhe Njësia Administrative Baz, për 6 subjekte në vlerën 76,758 lekë Njësia Administrative Rukaj, për 10 subjekte në vlerën 231,920 lekë Njësia Administrative Ulez, për 8 subjekte në vlerën 381,836 lekë, Njësia Administrative Macukull, për 20 subjekte në vlerën 331,212 lekë, Njësia Administrative Derjan, për 4 subjekte në vlerën 102,280 lekë sipas pasqyrës II si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Masat e marra për personat fizikë e juridikë që nuk likujdojnë taksat dhe tarifave vendore dhe ushtrojnë aktivitet pa qenë të rregjistruar në QKR.

Nga auditimi i dokumentave dhe të dhënave të paraqitura nga Zyra e Tatim Taksave, për vitin 2017 dhe 2018, nga zyra e taksave dhe tarifave vendore janë evidentuar 16 subjekte të cilat ushtrojnë veprimtari biznesi pa qenë të rregjistruar në QKR, për këto subjekte, bazuar në nenin 11, 22 dhe 32 të ligjit nr. 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, është bërë vlerësimi nga zyra, kan llogaritur në planifikim të ardhura për buxhetin e vitit 2017 dhe 2018, kanë dalë njoftim vlerësimi në zbatim të nenit 40, pika 5 të ligjit nr 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore” me ndryshime ku thuhet...*mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.*

Nga mosregjistrimi i këtyre subjekteve **llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë në vlerën 185,238lekë**, sipas pasqyrës si më poshtë:

Mbi vjeljen e detyrimeve të taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI.

Në zbatim të ligjit nr. 9482 datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, ku cilësohet: “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë llogaritet dhe arkëtohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me pikën 2/1, të nenit 27, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.”

Për Bashkinë Mat për të tre vitet 2016, 2017 dhe 2018, kjo taksë për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, është 0.5% e vlerës në lekë e investimit të ri (objektit për legalizim).

Vlera e objektit llogaritet sipas sipërfaqes përkatëse me koston mesatare të ndërtimit të nxjerrë nga EKB. Në Bashkinë Mat, për arsye të realizimit të shërbimit sa më pranë banorëve, kjo taksë është pëllogaritur dhe mbajtur edhe nga Njësitë Administrative Burrel, Ulez, Baz, Koms, Lis, Rukaj, Derjan dhe Macukull.

1.Për vitin 2017 janë proceduar 46 shkresa për ndërtimet informale në territorin e Bashkisë nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Shërbimeve dhe Infrastrukturës Publike. Nga të cilat për vitin 2017 kanë paguar 27 persona në vlerën 858,170 lekë. Diferenca prej 19 personave janë njoftuar me shkresë zyrtare por nuk kanë bërë pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë, ndaj Bashkisë Mat.

2.Për vitin 2018 janë proceduar 105 shkresa dhe është pëllogaritur taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi për ndërtimet informale në territorin e Bashkisë nga ana e D.P.T.I.Sh.P. Nga të cilat për vitin 2018 kanë paguar 32 persona në vlerën 985,331 lekë. Diferenca prej 73 personave janë njoftuar me shkresë zyrtare por nuk kanë bërë pagesat e TNI, ndaj Bashkisë Mat.

Për vitet 2017, 2018 objektet e ndara sipas kategorive të cilat janë pajisur me leje legalizimi për të cilat është pëllogaritur taksa ndikimit në infrastrukturë nga D.P.T.Sh.I.P janë 119 objekte banimi, 26 objekte social-ekonomike dhe 6 objekte të kombinuara, në mbështetje të ligjit nr.9482, datë 03.04.2016, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe VKB nr. 6 datë 07.02.2017 “Paketa fiskale për vitin 2017”, nr. 69, datë 26.12.2017 “Paketa fiskale për vitin 2018”, sipas aneksit nr.5/2.

Taksë reklame.

Për periudhën objekt auditimi kemi një realizim, për vitin 2017 nga 667,000 lekë të planifikuara, janë realizuar 1,114,076 lekë ose 167%. Ndërsa për vitin 2018, nga 1,000,000 lekë të planifikuara për periudhën janë realizuar 605,251 lekë ose 61% e planit vjetor të të ardhurave. Nga të dhënat rezulton se, planifikimi i kësaj takse nuk është i saktë pasi:

-për subjektet që paguajnë këtë taksë nuk ka gen plan për tabelat për qëllime reklamimi.

Nga Sektori i Taksave i është kërkuar Drejtorisë së Urbanistikës me shkresën nr.1076, datë 02.05.2017 ku kërkohet informacion mbi siperfaqet e Tabelave dhe Reklamave, por nga Drejtoria e Urbanistikës është kthyer përgjigje që nuk kemi asnjë të dhënë për këto sipërfaqe gjë e cila bie ndesh me ligjin.

Tarifa e Pastrimit, Gjelbërimit dhe Ndriçimi i biznesit.

Tarifa e pastrimit për biznesin për vitin 2017, është planifikuar në vlerën 14,843,122 lekë dhe është realizuar në vlerën 13,758,911 lekë, ose 92%, ndërsa për vitin 2018, është planifikuar në vlerën 16,016,539 lekë dhe realizuar në vlerën 13,343,028 lekë e planit vjetor, ose 83%.

Tarifa e ndriçimit për vitin 2017, është planifikuar në vlerën 606,656 lekë dhe është realizuar në vlerën 13,816 lekë ose 22%, ndërsa për vitin 2018, është planifikuar 641,291 lekë dhe është realizuar 421,011 lekë ose 65% e planit vjetor. Tarifat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit për biznesin janë miratuar me VKB, ku tarifatat janë kategorizuar sipas llojit të aktivitetit dhe statusit të biznesit.

Taksa dhe tarifa lokale (familjarët).

Me VKB nr. 6, datë 07.02.2017 për vitin 2017, është miratuar taksë ndërtese për familjarët 5 lekë m² në vit për çdo familje, tarifë shërbimi 1,500 lekë, ndriçimi 100 lekë për çdo familje. Ndërsa për vitin 2018, me VKB nr. 69, datë 27.12.2017, është miratuar taksë ndërtese për familjarët 5 lekë m² në vit për çdo familje deri me 31.03.2018 dhe me 01.04.2018 ka patur ndryshim të kësaj takse bazuar në VKM nr. 132, datë 07.03.2018, është miratuar 16 lek m², është miratuar Tarifë Shërbimi për familjarët 1,500 lekë në vit për çdo familje, ndriçimi 100 lekë për çdo familje.

Planifikimi vjetor i taksave dhe tarifave lokale për vitin 2017, është 33,165,331 lekë dhe është arkëtuar 2,999,640 lekë, ose 0.9 % e planit vjetor. Ndërsa për vitin 2018, janë planifikuar 22,981,000 lekë dhe janë realizuar 3,048,344 lekë, ose 13 % e planit vjetor.

Nga verifikimi rezulton se janë planifikuar të ardhura për 10,967 familje për vitin 2017 dhe 2018 sipas regjistrit të gjendjes civile me datë 01.01.2017 dhe 01.01.2018, rezultojnë në Bashkinë Mat në Njësinë Administrative Burrel 5055 familje, ndërsa në Njësinë Administrative Baz 1858 familje. Njësinë Administrative Komsit 1333 familje Njësinë Administrative Lis 1266 familje,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Njësinë Administrative Rukaj 936 familje, Njësinë Administrative Ulez 556 familje, Njësinë Administrative Derjan dhe Macukull 953 familje.

Në planifikim nuk janë planifikuar saktë të ardhurat për vitet 2017 dhe 2018, pasi nuk janë marrë në konsideratë vlera debitore e trashëguar në vite për taksat dhe tarifatat familjare.

Sipërfaqja e tokës së ndarë me ligj për Bashkinë Mat dhe Njësinë Administrative është si më poshtë vijon:

Përmbledhëse e sipërfaqes së ndarë me ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 është si më poshtë vijon:

Bashkia Mat.

Nr.	Zonat	Sipërfaqja në Ha	Nr.familjeve
1.	Burrel	0	5055
2.	Ulez	262	556
3.	Baz	654	1855
4.	Komsi	965	1333
5.	Lis	1138	1266
6.	Macukell	342	
7.	Derjan	460	953
8.	Rukaj	889	936
	Gjithsej	4710	11954

Për vjeljen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave vendore të Bashkia Mat, janë ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore të mëposhtme:

-është nxjerrë urdhri i bllokimit të llogarive bankare për të gjithë subjektet debitore.

-janë llogaritur kamat vonesa (gjobë në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kanë kryer aktivitet subjekte private për “shfrytëzim fondi pyjor dhe kullor” dhe nuk kanë paguar detyrimet në shumën 2,947,905 lekë, e cila do të konsiderohet mungesë të ardhurash me efekt negativ, shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Mat, konkretisht(sipas tabelës bashkëngjitur):

1. Subjekti “T. A. SHA (Ulëz)” me nipt L78028901G, ka lidhur Kontratë Qeraje NR.618 REP dhe NR. 44 KOL, datë 04.09.2009, me ish-Komunën Ulëz, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor publik në pronësi të ish-Komunës Ulëz (sot Njësia Administrative Ulëz) për ndërtim të stacionit të antenave. Afati i kontratës është 9 vjeçar (02.08.2009-01.08.2018).Vlera e qirasë vjetore është për shumën 225,000 lekë, e cila është llogaritur sipas VKM nr.391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, lidhjes 2, pika 6 “Për vendosje antene”. Nga të dhënat e marra në zyrën e taksave dhe sektorin e financës, rezulton se subjekti “T. A. sha” sha nuk ka likuiduar detyrimet e vitit që ka lenë KLSH në shumën prej, gjithsej në vlerën **78,445lekë**.

2. Subjekti “A. SHA (Ulëz)” me nipt J61824053N, ka lidhur Kontratë Qeraje nr ska, datë 19.12.2008, me ish-Komunën Ulëz, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor publik në pronësi të ish-Komunës Ulëz (sot Njësia Administrative Ulëz) për ndërtim të stacionit të antenave. Afati i kontratës është



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

9 vjeçar dhe është miratuar në heshtje në afatin (19.12.2017-18.12.2026). Vlera e qirasë vjetore është për shumën 280,000 lekë, e cila është llogaritur sipas VKM nr.391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, lidhjes 2, pika 6 “Për vendosje antene”. Nga të dhënat e marra në zyrën e taksave dhe sektorin e financës, rezulton se subjekti “A. sha (Ulëz)” nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2017, 2018 në shumën prej, gjithsej në vlerën **560,000lekë**.

3. Subjekti “A. SHA (Lis)” me nipt J61824053N, ka lidhur Kontratë Qeraje nr.3029 REP dhe nr.1024 KOL, datë 07.09.2009, me ish-Komunën Lis, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor publik në pronësi të ish-Komunës Lis (sot Njësia Administrative Lis) për ndërtim të stacionit të antenave. Afati i kontratës është 9 vjeçar dhe është miratuar në heshtje deri në afatin (07.09.2018-06.09.2027). Vlera e qirasë vjetore është për shumën 170,000 lekë, e cila është llogaritur sipas VKM nr.391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, lidhjes 2, pika 6 “Për vendosje antene”. Nga të dhënat e marra në zyrën e taksave dhe sektorin e financës, rezulton se subjekti “A. sha (Ulëz)” nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2018, në shumën prej, gjithsej në vlerën **170,000lekë**.

4. Subjekti “K. I. SHA (Ulëz)” me nipt K02727230T, ka lidhur Kontratë Qeraje nr. ska, datë 05.08.2012, me ish-Komunën Ulëz, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor publik në pronësi të ish-Komunës Ulëz (sot Njësia Administrative Ulëz) për ndërtim të linjave të tensionit të lartë. Afati i kontratës është 1 vjeçar dhe është miratuar në heshtje deri në afatin (05.08.2018-04.08.2019). Vlera e qirasë vjetore është për shumën 300,000 lekë, e cila është llogaritur sipas VKM nr.391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, lidhjes 2, pika 6 “Për vendosje antene”. Nga të dhënat e marra në zyrën e taksave dhe sektorin e financës, rezulton se subjekti “K. I. sha (Ulëz)” nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2018-2019 në shumën prej, gjithsej në vlerën **300,000 lekë**.

5. Subjekti “V. A. SHA (Lis)” me nipt K11715005L, ka lidhur Kontratë Qeraje nr.1865 Prot, datë 23.07.2018, me Bashkinë Mat, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor publik në pronësi të ish-Komunës Lis (sot Njësia Administrative Lis) për ndërtim të stacionit të antenave. Afati i kontratës është 9 vjeçar dhe është miratuar deri në afatin (30.10.2016-29.10.2026). Vlera e qirasë vjetore është për shumën 300,000 lekë, e cila është llogaritur sipas VKM nr.391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, lidhjes 2, pika 6 “Për vendosje antene”. Nga të dhënat e marra në zyrën e taksave dhe sektorin e financës, rezulton se subjekti “V. A. sha” nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2018 në shumën prej, gjithsej në vlerën **300,000 lekë**.

6. Subjekti “P. E. SHPK” me nipt L17610901S, ka lidhur Kontratë Qeraje nr ska, datë 06.05.2013, 16.05.2013, me ish-Komunën Rukaj, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor publik në pronësi të ish-Komunës Rukaj (sot Njësia Administrative Rukaj) dhe me drejtoirinë Pyjore Mat, sot pjesë e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Bashkise Mat, për ndërtim hidrocentrali. Afati i kontratës është 9 vjeçar dhe është deri ne afatin (16.05.2013 - 15.05.2022).Vlera e qirasë vjetore është për shumën 275,000 lekë dhe 140,250 lekë, e cila është llogaritur sipas VKM nr.391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, lidhjes 2, pika 6 “Për vendosje antene”. Nga të dhënat e marra në zyrën e taksave dhe sektorin e financës, rezulton se subjekti “P. E. shpk” nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2018, në shumën prej, gjithsej në vlerën **830,500lekë**.

7. Subjekti “S.G.- M. SHPK” me nipt L11814001B, ka lidhur Kontratë Qeraje nr ska, datë 22.08.2014, me ish-Komunën Komsi, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kollusor publik në pronësi të ish-Komunës Komsi (sot Njësia Administrative Komsi), për ndërtim hidrocentrali. Afati i kontratës është 5 vjeçar dhe është deri në afatin (22.08.2014 - 22.08.2020).Vlera e qirasë vjetore është për shumën 354,480 lekë, e cila është llogaritur sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, lidhjes 2, pika 6 “Për vendosje antene”. Nga të dhënat e marra në zyrën e taksave dhe sektorin e financës, rezulton se subjekti “S.G.- M. SHPK” nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2017, 2018, në shumën prej, gjithsej në vlerën **708,960lekë**.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

1) Ndër vite, kanë ushtruar aktivitet 16 subjekte pa qenë të rregjistruar në QKB, buxhetit të Bashkisë për periudhën objekt auditimi nga mosregjistrimi i këtyre subjekteve, llogaritet ***mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 185,238 lekë***. Kjo shumë është kontabilizuar në bilancin e vitit 2018.

2) Në fund të vitit 2018 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 287 subjekte të biznesit të vogël dhe 51 biznesit të madh, llogaritet ***mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 23,675,418 lekë***.

3) Kanë kryer aktivitet subjekte private për “shfrytëzim fondi pyjor dhe kullusor” dhe nuk kanë paguar detyrimet ***në shumën 2,947,905 lekë, e cila do të konsiderohet mungesë të ardhurash me efekt negati***.

Kriteri

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 4, 26, 32, 34, ligji nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 90, 91, UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI, neni 12.

Mosrealizimi i të ardhurave.

I mesëm.

Impakti

Rëndësia

Rekomandimi:

Bashkia Mat, nëpërmjet Drejtorisë së Tatim Taksave e Tarifave të marrë masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore të pa arkëtuara në vlerën 89,881,808 lekë për sektorin e biznesit dhe të vlerës 8,317,400 lekë nga familjarët, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar. Sa sipër, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Taksave të nxirren njoftim vlerësimet tatimore dhe për arkëtimin e detyrimeve të mësipërme të ndiqen rrugët e mëposhtme:

a) T’u ridërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Në rast mos kryerjes të urdhër bllokimeve prej bankave të njoftohet Guvernatori i Bankës Shqipërisë).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

b) T’i ridërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

c) Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të fillojë llogaritja e gjobës në masën 0,06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë “ të ndryshuar, me ligjin nr.164/2014, datë 15.12.2014.

ç) Në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet e akumuluar në vite, nga ana e Bashkisë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike) të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të Republikën e Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

d) Drejtoria e Taksave në Bashkinë Mat të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të familjarëve, taksës së tokës nga fermerët. Në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, pika 76, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë dhe bizneset me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifaf etj.

Afati për zbatim

Rekomandimi:

Në vazhdimësi.

Nga Bashkia Mat, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe në bashkëpunim me ALUIZNI-n Mat dhe ZVRPP Mat të merren masa të nxjerrë përgjegjësitë për situatën e krijuar si dhe të ndiqen të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së infrastrukturës.

Afati për zbatim

Rekomandimi:

Menjëherë.

Bashkia Mat të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktor ku kanë kryer aktivitet subjekte private për “shfrytëzim fondi pyjor dhe kullisor ” dhe nuk kanë paguar detyrimet në shumën 2,947,905 lekë.

Afati për zbatim

Menjëherë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

C-Mbi planifikimin dhe zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017.

Në mënyrë të përgjithshme rezulton se edhe pse bashki e vogël, ky subjekt ka hartuar projekte duke përfutur fonde dhe realizuar investime dhe shpenzime , të cila janë në vlerën e prokuruar prej afro 307 milion lekë.

Në Bashkinë Mat, për periudhën objekt auditimi 01.01.2017 – 31.12.2018, janë zhvilluar **41** procedura prokurimi, me fond limit **306,851,049** lekë dhe me vlerë të kontratave të lidhura (me tvsh) në shumën **286,830,097** lekë. Nga grupi i auditimit, referuar numrit të pakët të procedurave, u vlerësuar për tu audituar të gjitha procedurat me vlerë të prokuruar mbi 3 milion lekë ose afro 90% e fondit të prokuruar dhe 20 procedura nga 41 ose afro 50% e tyre.

Nga 41 procedura prokurimi, 23 janë realizuar gjatë vitit 2017, për vlerën prej 215,867,605 lekë (nga të cilat 181,257,392 lekë janë nga grantet e buxhetit të shtetit ndërsa diferenca është mbuluar nga të ardhurat dhe) dhe vlerë të kontraktuar 209,815,334 lekë, me një diferencë nga fondi limit prej 6,052,271 lekë, ose afro 3 %; si dhe 18 gjatë vitit 2018, për vlerën prej 90,983,444 lekë (nga të cilat 77,931,429 lekë janë nga grantet e buxhetit të shtetit ndërsa diferenca është mbuluar nga të ardhurat) dhe vlerë të kontraktuar 77,014,700 lekë, me një diferencë nga fondi limit prej 11,243,854 lekë, ose 12.3 %

Nga 41 procedura rezulton se kanë pjesë 125 Operatorë ose me një mesatare prej afro 4 operatorë ekonomik apo bashkim operatorësh për procedurë.

Nr.	Procedura prokurimi	Procedura	Fondi limit
A	Viti 2017		
1	Kerkese per propozim	15	35,696,999
2	Procedure e hapur	7	172,303,086
3	Negocim pa shpalljes	1	7,867,520
	Shuma A	23	215,867,605
	Audituar nga KLSH	11	200,983,584
	- në % ndaj procedurave të kryera	48	93
B	Viti 2018		
1	Kerkese per propozim	14	47,063,715
2	Shërbim konsulence	1	4,166,667
3	Procedure e hapur	3	39,753,062
	Shuma B	18	90,983,444
	Audituar nga KLSH	9	69,352,131
	- në % ndaj procedurave të kryera	50	76
	Totali A + B	41	306,851,049
	Kerkese per propozim	29	82,760,714
	Procedure e hapur	10	212,056,148
	Neg.pa shpall.paraprake	1	7,867,520
	Shërbim konsulence	1	4,166,667
	Audituar nga KLSH për periudhën objekt auditimi	20	270,335,715
	- Në % ndaj procedurave të kryera	49	88

Ndarja e fondeve të procedurave të prokurimit paraqitet sipas tabelës sa më poshtë vijon:

Viti	Procedura në nr.	Hapur	K.Prop (nr & vlere total)	Negocim & (nr & vlere total)	Konsulence (nr & vlere total)	Fondi limit (pa tvsh)	Oferta (pa tvsh)	Diferenca (pa tvsh)	OE apo BOE	skulifikuar
2017	23	7	15	1		215,867,605	209,815,334	6,052,271	66	29



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

2018	18	3	14		1	90,983,444	77,014,700	11,243,854	59	11
Total	41	212,056,148	82,760,714	7,867,520	4,166,667	306,851,049	286,80,034	13,968,774	125	49

Nga auditimi rezultoi se situata e likuidimit të kontratave të lidhura sipas viteve paraqitet sa vijon:

Viti	Vlerë kontrate	Likuiduar	Pa likuiduar	Në % pa likuiduar
2017	209,815,334	204,391,001	5,424,333	0.2
2018	77,014,700	57,623,802	19,390,898	25
totali	286,830,034	469,738,769	783,441,235	25

Në mënyrë analitike procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Bashkia Mat, janë sipas aneksit nr.X, “Procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Bashkia Shijak për periudhën objekt auditimi Janar 2017 – Dhjetor 2018”, bashkëlidhur këtij material.

Në mënyrë analitike, sipas viteve dhe procedurave të prokurimit nga auditimi rezultoi:

Procedurat e prokurimit të konstatuara më shkelje e parregullsi gjatë vitit 2017, si vijon:

Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare 31 Korrik, Burrel”.

Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në përcaktimin e kriterëve dhe përzgjedhjen e ofertës fituese
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik u konstatua vendosja e kriterëve kualifikuese jo plotësisht në përputhje me natyrën e investimit, dhe në vlerësimin e ofertës fituese u konstatua se OE i shpallur fitues nuk i përmbush plotësisht ato, dhe pavarësisht mangësive është vlerësuar dhe shpallur fitues.
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I Lartë.
Rekomandime:	Të merren masa për analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përzgjedhjen e OE fitues, vendimmarrje e cila ka sjell si pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet në vlerën prej 61,580,780 lekë (vlerë e barabartë me ofertën e shpallur fituese).

Në mënyrë të përmbledhur të dhëna për tenderin jepen në tabelën e mëposhtme:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rikonstruksion Shkolla 31 Korriku Burrel		
1.Urdhër Prokurimi <u>NR. 400.</u> <u>DATË 28.07.2017</u>	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 402 , dt.28.07.2017	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 401 dt. 28.07.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “e hapur ”	A. N. Kryetare/ Jurist B. H. Anëtar/Arkitekt D. N. Anëtare/ekonomist	K. K. KRYETAR (ekonomist) E. Ç. anetar(jurist) B. K. anetare(ing.ndërtimi)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

5.Fondi Limit (pa tvsh) : 61,819,333 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 61 580 780lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 238 500 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 29.08.2017	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit/ financim i huaj Grant	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 3 OE b)S’kualifikuar: B. B, c) Kualifikuar: V. N. I.S & N. OE d)K.
11.Ankimime AK- ska;APP–s’ka;KPP-ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr datë_____	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga z. A. N., Specialist i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve (Jurist), z. B. H., me detyrë ish-Specialist i Sektorit të Infrastrukturës (Arkitekt), z. D. N., Specialist i Sektorit të Financës (Ekonomist). Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përllogaritjen e fondit.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike (KLLFLST) dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përllogaritjen e fondit.

a- Llogaritja e fondit limit: Në dosjen e prokurimit nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se si ka proceduar AK për të llogaritur fondin limit të prokuruar.

Projekt preventivi është hartuar nga shoqëria “K.” shpk, grupi i punës projektues ing. A. K. dhe ing. L. L., por pavarësisht sa sipër rezulton se projekti i zbatimit, relacioni teknik dhe projekt preventivi i depozituar në dosjen e prokurimit, janë të vulosura nga shoqëria por pa nënshkrimin e specialistëve të mësipërm të cilët kanë punuar dhe përllogaritur sa sipër. Për sa sipër ngarkohet me përgjegjësi titullari i AK z. N. R., për pranimin e dokumenteve të pa nënshkruara nga hartuesit e tyre si dhe përdorimin e tyre pa miratim të tij në cilësinë e titullarit të institucionit dhe hartuesit të kontratës së projektimit. Përveç se nuk janë miratuar prej tij, këto dokumente nuk kanë as edhe një dokument shoqëruar të hartuar nga punonjës të bashkisë ku të evidentohet fakti i vlerësimit të tyre dhe saktësisë të sa përllogaritur nga shoqëria “K.”

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 2, “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, në të cilën përcaktohet se: “Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato”.

Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT. Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

“Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

4.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO :

1. Certifikatë : (ISO 9001) Sistemi menaxhimit të cilësisë
 2. Certifikatë : (ISO 14001) Sistemi i menaxhimit të mjedisit
 3. Certifikatë : (ISO 18001) Sistemi i menaxhimit dhe sigurisë në punë.
 4. Certifikatë : (PAS 99:2012) Për sistemin menaxherial të integruar
 5. Certifikatë : (ISO 50001) Për sistemin e menaxhimit të energjisë.
 6. Certifikata :(ISO 3834) Për sistemin e të cilësisë në saldim.
 7. Certifikata : (ISO/IEC 27001) Për menaxhimin e sigurisë së informacionit.
 8. Certifikata : (ISO/IEC 27001) Për menaxhimin e përgjegjësisë shoqërore
 9. Certifikata : (ISO/IEC DS CEN/TR 15128) Për standardet për riparimin e sistemeve të kanalizimit dhe kullimit.
 10. Certifikatë: (DS CEN/TR 1452-1:2009) Për sistemet e tubacioneve plastike për furnizimin me ujë, kullimet dhe kanalizimet nëntokësore dhe mbitokësore nën presion
 11. Certifikatë: (ISO 28001) Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në zinxhirin e furnizimit.
- 4.2 Të ketë të punësuar me kontratë minimumi 2 (dy) specialistë të certifikuar për punime që do të kryhen në lartësi (IRATA ose ekuivalent me të) nga organe të certifikuara.

4.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë një Inxhinier që përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, i cili duhet të jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose privatë, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””.

- Për specialistin e kërkuar si më sipër, duhet të paraqitet :
- certifikata e trajnimit për sigurinë dhe shëndetin në punë e dhënë nga një organizëm i licencuar/certifikuar certifikimi shqiptar ose i huaj .

5. Operatori ekonomik/ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton se: për periudhën **Janar 2014 - Dhjetor 2014** ka të punësuar mesatarisht **70** Punëtorë, për periudhën **Janar 2015 - Dhjetor 2015** ka të punësuar mesatarisht **90** Punëtorë, për periudhën **Janar 2016- Dhjetor 2016** ka të punësuar mesatarisht **110** Punëtorë, si dhe për periudhën **Janar 2017 - Qershor 2017**, ka të punësuar jo me pak se **110** punonjës për secilin nga muajt e kërkuara duke përfshirë dhe stafin tekniko-menaxherial (inxhinieret dhe punonjësit e kualifikuar). Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë listpagesat e konfirmuara nga organet tatimore dhe vërtetim nga Administrata Tatimore.

Në lidhje me kriterin e fuqisë së punëtorisë për vitet 2014, 2015, 2016, të shtirë në kohë, në referim të nenit 26/8 pika b, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ky kriter nuk është pjesë e kriterëve të cilat shërbejnë për të vërtetuar eksperiencën të suksesshme pune të ngjashme apo besueshmërinë ekonomiko-financiare të OE, pasi janë kritere të tjera ato të cilat mundësojnë këtë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

6. Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisjet /kapacitet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës

Lista e Makinerive:

1-	Fadromë me goma (për gërmim)	copë 3	në pronësi ose me qira
2-	Kamion vetëshkarkues me 4 akse	cope 2	“
3-	Kamion vetëshkarkues me 2 akse	cope 2	“
4-	Kamion 5-7 Ton	cope 1	“
5-	Autobot Uji	cope 1	“
6-	Autovinç	cope 3	“
7-	Kamionçine deri 3.5 Ton	copë 4	“
8-	Autobetoniere	copë 2	“
9-	Auto pompë betoniere	copë 1	“
10-	MotoBetoniere	copë 3	“
11-	Miniekskavator	copë 2	“
12-	Rimorkiator me kapacitet mbajtës mbi 25 ton për lëvizje mjetë e pajisje	cope 1	
13-	Eskavator	cope 2	“
14-	Bobcat	cope 1	“
15-	Pompë suvatimi	copë 2	“
16-	Motogjenerator	copë 3	“
17-	Skela në m ² minim 1500 m ²		“
18-	Armaturë (dërrase ose panele) minim 1500 m ²		“
19-	Motosaldatriçe	copë 2	“
20-	Tokmak për ngjeshje	cope 1	“
21-	Matrapik	copë 3	“
22-	Karrocë tip karel për punime + foto	cope 1	“

Operatori ekonomik duhet të paraqesë për materialet si me poshtë :

7. Materialet dyer –alumin sipas preventivit të paraqesë:

8.1 Kontratë paraprake furnizimi me furnitorin për listën e mësipërme të mallrave shoqëruar me QKL. Kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

8.2 Certifikatën që vërteton se sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit / prodhuesve është sipas standardit ISO 9001:2008 ose ekuivalentë me të për listën e mësipërme të mallrave. E noterizuar ose origjinale.

8.3 Certifikata normativiteti EN 13830:2003 që vërteton që prodhuesi të garantojë që standardi i materialeve të jetë me përcjellshmëri termike jo më të vogël se $Ucë=1.15 \text{ } \ddot{\text{E}}/m^2k$ kalkulim i cili bëhet në bazë të EN ISO12631:2012 gjithashtu përshkueshmëria e ajrit 299 Pa ASTM E330-14, qëndrueshmëria ndaj ujit 718 Pa ASTM E331-00(09) dhe të përballojë presionere 4309 Pa ASTM E547-00(09).

9. Për ndriçimin

9.1 Kontratë paraprake furnizimi me furnitorin për listën e mësipërme të mallrave. Kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsitë, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

9.2 Certifikatën që vërteton që sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit / prodhuesve është sipas standardit ISO 9001:2008 ose ekuivalentë me të për listën e mësipërme të mallrave. E noterizuar ose origjinale.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

9.3 Certifikatë konformiteti që provon se pajisjet objekt prokurimi që ofron operatori ekonomik janë në përputhje me standardit europian: **EN 605981:2008+A11:2009**. *E noterizuar ose origjinale.*

9.4 Dëshmi të testimeve zyrtare të kryera, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara me standardet e kërkuara. *E noterizuar ose origjinale.*

10. Për Kaldaja

10.1 Kontratë paraprake furnizimi/Autorizim prodhuesi me furnitorin për listën e mësipërme të mallrave. Kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsitë, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

10.2 Certifikatën që vërteton që sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit / prodhuesve është sipas standardit ISO 9001:2008 ose ekuivalentë me të për listën e mësipërme të mallrave. *E noterizuar ose origjinale.*

10.3 Certifikatë/dokument të vlefshëm që provon se pajisjet objekt prokurimi që ofron operatori ekonomik janë në përputhje me direktivën 97/23/EC për enët në presion ose ekuivalentë.

10.4 Ofertuesi duhet të ketë servis të autorizuar nga prodhuesi ose kontratë me një servis të autorizuar nga prodhuesi të materialeve që do të instalohen duke e dëshmuar me kontratën përkatëse.

E noterizuar ose origjinale.

11. Për peme dekorative duhet të paraqesë:

11.1 Kontratë paraprake furnizimi me furnitorin për listën e mallrave. Kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsitë, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

11.2 Certifikatën që vërteton që sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit / prodhuesve është sipas standardit ISO 9001:2008 ose ekuivalentë me të për listën e mësipërme të mallrave. *E noterizuar nga origjinali.*

11.3 Licence të tipit II.4 dhe III.7.A të lëshuar nga QKL.

12. Matërialet e ndërtimi sipas preventivit të paraqesë:

12.1 Kontratë paraprake furnizimi me furnitorin për listën e mësipërme të mallrave. Kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsitë, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

12.2 Certifikatën që vërteton që sistemi i menaxhimit të cilësisë së prodhuesit / prodhuesve është sipas standardit ISO 9001:2008 ose ekuivalentë me të për listën e mësipërme të mallrave. *E noterizuar ose origjinale.*

12.3 Certifikatën që provon se materialet objekt prokurimi që ofron operatori ekonomik janë në përputhje me aneksin III të rregullores (EU) 305/2011 ose ekuivalentë me të për listën e mësipërme të mallrave. *E noterizuar ose origjinale.*

12.4 Për materialet që do të përdoren në objekt ofertuesi duhet të ketë një kontratë me një laborator të licencuar për të bërë provat laboratorike për materialet dhe laboratorin të posedojë:

- Certifikate akreditimi nga Drejtoria e Përgjithshme e akreditimit
- Certifikate S SH ISO 14001, OHSAS 18001 dhe ISO 9001 në fushën e certifikimit laborator për testimin e materialeve të ndërtimit

Dhe të paraqitën fotografi dhe fatura tatimore dhe/ose deklarata zhdoganimit për aparatet që disponon laboratorin.

13. Për Bojërat



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

13.1 *Kontratë paraprake furnizimi me furnitorin për listën e mësipërme të mallrave. Kontrata duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsitë, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*

13.2 *Certifikatën qe vërteton se sistemi i menaxhimit të cilësisë se prodhuesit / prodhuesve është sipas standardit ISO 9001:2008 ose ekuivalentë me të për listën e mësipërme të mallrave. E noterizuar ose origjinale.*

13.3 *Certifikatën qe provon se materialet objekt prokurimi qe ofron operatori ekonomik janë ne përputhje me aneksin III të rregullores (EU) 305/20011 iso 9514:2005. E noterizuar ose origjinale*

14. Për Pllakat

14.1 *Kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar për listën e mësipërme të mallrave. Kontrata duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsitë, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*

14.2 *Certifikatën qe vërteton se sistemi i menaxhimit të cilësisë se prodhuesit / prodhuesve është sipas standardit ISO 9001:2008 ose ekuivalentë me të për listën e mësipërme të mallrave. E noterizuar ose origjinale.*

15. Për hidrosanitaret:

15.1 *Kontratë paraprake furnizimi me furnitorin për listën e mësipërme të mallrave. Kontrata duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsitë, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*

15.2 *Certifikatën qe vërteton se sistemi i menaxhimit të cilësisë se prodhuesit / prodhuesve është sipas standardit ISO 9001:2008 ose ekuivalentë me të për listën e mësipërme të mallrave. E noterizuar ose origjinale.*

16 . Për Beton:

Kontratë furnizimi ne prani të noterit me Fabrika qe prodhon beton të shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë, Planvendosjen e nyjes, **lejen Kodi III.1.B** lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit ose leja mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit.

Nga auditimi rezulton se :

Në lidhje me kriteret e sipërcituara, në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kriterë kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç sine qua non për hartimin dhe vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimeve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar, ditëve të punës të kërkuara për realizimin e kontratës si edhe kategorizimit të pikave të licencës, mjeteve dhe kontratave paraprake të furnizimit, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e shumë prej tyre.

Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Po ashtu, lidhur me kërkesat për kontrata furnizimi dhe certifikata konformiteti, Njësia e hartimit të DST, nuk ka kërkuar që OE i cili do të shpallet fitues të paraqes në përfundim të objektit jo vetëm kontratat por edhe certifikatat e konformitetit, cka tregon se kriteret janë vendosur vetëm për të kufizuar pjesëmarrjen në prokurim dhe jo për të garantuar cilësinë e objektit. Nëse nga NJP,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

do të ishte vlerësuar maksimalisht kjo gjë, atëherë detyrimisht në DST duhet të ishte vendosur dhe përcaktimi i detyrimit të OE të shpallur fitues që pjesë të dosjes së prokurimit (krahas dokumenteve shoqëruese të kontratës) duhet të paraqesë dhe detyrimisht kontratat e furnizimit dhe certifikatat përkatëse të cilësisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1, 2, 20 dhe 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP si hartues të tyre si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor si miratuesi i kriterëve.

Përsa më sipër NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhe nenin 26 të VKM 797 nr. 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi kërkesa të tilla sjellin si pasojë ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskriminim të kandidateve. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht z. A. N. z. B. H. dhe z. D. N..

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z. K. K., me detyrë Administrator i Njësisë Burrel, z.E. Ç., me detyrë Specialist i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe znj. B. K., me detyrë Specialistë e Sektorit të Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO.

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.

Nga vlerësimi rezulton se janë s’kualifikuar një operatorë ekonomik dhe kualifikuar dy operator, BOE “V. N. I.S & N.” Shpk i cili është shpallur fitues.

Kualifikimet dhe s’kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

OPERATORËT EKONOMIK PJESËMARRËS

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s’kualifikuar	Klasifikimi
1	1.V. N. I.S & N. shpk	61 580 780	Kualifikohet	61580 780
2	2. K.	61 771 210	Kualifikohet	61 771 210
3	3. B.B	52 247 126	S’kualifikohet	52 247 126

Janë s’kualifikuar:

Janë s’kualifikuar ofertuesit :

1. **B.B sh.p.k**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

MUNGON Certifikatë: (DS CEN/TR 1452-1:2009) Për sistemet e tubacioneve plastike për furnizimin me ujë , kullimet dhe kanalizimet nëntokësore dhe mbitokësore nën presion

Certifikatë : (ISO 28001) Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në zinxhirin e furnizimit.

Drejtues Teknik , Inxhinier Topograf 1 nje

Për periudhën **Janar 2015 - Dhjetor 2015** ka të punësuar mesatarisht **56** punonjës në DST kërkohen 90 punonjës.

Vërtetim të lëshuar nga Bashkia Mat që konfirmon se operatori ekonomik nuk ka asnjë lloj detyrimi të mundshëm kundrejt Bashkisë Mat dhe Njësisë Administrative në varësi, përcaktuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV "Bashkia Mat"

sipas Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Taksat Vendore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar (çdo anëtar i bashkimit të operatoreve ekonomike).

Mungon një karroce tip karel për punime.

Nuk ka paraqitur kontratë me një laborator të licencuar për të bere provat laboratorike për materiale.

Nuk ka paraqitur kontratë furnizimi për kaldaja për DST.

Faromë me goma që shënohen në regjistrat publik nuk janë të pajisur në leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik dhe sigurimit të mjeteve.

Kontratë paraprake furnizimi me furnitorin person fizik T. M. H. për peme dekorative nuk ka paraqitur Licence të tipit II.4 dhe III.7.A të lëshuar nga QKL.

Mungon 2(dy) Autovinç sipas kërkesave të DST.

Nuk ka paraqitur vërtetim të gjendjes financiare, nga një ose me shume banka ku vlera ne lek(apo ekuivalentja ne valutë) ne llogarinë e operatorit të jetë jo me të vogël se 10% të fondit limit, të lëshuar jo me shume se 5 ditë nga data e hapjes se ofertave. Vërtetimi i datë 23.08.2017 është jashtë afatit të kërkuar.

Nuk ka të punësuar punonjës të kualifikuar me dëshmi sipas DST konkretisht 2 punonjës për konstruksione metalike dhe 2 specialistë ndërtimi.

Kontratë paraprake furnizimi me furnitor person fizik A. C. për material dyer-alumin nuk është e shoqëruar me QKL, ISO 9001:2008 ose ekuivalentë si dhe Certificate normativiteti EN 13830:2003 që vërteton që prodhuesi të garantoje që standardi i materialeve të jetë me përcjellshmëri jo më të vogël se $Uc=1.15 \text{ E}/m^2k$ kalkulim i cili bëhet në bazë të EN ISO12631:2012 gjithashtu përshkueshmëria e ajrit 299 Pa ASTM E330-14, qëndrueshmëria ndaj ujit 718 Pa ASTM E331-00(09) dhe të përballojë presion ere 4309 Pa ASTM E547-00(09).

Kontratë paraprake furnizimi me furnitorin person fizik F. T. për materialet e ndriçimit nuk është e shoqëruar me standardin ISO 9001:2008 ose ekuivalentë dhe Certifikatë konformitetiti që provon se pajisjet objekt prokurimi që ofron operatori ekonomik janë në përputhje me standardin europian **EN 605981: 2008+A11:2009**.

OE e kualifikuar

Në lidhje me OE e Kualifikuar dhe të shpallur fituese "V. N. I.S & N." sh.p.k nga auditimi rezulton se ky BOE ka këto mangësi:

NëDST është kërkuar:

1.Pika 5.3 e kërkesës së DST, kërkon nga operatorët që të paraqesin 2 teknik ndërtimi dhe 3 manovratorë të pajisur me certifikatë nga IQT.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nga 2 teknik ndërtimi, njëri nuk ka certifikatën e lëshuat nga IQT, dhe për 3 manovratorët rezulton se asnjëri prej tyre nuk posedon certifikatën e lëshuar nga IQT.

2.Pika 5.5 e kërkesës së DST sipas të cilës operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 20 punonjës të kualifikuar me kualifikime teknike nga IQT ku të paktën:

- 4 punonjës elektrikist
- 4 punonjës hidraulik
- 2 punonjës konstruksione metalike
- 1 punonjës montator
- 2 punonjës elektromekanik
- 2 punonjës saldator
- 1 karpentier
- 4 specialist ndërtimi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

-Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se operatorët fitues nuk kanë paraqitur listën e punonjësve të mësipërm me kualifikime teknike të certifikuara nga IQT sipas kërkesës së DST. Konkretisht nga 4 elektrikist të kërkuar, 2 nuk kanë certifikatën e IQT. Nga 4 hidraulik të kërkuar, 2 prej tyre nuk kanë certifikatën e lëshuar nga IQT. Nga 2 punonjës të kërkuar për konstruksione metalike, të dy janë pa IQT. Nga 2 punonjës saldatorë, të 2 janë pa IQT. Për 1 karpentier të kërkuar, rezulton të jetë pa IQT, si dhe për 4 specialist ndërtimi, të 4-rt janë pa IQT.

3.Pika 8.3 e kërkesës së DST për dyert e aluminit kërkon që subjekti të paraqesë nga operatorët certifikata normativiteti EN 13830:2003 që vërteton që prodhuesi të garantojë që standardi i materialeve të jetë me përcjellshmëri termike jo më të vogël se $Uc\dot{e}=1.15 \text{ \ddot{E}/m}^2\text{k}$ kalkulim i cili bëhet në bazë të EN ISO12631:2012 gjithashtu përshkueshmëria e ajrit 299 Pa ASTM E330-14, qëndrueshmëria ndaj ujit 718 Pa ASTM E331-00(09) dhe të përballojë presion ere 4309 Pa ASTM E547-00(09).

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se operatori i kualifikuar dhe shpallur fitues nuk e ka paraqitur certifikatën e normativitetit EN 13830:2003 që vërteton që prodhuesi të garantojë që standardi i materialeve të jetë me përcjellshmëri termike jo më të vogël se $Uc\dot{e}=1.15 \text{ \ddot{E}/m}^2\text{k}$ kalkulim i cili bëhet në bazë të EN ISO12631:2012 gjithashtu përshkueshmëria e ajrit 299 Pa ASTM E330-14, qëndrueshmëria ndaj ujit 718 Pa ASTM E331-00(09) dhe të përballojë presion ere 4309 Pa ASTM E547-00(09), si dhe i gjithë dokumentacioni i kontraktuar nga furnizuesi nuk është i noterizuar dhe është në gjuhën angleze i pa përkthyer.

4.Pika 9.3 e kërkesës së DST për ndriçimin kërkon nga operatorët që të paraqesin nga furnizuesi certifikatë konformiteti qe provon se pajisjet objekt prokurimi qe ofron operatori ekonomik janë ne përputhje me standardit europian: **EN 605981:2008+A11:2009**. *E noterizuar ose origjinale.*

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se certifikata e paraqitur nga furnitori me standardet e kërkuara, është në gjuhën franceze, e pa përkthyer dhe me vulë të palexueshme noterizimi.

5.Pika 10.3 dhe 10.4 e kërkesës së DST në lidhje me kontratën për kaldajën kërkohet që operatori të paraqesë nga furnitori certifikatë/dokument të vlefshëm qe provon se pajisjet objekt prokurimi qe ofron operatori ekonomik janë në përputhje me direktivën 97/23/EC për enët në presion ose ekuivalentë. (10.3)

Ofertuesi duhet të ketë servis të autorizuar nga prodhuesi ose kontratë me një servis të autorizuar nga prodhuesi të materialeve që do të instalohen duke e dëshmuar me kontratën përkatëse.

E noterizuar ose origjinale. (10.4)

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se operatori fitues ka paraqitur kontratat me furnitorin për certifikatën në përputhje me direktivën 97/23/EC si dhe për servisin e autorizuar të pa përkthyer. Ato janë përgjithësisht në gjuhën angleze, gjermane dhe turke.

6.Pika 12.4 e kërkesës së DST kërkon nga operatori fitues të paraqesë kontratë furnizimi për materialet që do të përdoren ne objekt të cilat duhet të ketë një kontratë me një laborator të licencuar për të bërë provat laboratorike për materialet dhe laboratorit të posedojë:

- Certifikate akreditimi nga Drejtoria e Përgjithshme e akreditimit
- Certifikate S SH ISO 14001, OHSAS 18001 dhe ISO 9001 në fushën e certifikimit laborator për testimin e materialeve të ndërtimit

Dhe të paraqitën fotografi dhe fatura tatimore dhe/ose deklarata zhdoganimit për aparatet që disponon laboratorit.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se edhe për këtë pikë të kërkesës së DST, operatori fitues ka paraqitur kontratën për provat laboratorike me dokumentet teknike në gjuhën italiane dhe të pa përkthyer.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

7.Pika 6 e kërkesës së DST e cila kërkon nga operatori fitues që të paraqesë dokumentacion që vërteton se:

për periudhën **Janar 2014 - Dhjetor 2014** ka të punësuar mesatarisht **70** punëtorë,
për periudhën **Janar 2015 - Dhjetor 2015** ka të punësuar mesatarisht **90** punëtorë,
për periudhën **Janar 2016- Dhjetor 2016** ka të punësuar mesatarisht **110** punëtorë,
si dhe për periudhën **Janar 2017 - Qershor 2017**, ka të punësuar jo më pak se **110** punonjës për secilin nga muajt e kërkuara duke përfshirë dhe stafin tekniko-menaxherial (inxhinierët dhe punonjësit e kualifikuar). Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë listpagesat e konfirmuara nga organet tatimore dhe vërtetim nga Administrata Tatimore.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se operatori fitues nuk e ka plotësuar këtë kriter për vitet 2014, 2015, 2016 pasi operatorët ekonomik nëpërmjet bashkimit të tyre synojnë që të bashkojnë kapacitetet e tyre dhe eksperiencat në punë dhe nuk mund të konsiderohet bashkim i kapaciteteve njerëzore për vitet e kaluara por vetëm në atë aktual që ka lidhje me procedurën që prokurohet. Kështu që operatorët e plotësojnë nëpërmjet bashkimit të tyre numrin 110 punonjës për vitin 2017 por ky bashkim nuk mund të shtrijë efektet për fuqinë punëtore për vitet e kaluara. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se dosja e operatorëve fitues e dorëzuar pranë sektorit juridik dhe të prokurimeve, është e pa inventarizuar dhe mungojnë të gjitha kontratat e furnizimit me të cilët operatori fitues ka kryer me subjektet që ofrojnë produktet ose shërbimet e tyre për qëllimin e kësaj procedure prokurimi, veprime për të cilat ngarkohet me përgjegjësi z. N. R., në cilësinë e Titullarit të AK dhe nënshkruesit të kontratës. Mos pasja e dokumenteve bashkëlidhur nuk dokumenton dhe njëherazi nuk lejon vërtetimin/konfirmimin mbi ekzistencën reale dhe saktësinë e tyre në formë e përmbajtje, përse nuk janë pjesë e dosje së prokurimit dhe kontratës përkatëse, veprime në kundërshtim me LPP, si dhe shumë ndër arsytet e s’kualifikimit të OE me ofertë më të ulët është pikërisht për mungesë të këtyre dokumenteve të kërkuara në DST.

Dokumentet që ka paraqitur BOE “V. N. I.S & N.” Shpk nuk plotësojnë kërkesat e DST dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “V. N. I.S & N.” Shpk, që është edhe oferta me vlerë më të lartë ekonomike e paraqitur. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. K. K. në cilësinë e kryetarit të KVO z. E. Ç. dhe znj. B. K., në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. N. R.

-Në lidhje me OE e Kualifikuar por jo të shpallur fituese “K.” sh.p.k (oferta më e lartë e s’kualifikuar), nga auditimi rezulton se ky OE është kualifikuar në kushtet kur mungojnë më shumë se gjysma e dokumentacionit të kërkuar nga AK në DST, pra nuk kuptohet përse KVO ka kualifikuar një OE i cili dukshëm nuk plotëson kriteret.

KVO ka vepruar në kundërshtim me pikën 5, të nenit 53 “*Shqyrtimi i ofertave*” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar ku citohet “*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit*”, si dhe pikës 2 të nenit 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*”, ku citohet “*Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit*”. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi **KVO, z. K. K. në cilësinë e kryetarit të KVO, z. E. Ç. dhe znj. B. K., në cilësinë e anëtarëve të KVO.**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anulim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO të përbërë nga K. K., E. Ç. dhe B. K.

Mos plotësimi i kushteve nga OE i shpallur fitues dhe s’kualifikimi nga KVO i OE me ofertë më të ulët, për mos plotësim të kriterëve të DST, ka sjell për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet për vlerën prej **61,819,330 lekë pa tvsh**, (vlera e shpallur fituese e cila përkon edhe me ofertën ekonomike më të lartë të paraqitur), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797 datë 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Oferta më e ulët ekonomike pas ofertës së shpallur fituese rezulton ajo e shoqërisë “B. B” Shpk për vlerën prej 52,247,126 lekë pa tvsh ose më pak se oferta fituese në vlerën prej 9,333,654 lekë, më e ulët se sa ajo e operatorit ekonomik të kualifikuar dhe shpallur fitues. Oferta e këtij operatori është ndjeshëm më e ulët se sa ajo fituese dhe pjesa më e madhe e shkaqeve të s’kualifikimit të saj vjen nga kriteret e paargumentuara të Njesisë së Prokurimit dhe kjo ka sjellë shpenzime në kundërshtim me parimin e 3E-ve, pasi edhe operatori fitues nuk plotëson kushtet e përcaktuara nga Njësia e Prokurimit për fitimin e kësaj kontratë.

Lidhur me administrimin e dokumentacionit të kontratës dhe marrjes në dorëzim të objektit, sipas urdhrat 408, datë 26.12.2018, pas përfundimit të tij, rezulton se grupi i marrjes në dorëzim përbëhet edhe nga anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Njesisë së Prokurimit të kësaj procedure, konkretisht kryetari i KVO z. K. K., anëtarë i NjP A. N., si dhe A. M.. Grupi i marrjes në dorëzim, në cilësinë edhe të pjesëtarëve të KVO dhe NJP, duhet të kishin kërkuar nga OE që pjesë të dosjes së zbatimit të përfshiheshin kontratat e furnizimit dhe certifikatat e cilësisë së materialeve. Këto dokumente jo vetëm që nuk janë kërkuar, por as nuk rezultojnë pjesë e dosjes së prokurimit dhe zbatimit, pasi nuk janë paraqitur nga OE i shpallur fitues.

Theksojmë se ky qëndrim i KVO dhe grupit të marrjes në dorëzim është kontradiktor, përse OE me ofertë më të ulët “B. B” është skualifikuar pikërisht për shkak të mos plotësimit të këtyre kriterëve të përcaktuara në DST.

Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Rikonstruksion i kanalit vaditës fshati Derjan (i pjesshëm)”.

Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjisllacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në përcaktimin e kriterëve dhe përzgjedhjen e ofertës fituese
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik u konstatua vendosja e kriterëve kualifikuese jo plotësisht në përputhje me natyrën e investimit, dhe në vlerësimin e ofertës fituese u konstatua se OE i shpallur fitues nuk i përmbush plotësisht ato, dhe pavarësisht mangësive është vlerësuar dhe shpallur fitues, për të njëjtat mangësi si dhe OE me ofertë ekonomike më të leverdisshme.
Kriteri:	Legjisllacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të shërbimit (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e mallrave të ofruara
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I Lartë.
Rekomandime:	Të merren masa për analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përzgjedhjen e OE fitues me ofertë më të lartë dhe skualifikimin e OE me ofertë më të ulët, dhe shpërblimin e dëmit ekonomik prej 2,743,534 lekë si diferencë ndërmjet dy ofertave ekonomike asaj të skualifikuar “BE-IS” shpk dhe ofertës së shpallur fituese “Vllaznia Ndërtim IS &N” shpk.

Në mënyrë të përmbledhur të dhëna për tenderin jepen në tabelën e mëposhtme:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rikonstruksion i kanalit vaditës, fshati derjan (i pjesshëm”		
1.Urdhër Prokurimi NR. 120. DATE 31.03.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 53 , dt.17.02.2017	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 54 dt. 17.02.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Hapur ”	A. N. Kryetare/ Jurist E. Ll. Anetar/Ing.Ndertimi E. R. Anetare/ekonomistë	P. M. KRYETAR Ing. E. K. anetare Juristë D. T. anetare Ekonomistë.
5.Fondi Limit (pa tvsh) : 16 666 666 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 16,458,763lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 207 903 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 29.05.2017	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit/ financim i huaj Grant	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 6 OE a)S’kualifikohet B.- I. b) S’kualifikohet K. c) S’kualifikohet E. d) S’kualifikohet Sh. e)Kualifikohet V. N. I.S f) S’kualifikohet E.
11.Ankimime AK- ka;APP-s’ka; KPP-ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr1706datë07.07.2017	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga z. A. N., Specialist i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve (Jurist), z. E. Ll., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës, Emergjencia dhe Pronave (Arkitekt), zj. E. R., me detyrë ish-Specialistë e Sektorit të Bujqësisë dhe Pyjeve (Ekonomist).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogaritjen e fondit.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike (KLLFLST) dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogaritjen e fondit.

a- Llogaritja e fondit limit: Në dosjen e prokurimit nuk ka asnjë dokument që të vërtetoje se si ka proceduar AK për të llogaritur fondin limit të prokuruar.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 2, “Hartimi i dokumenteve të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

tenderit”, në të cilën përcaktohet se: “Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato”.

Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.

Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

”Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specififikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatat ISO :

1. Certifikatë: (ISO 9001) Sistemi menaxhimit të cilësisë
2. Certifikata (ISO 3834) Për sistemin e të cilësisë në saldim
3. Certifikatë: (DS CEN/TR 1452-1:2009) Për sistemet e tubacioneve plastike për furnizimin me ujë, kullimet dhe kanalizimet nëntokësore dhe mbitokësore nën presion
4. Certifikatë: (ISO 28001) Për sistemin e menaxhimit të sigurisë në zinxhirin e furnizimit.
5. Certifikatë: (BS EN 13331-1:2002) Për sistemet për veshjen e kanaleve
6. Certifikatë: (ISO 14001) Sistemi i menaxhimit të mjedisit

Lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qellim. Certifikatat kërkohet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rast bashkimi operatorësh çdo operator duhet të paraqesë Certifikatat e mësipërme. Certifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

2.3.3 Numri mesatar i punonjësve të siguruar në një vit kalendarik duhet të jetë jo më pak se **75 punonjës** për periudhën Janar 2014 deri Shkurt 2017. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në staf teknik të punësuar, të vërtetuar me kontratë noteriale pune me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt si dhe, diplomë, CV, Librezat e punës, Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik dhe të figurojnë në listëpagesa (për vitin e fundit) si më poshtë :

- Inxhinier ndërtimi, (2 dy)
- Inxhinier hidroteknik, (1 një)
- Inxhinier mekanik, 1 një)
- Inxhinier topograf, (1 një)

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (Gjashtë) muajt e fundit. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, librezë pune, diplomën përkatëse. (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (Gjashtë) muajt e fundit. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve si më lart.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Operatori Ekonomik duhet të paraqes një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertueses inxhinieret e deklaruar ne kërkesën 2.3.4 për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontratë dhe nuk janë të angazhuara ne kontrata të tjera.

2.3.8 Deklaratë e disponueshmerisë se makinerive, sipas shtojcës 9. Operatori ekonomik duhet të disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka ne dispozicion të cilat janë si me poshtë vijon:

Nr	Lloji I makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamiona, kapaciteti total mbajtës minimumi 15 ton	në pronësi ose me qira	copë	min 3
2	Rimorkiator per transportimin e mjeteve të renda	në pronësi ose me qira	copë	1
3	Motogjeneratorë	në pronësi ose me qira	copë	2
4	Fadromë me goma	në pronësi ose me qira	copë	3
5	Ekskavator me zinxhir	në pronësi ose me qira	copë	1
6	Miniekskavator	në pronësi ose me qira	copë	1
7	Kamionçine	në pronësi ose me qira	copë	4
8	Betoniere	në pronësi ose me qira	copë	4
9	Vibrator	në pronësi ose me qira	copë	4
10	Pompë uji	në pronësi ose me qira	copë	2
11	Tokmak për ngjeshje dheu	në pronësi ose me qira	copë	1
12	Matrapik	në pronësi ose me qira	copë	2
13	Kompresor	në pronësi ose me qira	copë	1
14	Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	copë	2
15	Saldatriçe	në pronësi ose me qira	copë	1
16	Makineri për veshjen e kanalit me beton (Të shoqërohet me foto)	në pronësi ose me qira	copë	1

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitët dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme) si dhe certifikatën e transportit, leje transporti, licence transporti të lëshuara nga autoritetet përkatëse. Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqitën dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qira të paraqitët kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Deklaratë nga kompania ofertuese që makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar ne procedurat të shpallura fitues ne procedura të tjera. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qira me qellim verifikimi).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Nga auditimi rezulton se :

Në lidhje me kriteret e sipërcituara, në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kriterë kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç sine qua non për hartimin dhe vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimeve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar, ditëve të punës të kërkuara për realizimin e kontratës si edhe kategorizimit të pikave të licencës, mjeteve apo pajisjeve të punës, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e shumë prej tyre.

Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP si hartues të tyre.

Përsa më sipër NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenin 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhe nenin 26 të VKM 797 nr. 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi kërkesa të tilla sjellin si pasojë ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskriminim të kandidatëve. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht z. A. N., z. E. L. i dhe zj. E. R..

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z. P. M., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, zj. E. K., me detyrë ish-Specialiste e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj. D. T., me detyrë Specialistë e Sektorit të Financës (ekonomistë), në cilësinë e anëtarit të KVO.

KVO ka nënshkruar formularin e deklaramentit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.

Fillimisht për këtë procedurë rezulton se KVO e përbërë nga P. M., E. K. dhe D. T. ka vlerësuar se asnjëri prej OE pjesëmarrës në procedurë nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DST, duke i propozuar titullarit të AK, anulimin e procedurës dhe ribërjen e saj, kjo sipas raportit përmbledhës të datës 12.06.2017, drejtuar Titullarit të AK.

Pas kësaj më datë 15.6.2017, administruar nga Bashkia Mat me nr. 1523, datë 19.6.2017, OE “**V. N. I.S & N.**”, shpk, ka paraqitur ankim pranë AK. Pas kësaj titullari i AK me urdhrin nr. 308, datë 29.06.2017 ka ngritur komisionin e verifikimit të afateve të ankesës së subjektit, i përbërë nga E. B., K. K. dhe D. N., të cilët me vendimin nr. 09, datë 03.0.2017, ka vlerësuar se ankesa e OE është brenda afateve ligjore, duke i propozuar Titullarit të AK, vijim e procedurave të vlerësimit, pasi ankesa ka rezultuar në përputhje të plotë me ligjin dhe brenda afateve ligjore.

Pas kësaj nga Titullari i AK është ngritur komisioni i shqyrtimit të anekses të OE “**V. N. I.S & N.** shpk”, i përbërë nga B. H. (ing), J. K. (ekonomist) dhe E. Ç. (jurist), sipas urdhrit të Titullarit të AK nr. 320, datë 04.07.2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Komisioni, me relacion-vendimin nr. 1706, datë 07.07.2017 drejtuar Titullarit të AK, ka vlerësuar, ndryshe nga KVO, duke argumentuar se OE plotëson kërkesat e DST, dhe, OE nuk i mungojnë dy licenca dhe se certifikatat ISO janë rregullta, si dhe duke i e konsideruar ankesën e OE të drejtë dhe duke e pranuar atë. Komisioni ka vlerësuar se mbështetur në nenin 46/1/b dhe nenin 63 të LPP si dhe nenin 78 të VKM nr. 914, të pranojë ankesën e OE duke e quajtur të padrejtë s’kualifikimin e BOE. Vendimi është nënshkruar vetëm nga J. K. dhe E. Ç., ndërsa nuk është nënshkruar nga kryetari i komisionit, B. H., pasi më parë me relacion-vendimin nr. 1708, datë 10.7.2017, drejtuar Titullarit të AK, ka vendosur: *“Unë personalisht pasi u njoha me dokumentacionin e kam të pamundur juridikisht e profesionalisht për të gjykuar këtë procedurë tenderimi, për të shqyrtuar dokumentacionin në fjalë”*.

Nga vlerësimi rezulton se janë s’kualifikuar pesë operatorë ekonomik dhe kualifikuar një operator, BOE “V. N. I.S & N.” Shpk i cili është shpallur fitues. Kualifikimet dhe s’kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s’kualifikuar	Klasifikimi
1	B.- I.	13715229	S’kualifikohet	
2	K. & C. R. 2008	12,564,746	S’kualifikohet	
3	E. & S.	16,431,032	S’kualifikohet	
4	Sh.	12,839,242	S’kualifikohet	
5	V. N. I.S & N.	16,458,763	Kualifikohet	16,458,763
6	E.	16,658,253	S’kualifikohet	

Janë s’kualifikuar ofertuesit:

1. B.- I. sh.p.k

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

a. 1.Nuk plotëson numrin e punonjësve (kriter ky i vendosur ne DST)

2. K. & C. R. 2008 sh.p.k

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

b. 1.Mungon makineria për veshje betoni

c. 2.Mungon Certifikata ISO 28001

d. 3.2.Mungon Certifikata ISO 13331

e. 4.Mungon numri I punonjësve për vitin 2014-2015

f. (kriteret këto të vendosura ne DST)

3. E. & S. sh.p.k

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

g. 1.Mungon makineria për veshje betoni

h. 2.Mungojne Certifikatat ISO

i. 3.Mungojne licencat

j. (kriteret këto të vendosura ne DST)

4. Sh. sh.p.k

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

k. 1.Mungon makineria për veshje betoni

5.E. sh.p.k



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- l. 1.Mungojne deklaratat*
- m. 2.mungon vërtetimi nga banka për gjendjen financiare*
- n. 3.mungojne certifikatat ISO*
- o. 4.mungojne punonjësit e specializuar*
- p. 5.mungojne makineritë*
- q. 6.mungojne mjetet e sigurimit teknik ne pune*

OE e kualifikuar

Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe të shpallur fituese “V. N. I.S & N.” sh.p.k nga auditimi rezulton se ky BOE ka këto mangësi:

Ne dst është kërkuar

1.Pika 2.3.4 e kërkesës së DST e cila kërkon që Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (Gjashtë) muajt e fundit. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, librezë pune, diplomën përkatëse. (Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (Gjashtë) muajt e fundit. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve si më lart.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se mjeku i kontraktuar nga operatori V. N. shpk, ka lejen individuale për ushtrimin e profesionit me datë të paverifikueshme, çka nuk vërteton afatin e fillimit të vlefshmërisë së saj.

2.Pika 2.3.4 e kërkesës së DST kërkon që Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në staf teknik të punësuar, të vërtetuar me kontratë noteriale pune me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt si dhe, diplomë, CV, Librezat e punës, Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik dhe të figurojnë në listëpagesa (për vitin e fundit) si më poshtë:

- Inxhinier ndërtimi, (2 dy)
- Inxhinier hidroteknik, (1 një)
- Inxhinier mekanik,(1 një)
- Inxhinier topograf, (1 një)

Në rast bashkimi operatorësh çdo operator duhet të paraqesë nje koordinator për realizimin e punimeve qe do realizoj. Certifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se inxhinieri i ndërtimi i operatorit N. shpk G. D. ka dëshminë e sigurimit teknik jashtë afateve të vlefshmërisë pasi afati i saj skadon me 17.02.2017 pra 3 muaj para hapjes së tenderit.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se inxhinieri topograf i operatorit N. shpk Sh. L. ka dëshminë e sigurimit teknik jashtë afateve të vlefshmërisë pasi afati i saj skadon me 11.05.2017, pra 3 javë para hapjes së tenderit.

-Për inxhinierit e tjerë të kërkuar nga DST, mungon dëshmia e sigurimit teknik në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori fitues.

3.Pika 12.3.8 e DST e cila kërkon nga operatori të paraqesë makineri për shtrimin me beton, rezulton të jetë kërkesë e argumentuar dhe e trajtuar në mënyrë të pasaktë pasi ky kriter është përdorur për s’kualifikimin e thujse gjithë operatorëve, ndërkohë që edhe operatori fitues nuk ka paraqitur një makineri të tillë dhe njëkohësisht edhe termi i përdorur është i gabuar pasi ato janë më shumë pajisje ose armatura për shtrimin e betonit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Pika 2.3.3 e DST që kërkon nga operatorët që të kenë mesatarisht 75 punonjës nga Janari 2014 deri Shkurt 2017, rezulton të jetë kriter i vendosur në mënyrë të padrejtë tek kapaciteti teknik pasi numri i punonjësve i shtrirë në kohë nuk përcakton kapacitetin dhe eksperiencën e operatorit, dhe njëkohësisht operatorët fitues nuk e plotësojnë asnjëri këtë kriter pasi në vitin 2014 e në vijim asnjëri prej tyre nuk ka pasur mesatarisht 75 punonjës në vit por vetëm se bashku, dhe ky kriter duhej të konsiderohej i paplotësuar nga KVO pasi qëllimi i bashkimit të operatorëve është bashkimi i kapaciteteve dhe eksperiencave për të plotësuar kushtet dhe kriteret dhe jo bashkimin e fuqisë punëtore në të shkuarën.

-Oferta e operatorit ekonomik B.- I. shpk është 13,715,229 pa tvsh ose 2,743,534 lekë pa tvsh me e ulët se sa oferta e operatorit fitues. Ky operator është s’kualifikuar vetëm për pikën 2.3.3 të DST e cila kërkon që të ketë të punësuar mesatarisht 75 punonjës nga Janari i vitit 2014 deri në Shkurt të vitit 2017, kriter i cili është i paargumentuar për kapacitetin teknik të subjekteve pjesëmarrëse në tender dhe nuk duhej të përcaktohej si i tillë nga Njësia e Prokurimit. Njëkohësisht, KVO në vlerësim të kësaj pike e ka vlerësuar gabim operatorin fitues, pasi për vitet 2014, 2015, dhe 2016, asnjëri nga operatorët fitues nuk e plotësonte këtë kriter pra të ketë mesatarisht 75 punonjës në vit. Këtë kriter ata e plotësojnë vetëm për vitin 2017, vit në të cilin është prokuruar kontrata dhe shtrin efektet bashkimi i operatorëve duke i dhënë fuqi edhe bashkimit të kapaciteteve punëtore, ndërkohë operatori B.-I. shpk me përjashtim të vitit 2014, të gjitha vitet tjera e plotësonte e vetme kapacitetin prej mesatarisht 75 punonjës në vit.

Kualifikimi i padrejtë i BOE “V. N. I.S.” dhe “N.” shpk, dhe s’kualifikimi i padrejtë i OE “B.-I.” shpk, ka sjellë një dëm ekonomik prej 2,743,534 lekë për buxhetin e shtetit.

Dokumentet që ka paraqitur BOE “V. N. I.S.” dhe “N.” Shpk, nuk plotësojnë kërkesat e DST dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “V. N.” dhe “N.” Shpk, që është edhe oferta me vlerë më të lartë ekonomike e paraqitur. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi Komisioni i vlerësimit të ofertave (ankesës) i përbërë nga z. J. K. dhe z. E. Ç., në cilësinë e anëtarëve të KVO.

KVO ka vepruar në kundërshtim me pikën 5, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”, si dhe pikës 2 të nenit 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, ku citohet “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit”. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi z. J. K. dhe z. E. Ç., në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Verifikimit të Ankesës.

Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anulim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit” dhe ngarkon me përgjegjësi z. J. K. dhe z. E. Ç., në cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Verifikimit të Ankesës.

Mos plotësimi i kushteve nga OE i shpallur fitues dhe s’kualifikimi nga KVO i OE me ofertë më të ulët, për mos plotësim të kriterëve të DST, ka sjellë për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet për vlerën prej **16,458,763 lekë pa tvsh**, (vlera e shpallur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

fituese e cila përkon edhe me ofertën ekonomike më të lartë të paraqitur), si dhe dëm ekonomik nga s’kualifikimi i padrejtë (për mungesë të të njëjtit kriter të DST si dhe OE i shpallur fitues), prej 2,743,534 lekë (16,458,763 -12,515,490) veprime në papajtueshmëri me nenet 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797 datë 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Lidhur me këtë procedurë prokurimi, nga dokumentacioni i paraqitur në SEP nga BOE e shpallur fitues ka rezultuar se:

Lidhur mbi disponueshmërinë e certifikatës ISO 28000:2007, nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistem SEP, rezulton se të dy operatorët ekonomik “N” shpk dhe “V. N. I.S” shpk disponojnë certifikatën ISO 28000:2007 “Certifikatë of conformity” për “Ndërtim dhe rinovim i ndërtimeve civile dhe industriale, infrastrukturë rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, punime në diga, hidrocentrale, sistemeve të ujësjellësve dhe ujërave të zeza. Mirëmbajtje rrugësh rutinë dhe ndërtesash civile dhe industrial”.

Nga verifikimi on-line në faqen zyrtare të kompanisë certifikuese AQSCERT (Certifications & Inspections body) www.aqscert.org, në rubrikën “Certifikatat e mia” rezulton se OE “N.” shpk, disponon certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/SSC/15272017, me të dhënat e poshtëshënuara, të cilat rezultojnë të njëjta me atë të ngarkuar në sistem nga ky operator.

Emri i Kompanisë: “N.” Sh.p.k. NIPT: K31329048I

Adresa: Rruga Sulë Bega, Ndertësa Nr. 32, Hyrja 8, Njesia Bashkiake Nr. 8, Tirane, Albania

Nr. i Certifikatës.: AQS/SSC/15272017

Standardi: ISO 28001:2007

Fusha EN: Construction and renovation of civil and industrial constructions, road infrastructure, highäays, overpasses, railäays, underground works, bridges, works of art, works on the dams, hydropower, watër supply systëms and sewerage. Routine maintenance of road and civil and industrial building.

Fusha AL: Ndërtim dhe rinovim i ndërtimeve civile dhe industriale, infrastrukturë rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, punime në diga, hidrocentrale, sistemeve të ujësjellësve dhe ujërave të zeza. Mirëmbajtje rrugësh rutinë dhe ndërtesash civile dhe industriale.

First Issue Datë: 13/02/2017

Data e Modifikimit: 08/02/2019

Vlefshmëria: Valid

Data e Skadencës: 12/2/2020

Lidhur me OE “V. N. I.S” shpk po nga verifikimi on-line në faqen zyrtare të kompanisë certifikuese AQSCERT (Certifications & Inspections body) www.aqscert.org, në rubrikën “Certifikatat e mia” rezulton se OE “V. N. I.S” shpk, nuk disponon certifikatën ISO, edhe pse në SEP ky operator ka ngarkuar certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/PPS/16192017. Për këtë operatori, pas plotësimit të rubrikave: Emri i kompanisë, AQS, Standardi dhe Certificate, dhe pas dhënies së komandës “Kërkim” rezulton se del shënimi se: **Certifikata nuk u gjet. Ju lutem kontaktoni info@aqscert.org.**

Sa më sipër rezulton se ky operator ekonomik nuk disponon certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/PPS/16192017. Në sistemin elektronik të prokurimeve por edhe në zyrën e protokoll arkivit të bashkisë, nuk rezulton të jetë bërë apo dokumentuar ndonjë kërkesë e Bashkisë dhe më saktësisht e KVO dhe Titullarit të AK, lidhur me vërtetësinë e këtij dokumenti të ngarkuar në sistem nga ky OE, pra nuk ka asnjë të dhënë se mbi çfarë bazë KVO ka vlerësuar përmbajtjen e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

këtij dokumenti përsa kohë nga kompania certifikuese për këtë subjekti dhe certifikatë, nuk gjendet informacion. ***Për këtë veprim ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga K. K., E. Ç., dhe B. K.***

Për këtë kompani në sistem rezulton vetëm certifikata:

Emri i Kompanisë: "V. N. I.S" SHPK NIPT: K77524909Q

Adresa: Lagjia Pjetër Budi, Burrel, Diber, Albania

Nr. i Certifikatës.: AQS/SSC/19642017

Standarti: ISO 28001:2007

Fusha EN: Construction and renovation civil and industrial constructions, road infrastructure, highways, overpasses, railways, underground works, bridges, works of art, the works on the dams, hydro power, systems of the water supply and sewage water. Routine maintenance of road and civil and industrial building.

Fusha AL: Ndërtim dhe rinovim i ndërtimeve civile dhe industriale, infrastrukturë rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, punime në diga, hidrocentrale, sistemeve të ujësjellësve dhe ujërave të zeza. Mirëmbajtje rrugësh rutinë dhe ndërtesash civile dhe industriale.

First Issue Datë: 13/06/2017

Data e Modifikimit: 18/02/2019

Vlefshmëria: Valid

Data e Skadencës: 12/6/2020

Po ashtu nga verifikimi i lirë i të dy certifikatave të OE “N.” shpk, i cili disponon certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/SSC/15272017 e cila rezulton dhe në sistemin e AQSCERT, si dhe Certifikatën e “V. N. I.S” shpk, e cila vetëm në SEP ka ngarkuar certifikatën ISO 28000:2007 me nr. AQS/PPS/16192017, certifikatë për të cilën AQSCERT në faqen zyrtare on-line nuk jep informacion duke dalë me shënimin “Certifikata nuk u gjet” rezulton se në të dy rastet certifikatat e lëshuara kanë dy nënshkrime në fund të tyre njëri me shënimin “technical Direction” dhe tjetri “For certification body”, nënshkrime të cilat janë identike me njëra tjetrën, duke mos u kuptuar nëse janë nënshkrime elektronike ose jo (edhe pse në dokument nuk ka ndonjë rubrikë që sqaron formën e nënshkrimit të tyre nga personat përgjegjës).

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Rikonstruksion lagjia Drita 1”.

Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në përcaktimin e kriterëve dhe përzgjedhjen e ofertës fituese
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik u konstatua vendosja e kriterëve kualifikuese jo plotësisht në përputhje me natyrën e investimit.
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatim i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I Lartë.
Rekomandime:	Të merren masa për analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përzgjedhjen e OE fitues, vendimmarrje e cila ka sjell si pasojë prokurim të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën prej 11,904,319 lekë (vlerë e barabartë me ofertën e shpallur fituese).

Në mënyrë të përmbledhur të dhëna për tenderin jepen në tabelën e mëposhtme:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rikonstruksion "Lagjia Drita"		
1.Urdhër Prokurimi NR. 497 . DATË 26.09.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 499 , dt.26.09.2017	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.500 dt. 26.09.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “ hapur ”	A. N. Kryetare/Jurist A. Gj. Anëtar/Arkitekt A. P. Anëtar/ekonomist	P. M. Kryetar Ing. E. Ll. anetare ing.ndërtimi D.T. Aanetare Ekonomistë.
5.Fondi Limit (pa tvsh) : 12 070 000 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 11 904 319 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 165 681 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 20.10.2017	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit/ financim i huaj Grant	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 3 OE a)Kualifikuar A.-K. b)S'kualifikuar: N. sh.p.k, c) Kualifikuar: E.
11.Ankimime AK- ska;APP-s'ka;KPP-ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr datë _____	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP Shkresa nr..... datë _____

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga z. A. N., Specialist i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve (Jurist), z. A. Gj., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës (Arkitekt), z. A. P., me detyrë Specialist i Sektorit të Infrastrukturës, Emergjencave dhe Pronave (Ekonomist).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogaritjen e fondit.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve teknike (KLLFLST) dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogaritjen e fondit.

a- Llogaritja e fondit limit: Në dosjen e prokurimit nuk ka asnjë dokument që të vërtetoje se si ka proceduar AK për të llogaritur fondin limit të prokuruar.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 2, “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, në të cilën përcaktohet se: “Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato”.

Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.

Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

”Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

3.Liçensa profesionale,lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, për kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A (Punime gjermimi toke)
- NP- 4 A (Rrugë,autostrada, mbikalime,hekurudha,tramvaj,metro,pista, aeroporte)
- NP-5A (Punime nëntokësore,ura,vepra arti).
- NP - 12A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)
- NP – 17A (Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane)
- NS 1A-(Punime për prishjen e ndërtimeve)
- NS-5A (Impiantetësinjalistikës ndriçuese të trafikut)
- NS -8A (Ndërtime parafabrikat beton arme ,struktura metalike dhe druri)
- NS-18A(Punime topogjeodezike)
- NS-19A (Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë) sipas modelit të lëshuar nga MPPT.

Për operatorët e huaj të bëhet njësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike,Transportit dhe Telekomunikacionit ,në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës

4.1 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatëtë cilësisë së punimeve për ndërtime civile,punime ne rruge etj **ISO 9001-2008 (e vlefshme),**

4.2 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2004 (e vlefshme)**

4.3Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë**ISO 39001:2012**,mbi sigurinë rrugore.Në rast bashkimi operatoresh çdo operatore duhet të paraqesë ISO.

4.4 Certifikate ISO 39001:2012 (Mbi menaxhimin e trafikut rrugor)

4.5 Certifikatë ISO S SH ISO /IEC 27001;2013 (Mbi sigurimin e informacionit)

4.6Certifikatëtë cilësisë në saldim EN-ISO 3834-2:2006. Në rast bashkimi operatoresh çdo operator duhet të paraqesë ISO.

4.7 Certifikatëtë cilësisë për sistemin e tubacioneve plastik nën presion 1451-1:2009.

4.8 Certifikatëtë cilësisë 13331-1:2002 në menaxhimin e sistemit të kanaleve. Në rast bashkimi operatoresh çdo operatore duhet të paraqesë ISO.

5.1Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik të punësuar të vërtetuar me kontratë pune

- Inxhinier Ndërtimi 1
- Inxhinier Mjedisit 1
- Arkitekt 1
- Inxhinier gjeolog 1
- Inxhinier topograf 1
- Inxhinier mekanik 1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

- Inxhinier hidroteknik 1

5.2 Në stafin e shoqërisë duhet të ketëtë paktën një *teknik ndërtimi* i licencuar të deklaruara ne listëpagesat e shoqërisë,për periudhën korrik 2016 dhe ne vazhdim.

6. Një punësim mesatar i të paktën 35 (tridhjetë e pese) personave, për periudhën Janar 2016-Shtator 2017 të vërtetuar me;

6.1-Vërtëtim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;

6.2-List-pagesat e punonjësve,shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore për periudhën sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni ne fuqi për periudhën **Janar 2016 - Shtator 2017**,të konfirmuar nga Administrata Tatimore.

7. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, që nevojitet për ekzekutimin e kontratës.

LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA Minim
Kamionë me kapacitet mbi 16 ton	Ne pronësi ose me qira	cope 2
Kamionçinë mbi 7 ton	Ne pronësi ose me qira	cope 2
Autobetoniere (stacionere ,2 m3)	Ne pronësi ose me qira	2 cope
Motogjenerator	Ne pronësi ose me qira	2 cope
Vibrator Betoni	Ne pronësi ose me qira	2 cope
Autocisternë me tërheqje mbi 5000 litra “bot”	Ne pronësi ose me qira	1 cope
Motobetoniere 0.5 m3	Ne pronësi ose me qira	5 cope
Kamion autovinç	Ne pronësi ose me qira	1 cope
Armature	Ne pronësi ose me qira	120 m2
Ekskavator me goma	Ne pronësi ose me qira	Cope 1
Ekskavator me zinxhirë	Ne pronësi ose me qira	Cope 1
Aparat saldimi për produktet metalike	Ne pronësi ose me qira	Cope 2
Faromë me goma	Ne pronësi ose me qira	Cope 2
Rul vibruës mbi 10 ton	Ne pronësi ose me qira	Cope 1
Kamionçinë mbi 3 ton	Ne pronësi ose me qira	Cope 2

Në lidhje me kriteret e sipërcituara, në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kriterë kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç sine qua non për hartimin dhe vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimeve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar, ditëve të punës të kërkuara për realizimin e kontratës si edhe kategorizimit të pikave të licencës, mjeteve dhe kontratave paraprake të furnizimit, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e shumë prej tyre.

Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1, 2, 20 dhe 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP si hartues të tyre si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor si miratuesi i kriterëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Përsa më sipër NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhe nenin 26 të VKM 797 nr. 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi kërkesa të tilla sjellin si pasojë ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskrimin të kandidateve. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht z. A. N., z. A. Gj. dhe z. A. P.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z. P. M., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, z. E. Ll., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës, Emergjencave dhe Pronave (Inxhinier), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj. D. T., me detyrë Specialistë e Sektorit të Financës (ekonomistë), në cilësinë e anëtarit të KVO.

KVO ka nënshkruar formularin e deklarimit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.

Nga vlerësimi rezulton se janë s’kualifikuar 1 operatorë ekonomik dhe kualifikuar dy operator, OE “A.-K.” dhe “E.-A.” & “E.” Shpk i cili është shpallur fitues.

Kualifikimet dhe s’kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s’kualifikuar	Klasifikimi
1	N.	11264563	S’kualifikohet	
2	E.	11904319	Vlera e shpallur fituese	11904319
3	A.-K.	12061469	Kualifikohet	

Janë s’kualifikuar:

1. N. sh.p.k

Për arsyet e mëposhtme:

Operatorit ekonomik i mungon licenca mjedisore 3/2b, certifikata ISO 13331-1 : 2012 dhe ka paraqitur dokument për tender me Nr. 2681 prot, datë 26.10.2017.

Nga auditimi rezulton se kjo OE “N.” Shpk nuk përmbush kriteret e Dst-ve dhe është s’kualifikuar drejtë nga KVO-ja.

Për këtë procedurë rezulton se OE i shpallur fitues nuk paraqet mangësi në dokumentacion dhe vendimmarrja e KVO për shpalljen e tij fitues të procedurës është në përputhje me LPP.

Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Mat”.

Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në përcaktimin e kriterëve dhe përzgjedhjen e ofertës fituese
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik u konstatua vendosja e kriterëve kualifikuese jo plotësisht në përputhje me natyrën e investimit, dhe në vlerësimin e ofertës fituese u konstatua se OE i shpallur



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

	fitues nuk i përmbush plotësisht ato, dhe pavarësisht mangësive është vlerësuar dhe shpallur fitues.
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I Lartë.
Rekomandime:	Të merren masa për analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përzgjedhjen e OE fitues, vendimmarrje e cila ka sjell si pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën prej 71,400,669 lekë (vlerë e barabartë me ofertën e shpallur fituese).

Në mënyrë të përmbledhur të dhëna për tenderin jepen në tabelën e mëposhtme:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Shërbimi i Pastrimit ne Bashkinë Mat		
1.Urdhër Prokurimi NR. 536 .. DATË 16.10.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 505, dt.03.10.2017	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 54 dt. 17.02.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkese për propozim”	A. N. Kryetar/ Jurist L. K. Anëtar/Specialistë D. N. Anëtare/ekonomistë	P. M. KRYETAR Ing. E. K. anetare Juristë D.T. anetareEkonomistë.
5.Fondi Limit (pa tvsh) : 73 385 319 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 71 400 699 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1 984 620 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 18.01.2018	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit/ financim i huaj Bashkisë	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 2 OE a) I. C. Kualifikohet b) P. SKualifikohet
11.Ankimime AK- ska;APP-s’ka;KPP-ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr datë_____	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga z. A. N., Specialist i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve (Jurist), z. L. K., me detyrë Specialist i Sektorit të Infrastrukturës, Emergjencave dhe Pronave (Inxhinieri) dhe z. D. N., me detyrë Specialist i Sektorit të Financës (Ekonomist).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogaritjen e fondit.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kriterëve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve teknike (KLLFLST) dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogaritjen e fondit.

a- Llogaritja e fondit limit: Në dosjen e prokurimit nuk ka asnjë dokument që të vërtetoje se si ka proceduar AK për të llogaritur fondin limit të prokuruar.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 2, “Hartimi i dokumenteve të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

tenderit”, në të cilën përcaktohet se: “Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato”.

Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.

Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

”Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specififikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

Nga auditimi rezulton se:

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (nje) vit , për punonjësit si më poshtë:
 - 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, Licencë, CV.
 - 1 (një) Inxhinier Mjedisi, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, dhe Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
 - 1 (një) Inxhinier Kimist, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV .
2. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 1 (vit). Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: Kontratë Pune e vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, Libreze Pune, Diplomën përkatëse. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë dhe ta vërtetoje me dokumentacionin e mësipërm.
3. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO 9001 – 2008** për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme).
4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO 14001 – 2004** për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme).
5. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **BS OHSAS 18001 – 2007**, për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme).
6. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO 50001-2012** për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme).
7. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO3834-2;2005** për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme).
Shënim: Certifikatat e mësipërme (pikat 6,7,8,9 dhe 10) duhet të jenë të lëshuara nga Institucione ndërkombëtare të certifikuara/akredituara.
8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (një) copë**;
 - b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak **2 (dy) copë**;
 - c) Makine transportuese të kontejnerëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontejnerëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (një) copë**.
 - d) Makinë vetëshkarkuese e hapur nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 1.5 - 3 ton. Viti i prodhimit jo më poshtë se 1998. Jo më pak se **3 (tre) copë**;
 - e) Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (një) copë**;
 - f) Makina për larjen e rrugëve, (autobot) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 8500 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998 jo më pak se **1 (një) copë**;
 - g) Fadromë me goma me kapacitet të kovës prej 1 m³, jo më pak se **1 (një) copë**.
9. Operatori ekonomik duhet të disponojë **100 (njëqind)** kontejnerë. Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:

Në lidhje me kriteret e sipërcituara, në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kriterë kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç **sine qua non** për hartimin dhe vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimeve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar, ditëve të punës të kërkuara për realizimin e kontratës si edhe kategorizimit të pikave të licencës, mjeteve dhe kontratave paraprake të furnizimit, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e shumë prej tyre.

Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1, 2, 20 dhe 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP si hartues të tyre.

Përsa më sipër NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhe nenin 26 të VKM 797 nr. 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi kërkesa të tilla sjellin si pasojë ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskriminim të kandidatëve. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht z. A. N., zj. L. K. dhe z. D. N..

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z. P. M., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, zj. E. K., me detyrë ish-Specialistë e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj. D. T., me detyrë Specialistë e Sektorit të Financës (ekonomistë), në cilësinë e anëtarit të KVO.

KVO ka nënshkruar formularin e deklaramentit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.

Nga vlerësimi rezulton se janë s’kualifikuar 1 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 1 operator, OE “I. C.” Shpk i cili është shpallur fitues.

Kualifikimet dhe s’kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s’kualifikuar	Klasifikimi
1	I. C.	71 400 699	Kualifikohet	
2	P.	0	S’kualifikohet	

Janë s’kualifikuar:

2. P. sh.p.k

Për arsyet e mëposhtme:

- Nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për të plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, të kërkuara nga DST.

Nga auditimi rezulton se ky OE “P.” Shpk nuk përmbush kriteret e Dst-ve dhe është s’kualifikuar drejtë nga KVO-ja.

OE të kualifikuar.

OE “I. C.” shpk është kualifikuar dhe shpallur fitues. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit fitues rezultojnë këto mangësi:

1.Pika 3 e kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkon që Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (një) vit , për punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, Licencë, CV .
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, dhe Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- 1 (një) Inxhinier Kimist, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nuk janë plotësuar kërkesat e kësaj pike nga operatori fitues, pasi nuk kanë paraqitur asnjë kontratë punësimi me inxhinierin kimist siç përcaktohet në dokumentet standarde të DST.

2.Pika 4 e kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkon që Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën 1 (vit). Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: Kontratë Pune e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, Librezë Pune, Diplomën përkatëse. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë dhe ta vërtetojë me dokumentacionin e mësipërm.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se kjo pikë e kërkesave të DST nuk është plotësuar nga operatori fitues pasi nuk kanë paraqitur asnjë kontratë të vlefshme pune për mjekun e përgjithshëm.

3.Pika 9 e kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkon që Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë certifikatën ISO 50001:2012 për ushtrimin e aktivitetit objekt i prokurimit sipas kërkesës se DST.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Operatori fitues nuk e ka paraqitur këtë certifikatë.

4.Pika 10 e kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkon që Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë certifikatën ISO 3834-2:2015 për aktivitetin objekt prokurimi sipas kërkesës se DST.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se Operatori fitues nuk e ka paraqitur këtë certifikatë.

5.Pika 13/e e kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkon që Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një makinë teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (një) copë**, dhe në vijim për të provuar mjetin përkatës pika 14/e kërkesave të DST ndërmjet tyre kërkon që operatori duhet të paraqesë edhe fotografi të mjeteve.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se operatori fitues ka paraqitur makinën teknologjike për fshirjen e rrugëve, por në fotot e paraqitura mjetit i mungon fshesa qendrore rrul.

6.Pika 15 e kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkon që Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **100 (njëqind)** kontejnerë. Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:

Kontejnerët në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar si dhe me faturat tatimore të blerjes, të lëshuara para datës së shpalljes së procedurës së tenderimit.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se operatori fitues nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar për disponibilitetin e 100 kontejnerëve siç kërkohet nga Njësia e Prokurimit.

Dokumentet që ka paraqitur OE “**I. C.**” Shpk nuk plotësojnë kërkesat e DST dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “**I. C.**” Shpk, që është edhe oferta me vlerë më të lartë ekonomike e paraqitur. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. P. M. në cilësinë e kryetarit të KVO, zj. E. K. dhe zj. D. T., në cilësinë e anëtarëve të KVO.

KVO ka vepruar në kundërshtim me pikën 5, të nenit 53 “*Shqyrtimi i ofertave*” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar ku citohet “*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit*”, si dhe pikës 2 të nenit 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*”, ku citohet “*Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit*”. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, z. P. M. në cilësinë e kryetarit të KVO, zj. E. K. dhe zj. D. T., në cilësinë e anëtarëve të KVO.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anulim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. P. M. në cilësinë e kryetarit të KVO, zj. E. K. dhe zj. D. T.

Mos plotësimi i kushteve nga OE i shpallur fitues, ka sjell për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet për vlerën prej **71,400,669 lekë pa tvsh**, (vlera e shpallur fituese e cila përkon edhe me ofertën ekonomike më të lartë të paraqitur), veprime në papajtueshmëri me nenet 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797 datë 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Lidhur me procedurat e pastrimit të qytetit, nga auditimi ka rezultuar gjithashtu se:

Kontrata e lidhur me nr. 796, datë 03.04.2017, ndërmjet Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Kryetari N. R. dhe subjektit “K.” shpk përfaqësuar nga G. K., me objekt: “Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Mat”. Sipas kushtëve të veçanta të kontratës, neni 3 “Vlera e Kontratës”, kontrata është lidhur me vlerë 1,118,886 lekë pa tvsh/muaj dhe afati i saj sipas nenit 4 “Afati i Kontratës”, është deri në lidhjen e kontratës bazë të shërbimit të pastrimit, pas përfundimit të procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Mat”.

Bashkia Mat para lidhjes së kësaj kontrata ka pasur të nënshkruar një tjetër kontratë dhe konkretisht kontrata nr. 41, datë 13.3.2009 ndërmjet Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Kryetari S. Ll. dhe subjektit “K.” shpk përfaqësuar nga G. K., si përfaqësues i BOE K. & I. & K. & J. shpk me objekt: “Shërbimi i pastrimit të qytetit Burrel”. Sipas kontratës afati është për një periudhë 7 vjeçare (2009-2015) dhe vlera e saj është në shumën prej 11,500,187 lekë pa tvsh ose 13,800,224 lekë me tvsh.

Shtesë kontrata nr. 2187, datë 18.08.2016, lidhur ndërmjet Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Kryetari S. Ll. dhe subjektit “K.” shpk përfaqësuar nga G. K., sipas të cilës në referim të kontratës bazë nr. 41, datë 13.3.2009, nenet 25 “Vonesa në zbatimin dhe zgjatje e afatit” dhe 26 “Ndryshimi i porosisë”, është hartuar shtesë kontratë në masën 20% të kontratës bazë ose 2,300,037 lekë pa tvsh ose 2,760,045 leke me tvsh. Sipas shtesës së kontratës afati i saj është nga data 18.8.2016 deri më 08.10.2016. sipas kontratës shkaqet ligjore të hartimit të saj janë mos përfundimi nga bashkia të procedurave të prokurimit për pastrimin e qyteti dhe njësisive administrative.

Bashkia Mat në referim të urdhrin të prokurimit nr. 106, datë 27.03.2017 të titullarit të AK z. N. R., ka filluar procedurat për prokurimin e shërbimit “Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Mat” për vlerën prej 84,231,478 lekë pa tvsh dhe lloj procedure të Hapur e ndarë në 5 vite nga ku vetëm për vitin e parë fondi është përcaktuar në shumën 14,973,490 lekë ndërsa për vitet në vazhdim 17,314,497 lekë. Urdhri i prokurimit dhe njoftimi i kontratës rezultojnë të jenë të depozituara dhe konfirmuara edhe nga Dega e Thesarit Burrel me nr. 70, datë 29.03.2017.

Njësia e Prokurimit e përbërë nga A. N., Jurist, L. K. Specialistë dhe E. R. ekonomistë ngritur me urdhrin nr. 107, datë 27.03.2017, më datë 28.03.2017 kanë realizuar mbajtjen e procesverbalit nr. 1, të miratimit të dokumenteve të tenderit dhe specifikimeve përkatëse.

Kjo procedurë fillimisht është pezulluar për shkak të ankimit të OE “R.” shpk, nr. 785, datë 04.04.2017, për të cilën ka dalë urdhri i pezullimit të titullarit të AK 132, datë 04.04.2017 dhe Vendimi nr. 135, datë 06.04.2017, sipas të cilit ankesa e OE nuk është marrë parasysh. Pas kësaj



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

rezulton se me vendimin nr. 138, datë 07.04.2017, është rifilluar procedura e prokurimit dhe pezulluar serish sipas Urdhrit nr. 149, datë 13.04.2017, në bazë të vendimit të KPP nr. 431/1, datë 15.03.2017.

Në referim të ankesave të BOE-ve të sipërcituara, titullari i AK ka ngritur Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave, në bazë të Urdhrit nr. 133, datë 03.04.2017 të përbërë nga B. K., A. P. dhe E. B., komision i cili me vendimin nr. 135, datë 06.04.2017, ka vendosur për refuzimin e kërkesës, duke i propozuar Titullarit të AK, NJP dhe KVO-së vijimin e procedurës, vendim i cili rezulton se në referim të nenit 78 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 është miratuar nga Titullari i AK (Në mungesë dhe me porosi nga Zv/Kryetari A. Sh.) duke e lënë në fuqi atë.

Më datë 10.04.2017, administruar nga bashkia me nr. 890, datë 11.04.2017, ka paraqitur ankesë pranë KPP OE “R.” shpk, shkresë e cila i është bërë me dije edhe bashkisë, ankesë për të cilën KPP me vendimin nr. 699/1, datë 12.04.2017, administruar nga Bashkia Mat me nr. 914, datë 13.04.2017, ka vendosur për shqyrtimin e ankesës të OE “R.” shpk duke urdhëruar Ak për pezullimin e procedurës së prokurimit.

OE “R.” shpk, vendimin e AK Bashkia Mat e ka ankimuar në Komisionin e Prokurimit Publik i cili me vendimin nr. 331/1, datë 22.05.2017, administruar nga bashkia me nr. 1282, datë 23.05.2017, ka vendosur: “Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga OE, duke kërkuar nga OE të modifikojë DST në përputhje me konstatimet e KPP, duke vënë në dijeni Brenda 10 ditëve KPP lidhur me zbatimin e këtij vendimi”.

KPP me vendimin nr. 331/3/2017, datë 05.06.2017, ka vendosur për pranimin e kërkesës të AK për heqjen e pezullimit të procedurës së prokurimit, rishikuar për tu zhvilluar më datë 21.04.2017. Pas modifikimi të DST-ve, nga NJP, më datë 26.07.2017, KVO e përbërë nga P. M., E. Ll. dhe D. T., ngritur me urdhrin e brendshëm nr. 108, datë 27.03.2017, kanë bërë hapjen dhe vlerësimin e ofertave duke kualifikuar OE, BOE “K. & R. 96” shpk, për vlerën prej 69,370,774 lekë pa tvsh; dhe BOE “V.... R. & B.” shpk për vlerën prej 79,583,852 lekë pa tvsh, si dhe duke s’kualifikuar BOE “R. & R. & I.”shpk, për vlerën prej 65,705,759, lekë pa tvsh, për arsye të mungesës të makinës teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës 10 ton; makinës teknologjike për fshirjen e rrugëve me kapacitet mbajtës 2 deri 3 m të pajisura me 2 fshesa anësore; si dhe makinën për larjen e rrugëve (autobot) të pajisur me pompë për lagjen e rrugëve me presion.

Më datë 03.08.2017, janë bërë me dije nëpërmjet mesazheve në SPE, OE pjesëmarrës nga ku ka rezultuar se më datë 08.08.2017, protokolluar në bashki me nr. 1991, datë 08.08.2017, ankesa e BOE “R. & R. & I.” shpk, sipas të cilës ky bashkim operatorësh plotëson të gjitha kushtet e vendosura nga AK dhe NJP në DST. Po ashtu më datë 08.08.2017, protokolluar në bashki me nr. 1998, datë 09.08.2017, ankesa e BOE “V.... R. & B.” shpk, sipas të cilës edhe ky bashkim operatorësh plotëson të gjitha kushtet e vendosura nga AK dhe NJP në DST.

Në referim të ankesave të BOE-ve të sipërcituara, titullari i AK ka ngritur Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave, në bazë të Urdhrit nr. 432, datë 09.08.2017 të përbërë nga E. K., V. S. dhe E. B., komision i cili me vendimin nr. 433, datë 16.08.2017, ka vendosur për pranimin pjesërisht të ankesave duke s’kualifikuar të tri pjesëmarrësit në procedurë dhe duke i propozuar Titullarit të AK, NJP dhe KVO-së ribërjen e procedurës, vendim i cili rezulton se në referim të nenit 63 të LPP është miratuar nga Titullari i AK (Në mungesë dhe me porosi nga Zv/Kryetari A. Sh.) duke e lënë në fuqi atë.

Me vendimi nr. 1391/1, datë 22.08.2017 të KPP, protokolluar në bashki me nr. 2107, datë 25.08.2017, KPP ka vendosur pezullimin e procedurave të prokurimit, me qëllim shqyrtimin e ankesës të BOE “R. & R. & I.” shpk.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Më datë 22.08.2017, protokolluar nga Bashkia Mat me nr. 2105, datë 24.08.2017, ka paraqitur ankim lidhur me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr. 433, datë 16.08.2017 dhe vendimit e Titullarit të AK, BOE “K. & R. 96” shpk sipas të cilës ky bashkim operatorësh plotëson të gjitha kushtet e vendosura nga AK dhe NJP në DST, po ashtu më datë 24.08.2017, protokolluar nga Bashkia Mat me nr. 2109, datë 24.08.2017, ka paraqitur ankim lidhur me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr. 433, datë 16.08.2017 dhe vendimit e Titullarit të AK, BOE “V.. R. & B.” shpk, sipas të cilës edhe ky bashkim operatorësh plotëson të gjitha kushtet e vendosura nga AK dhe NJP në DST.

Po ashtu më datë 21.08.2017, protokolluar nga Bashkia Mat me nr. 2103, datë 24.08.2017, ka paraqitur ankim lidhur me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr. 433, datë 16.08.2017 dhe vendimit e Titullarit të AK, BOE “R. & R. & I.” shpk sipas të cilës ky bashkim operatorësh plotëson të gjitha kushtet e vendosura nga AK dhe NJP në DST.

KPP me vendimin nr. 1411/1, datë 28.08.2017, administruar nga Bashkia Mat me nr. 2143, datë 30.08.2017, ka vendosur kalimin për shqyrtim të ankesave të BOE të sipërcituar, duke kërkuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e praktikës, kërkesë të cilën AK rezulton ta ketë përmbushur më datë 04.09.2017, shkresa nr. 2143/1, pra 3 ditë tej afatit (dy ditore të paracaktuar nga KPP).

Procedura e mësipërme në referim të vendimit të KPP nr. 672/1, datë 26.09.2017, administruar nga Bashkia Mat me nr. 2380, datë 27.09.2017, është anuluar si pasojë e mos pranimit nga KPP e asnjërës prej ankesave dhe urdhërimit të AK për të lejuar vazhdimin e hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit. Me anulimin e procedurës Bashkia Mat me shkresën nr. 2446, datë 04.10.2017 ka bërë edhe njoftimin përkatës drejtuar subjekteve dhe Degës së Thesarit Mat.

Për këtë procedurë prokurimi rezulton se Bashkia Mat ka shpallur kërkesën sipas të cilës për procedurën e llojit “Tender i Hapur”, më datë 23.10.2017 është përcaktuar si data e fundit e paraqitjes së ofertave të OE të interesuar. Shpallja është bërë në bazë të urdhrin të prokurimit nr. 509, datë 04.10.2017, për fondin limit nr. 77,844,165 lekë pa tvsh.

Bashkia Mat me shkresën nr. 2523, datë 12.10.2017, të Titullarit të AK ka bërë njoftimin e anulimit të procedurës së prokurimit sipas urdhrin të prokurimit nr. 509, datë 04.10.2017, për fondin limit nr. 77,844,165 lekë pa tvsh, me arsyetimin e përlllogaritjes së gabuar të fondit limit Lidhur me sa sipër rezulton se preventivuesi L. K., nuk ka paraqitur apo administruar në dosjen e procedurës së prokurimit as edhe një dokument mbi mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit të prokuruar. Po ashtu në dosje nuk ekziston asnjë dokument teknik e hartografik lidhur me vendndodhjet e depozitimin e mbeturinave (kazanë, pika grumbullimi si dhe vendi i hedhjes së mbeturinave). Për këtë procedure edhe pse nga pasaktësia e krijuar nga përlllogaritja e gabuar e fondit, çka është bërë shkak për anulimin e procedurës dhe për pasojë mos ofrimit nga bashkia të shërbimit të pastrimit të qytetit dhe njësive administrative, Titullari i Autoritetit Kontraktor, nuk ka marrë as edhe një veprim ligjor për ndëshkimin e personave përgjegjës për krijimin e kësaj situatë anormale, veprime për të cilat ngarkohet drejtpërdrejt titullari por dhe Punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve, Sektorit të Infrastrukturës, Pronave dhe Emergjencave Civile.

Me anulimin e procedurës, Titullari i AK me urdhrin e prokurimit nr. 541, datë 20.10.2017, ka iniciuar procedurën e prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kantatës” për objektin: “Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Mat”, për vlerën prej 1,573,504 lekë pa tvsh në muaj ose 18,882,048 lekë pa tvsh për një vit.

Po më datë 20.10.2017 me nr. Extra, me titull “Argumentim mbi arsyet e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit “Me negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”, nga Njësia e Prokurimit e përbërë nga A. N., L. K. dhe D. N, është argumentuar nevoja e kryerjes së procedurës



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

së negocimit pa botim paraprak, sipas nenit 33/c të LPP dhe nenit 36/2, gërma “c” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014. Argumenti i përdorur është se shërbimi i mëparshëm i pastrimit ka përfunduar më datë 20.10.2017 dhe nga data e fillimit të procedurave deri në hapjen e ofertave është minimalisht 23 ditë; në rast të ankesave të mundshme përpara hapjes së ofertave, dhe mbas shqyrtimit dhe kthimit të përgjigjes duhen pritur 10 ditë për ankesa të mundshme në KPP; për vlerësimin e ofertave nevojiten 5 ditë; pas klasifikimit në sistem pritet 7 ditë për ankesa të mundshme; në rast të ankesave AK duhet të respektojë afatin 7 ditor para shpalljes së njoftimit të fituesit; në rast të ankesave të mundshme në KPP, afati kohor i nevojshëm për shqyrtimin administrativ nga KPP është 20 ditë; si dhe nga hedhja e njoftimit të fituesit deri në publikimin e tij nevojiten 7 ditë; në këto kushte rezulton se nevojiten afro 3 muaj nga data e njoftimit, duke u përsëritur e njëjta praktikë si edhe në procedurën e iniciuar më datë 27.03.2017.

Data e paracaktuar për hapjen e ofertave është vendosur 23.10.2017 si dhe OE e ftuar janë “K.” shpk, “L.” shpk dhe “R. 96” shpk respektivisht njoftuar me shkresën nr. 2621, datë 20.10.2017, nr. 2622, datë 20.10.2017 dhe 2622, datë 20.10.2017. NJP është ngritur me Urdhërin e Titullarit të Ak nr. 541, datë 20.10.2017, e përbërë nga A. N., L. K. dhe D. N., ndërsa KVO e përbërë nga P. M., E. K., dhe D. T.. Më datë 23.10.2017, KVO, kanë vijuar me hapjen e ofertave nga ku ka rezultuar se kanë pranuar kërkesën duke shprehur interes dy prej OE dhe konkretisht “K.” shpk, dhe “L.” shpk, respektivisht për ofertat ekonomike prej 1,548,692 lekë pa tvsh dhe 1,565,644 lekë pa tvsh. Vendimi dhe raporti përmbledhës i KVO është miratuar po më datë 23.10.2017 nga Titullari i AK, zoti N. R.

Lidhur me dokumentacionin e paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se subjekti “K.” shpk, nuk ka plotësuar Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, pika 1.2 “Një dokument që vërteton se (subjekti juaj)” pika “a”, “ka plotësuar detyrimet fiskale”, pasi ky subjekt rezulton debitorë ndaj, Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, Sektori i Shërbimit ndaj Tatimpaguesit, sipas shkresës nr. 4686, datë 04.10.2017 “Marrëveshje për pagesë me këste” ku subjekti si debitor i shumës prej 2,548,339 lekë, pranon pagesën e saj me këste.

Po ashtu rezulton se dokumentacioni i paraqitur është jashtë afatit kohor të miratuar, përse procedura e prokurimit është përcaktuar për tu zhvilluar më datë 23.10.2017. ora 09⁰⁰ (sipas DST faqe 5), ndërkohë kur disa dokumente të paraqitura nga OE mbajnë datën 24.10.2017 (Vërtetimi nr. 3540, 3540/1, 3540/2 dhe nr. 3540/3, datë 24.10.2017, si dhe vërtetimi nr. 3541, datë 24.10.2017 dhe nr. 3539, datë 24.10.2017, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesit.

Në këto kushte rezulton se KVO dhe Titullari i AK, kanë vlerësuar dhe më tej shpallur fitues një OE i cili nuk ka paraqitur të plotë të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor të kërkuar sipas DST, përse dokumentet e sipërcituara mbajnë datën e lëshimit 24 Tetor 2017 dhe data e zhvillimit të prokurimit është më 23 Tetor 2017.

Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga z. P. M. Kryetar i KVO, zj. E. K. dhe zj. D. T. anëtare të KVO, si dhe Titullari i AK z. N. R.

Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Rehabilitimi veprave të marrjes të kanalit ujitës Batër e Madhe”.

Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në përcaktimin e kriterëve dhe përzgjedhjen e ofertës fituese
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik u konstatua vendosja e kriterëve kualifikuese jo plotësisht në përputhje me natyrën e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

	investimit, dhe në vlerësimin e ofertës fituese u konstatua se OE i shpallur fitues nuk i përmbush plotësisht ato, dhe pavarësisht mangësive është vlerësuar dhe shpallur fitues.
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I Lartë.
Rekomandime:	Të merren masa për analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përzgjedhjen e OE fitues, vendimmarrje e cila ka sjell si pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, efencë dhe efektivitet në vlerën prej 5,955,984 lekë (vlerë e barabartë me ofertën e shpallur fituese).

Në mënyrë të përmbledhur të dhëna për tenderin jepen në tabelën e mëposhtme:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Rehabilitimi veprave të marrjes të kanalit ujitës Batër e Madhe		
1.Urdhër Prokurimi <u>NR. 119</u> <u>DATË 31.03.2017</u>	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 53 , dt.17.02.2017	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 54 dt. 17.02.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “kërkesë për propozim”	A. N. Kryetar/ Jurist E. Ll. Anëtar/Ing.Ndërtimi E. R. Anëtare/ekonomistë	P. M. Kryetar Ing. E. K. anetare, Juriste D. T. anetare, Ekonomistë.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7 025 000 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 5 955 984 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1 069 016 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 25.04.2017	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit/ financim i huaj GRANT	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender IOE a) R. & F. Kualifikohet
11.Ankimime AK- ska;APP-s’ka;KPP-ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr datë _____	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP Shkresa nr..... datë _____

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga z. A. N., Specialist i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve (Jurist), z. E. Ll., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës (inxhinier), zj. E. R., me detyrë ish-Specialistë e Sektorit të Bujqësisë dhe Pyjeve (Ekonomistë).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogaritjen e fondit.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve teknike (KLLFLST) dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogaritjen e fondit.

a- Llogaritja e fondit limit: Në dosjen e prokurimit nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se si ka proceduar AK për të llogaritur fondin limit të prokuruar.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 2, “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, në të cilën përcaktohet se: “Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Vihet re se, në të gjitha kriterëve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

“Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specififikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z. P. M., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, zj. E. K., me detyrë ish-Specialistë e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj. D. T., me detyrë Specialistë e Sektorit të Financës (ekonomistë), në cilësinë e anëtarit të KVO.

KVO ka nënshkruar formularin e deklaramentit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.

Nga vlerësimi rezulton se janë skualifikuar 0 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 1 operator, OE “R. & F.” Shpk i cili është shpallur fitues.

Kualifikimet dhe skualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s’kualifikuar	Klasifikimi
1	R. & F.	5 955 984	Kualifikohet	

OE të kualifikuar.

BOE “R.” shpk dhe “F.” shpk janë shpallur fitues. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorëve të shpallur fitues rezultojnë këto mangësi:

1.Pika 2.3.2 e kërkesave të NJP kërkon që subjektet duhet të kenë në stafin e tij punonjës të kualifikuar me kontratë pune të vlefshme të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik nga IQT.

- 1 punonjës (Saldator)
- 1 punonjës (Hidraulik)
- 1 punonjës (Manovrator)

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se operatori i kualifikuar dhe shpallur fitues ka paraqitur nje listë me punonjës me kualifikimet e mësipërme të cilët dëshminë e sigurimit teknik nuk e kanë të lëshuar nga IQT por nga një trupës tjetër certifikuese, çka përbën shkak për s’kualifikim pasi kërkesat e NJP e kanë kërkuar në mënyrë eksplicite që të jenë me dëshmi nga IQT.

Pika 2.3.5 e kërkesave të NJP për disponimin ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës për lotin që konkuron:

Nr	Lloji I makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamionë, kapaciteti total mbajtës të # 6- 15 ton	Në pronësi ose me qira	copë	2
2	Autobetonjere	Në pronësi ose me qira	copë	1
3	Motogjeneratorë	Në pronësi ose me qira	copë	1



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

4	Fadromë me goma	Në pronësi ose me qira	copë	1
5	Ekskavator me zinxhir me çekiç pneumatik	Në pronësi ose me qira	copë	1
6	Kamionçine	Në pronësi ose me qira	copë	1
7	Betoniere 0.5 m3	Në pronësi ose me qira	copë	2
8	Vibrator	Në pronësi ose me qira	copë	2
9	Pompë uji	Në pronësi ose me qira	copë	1
10	Bot uji	Në pronësi ose me qira	copë	1
11	Aparat për prerje tuba çeliku	Në pronësi ose me qira	copë	1
12	Kamion me vinç	Në pronësi ose me qira	copë	1

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se BOE fitues nuk kanë paraqitur të gjitha mjetet e kërkuara në kërkesat e DST. Konkretisht operatorët nuk kanë paraqitur fadromën me goma; Ekskavatori i kërkuar me zinxhir me çekiç pneumatik, nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton të jetë pa çekiçin pneumatik dhe mungojnë edhe fotografitë provuese.

Për 2 kamionët e kërkuar si dhe kamionçinën, janë hedhur në sistem vetëm disa leje qarkullimi, por mungojnë materiale të tjera shtesë provuese për posedimin e tyre si dhe fotot përkatëse.

Edhe për kamionin me vinç, operatorët kanë paraqitur një kontratë qiraje të këtij mjeti, por mungojnë dokumentet shtesë bashkëlidhur, fotot e mjetit, siguracioni etj.

Për autobetonieret, BOE fitues kanë lidhur një kontratë qiraje për dy mjetë me targa dhe dokumentacion të shtetit të Kosovës, por atyre u mungon vula apostile sipas kërkesave të ligjit për dokumentet të cilat nuk janë të lëshuara nga organet e Shqipërisë.

Dokumentet që ka paraqitur BOE “**R. & F.**” Shpk nuk plotësojnë kërkesat e DST dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “**R. & F.**” Shpk, që është edhe oferta me vlerë më të lartë ekonomike e paraqitur. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. P. M. në cilësinë e kryetarit të KVO, zj. E. K. dhe zj. D. T., në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. N. R.

KVO ka vepruar në kundërshtim me pikën 5, të nenit 53 “*Shqyrtimi i ofertave*” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar ku citohet “*Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit*”, si dhe pikës 2 të nenit 55 “*Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese*”, ku citohet “*Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit*”. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, z. P. M. në cilësinë e kryetarit të KVO, zj. E. K. dhe zj. D. T., në cilësinë e anëtarëve të KVO.

Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar ku citohet “*Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit*” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. P. M. në cilësinë e kryetarit të KVO, zj. E. K. dhe zj. D. T., në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. N. R..

Mos plotësimi i kushteve nga OE i shpallur fitues dhe s’kualifikimi, ka sjell për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet për vlerën prej **5,955,984 lekë pa tvsh**, (vlera e shpallur fituese e cila përkon edhe me ofertën ekonomike më të lartë të paraqitur), veprime në papajtueshmëri me nenet 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797 datë 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Mirëmbajtje Kanale vaditëse”.

Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në përcaktimin e kriterëve dhe përzgjedhjen e ofertës fituese
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik u konstatua vendosja e kriterëve kualifikuese jo plotësisht në përputhje me natyrën e investimit, dhe në vlerësimin e ofertës fituese u konstatua se OE i shpallur fitues nuk i përmbush plotësisht ato, dhe pavarësisht mangësive është vlerësuar dhe shpallur fitues.
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I Lartë.
Rekomandime:	Të merren masa për analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përzgjedhjen e OE fitues, vendimmarrje e cila ka sjell si pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet në vlerën prej 3,898,480 lekë (vlerë e barabartë me ofertën e shpallur fituese).

Në mënyrë të përmbledhur të dhëna për tenderin jepen në tabelën e mëposhtme:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : Mirëmbajtje kanale vaditëse		
1.Urdhër Prokurimi NR. 162 . DATË 19.04.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 53 , dt.17.02.2017	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 54 dt. 17.02.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kerkese per propozim ”	A. N. Kryetar/ Jurist E. Ll. Anëtar/Ing.Ndërtimi E. R. Anëtare/ekonomistë	P. M., KRYETAR Ing. E. K.,anetare, Juristë D. T. anetare Ekonomistë.
5.Fondi Limit (pa tvsh) : 4 056 545 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 3 898 480 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 158 065 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 09.05.2017	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit/ financim i huaj Bashkise	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 1 OE a) N. Kualifikohet
11.Ankimime AK- ska;APP-s’ka;KPP-ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr datë_____	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga z. A. N., Specialist i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve (Jurist), z. E. Ll., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës (inxhinier), zj. E. R., me detyrë ish-Specialistë e Sektorit të Bujqësisë dhe Pyjeve (Ekonomistë).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogaritjen e fondit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kriterëve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve teknike (KLLFLST) dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlogaritjen e fondit.

a- Llogaritja e fondit limit: Në dosjen e prokurimit nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se si ka proceduar AK për të llogaritur fondin limit të prokuruar.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 2, “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, në të cilën përcaktohet se: “Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato”.

Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.

Vihet re se, në të gjitha kriterëve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

”Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z. P. M., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, zj. E. K., me detyrë ish-Specialistë e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj. D. T., me detyrë Specialistë e Sektorit të Financës (ekonomistë), në cilësinë e anëtarit të KVO.

KVO ka nënshkruar formularin e deklaramentit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit.

Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.

Nga vlerësimi rezulton se janë s’kualifikuar 0 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 1 operator, OE “N” Shpk i cili është shpallur fitues.

Kualifikimet dhe s’kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Oferta në lekë pa TVSH	Kualifikuar/s’kualifikuar	Klasifikimi
1	N	3 898 480	Kualifikohet	

OE të kualifikuar.

OE “N” shpk janë shpallur fitues. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues rezultojnë këto mangësi:

1.Pika 2.iii e kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkon nga Operatorët ekonomik ofertues që të ketë të punësuar të vërtetuar me kontrata pune të vlefshme dhe stafi teknik të mëposhtëm:

1.Inxhinier ndërtimi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

1. Inxhinier hidroteknik

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se të dy inxhinierët e mësipërm, kanë paraqitur dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik jashtë afateve të vlefshmërisë së tyre.

2. Pika 4 e kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkon që operatorët pjesëmarrës të posedojnë mjetet e nevojshme për zbatimin e kësaj kontratë, dhe konkretisht 2 kamionë me kapacitet deri në 15 ton.

-Nga shqyrtimi i kësaj pike, rezulton se operatori fitues ka paraqitur 2 kamionë me kapacitet mbi 18 ton, ndryshe nga kërkesa e përcaktuar nga NJP në DST.

Dokumentet që ka paraqitur BOE “N” Shpk nuk plotësojnë kërkesat e DST dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, tenderi duhet të ishte anuluar. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “N” Shpk, që është edhe oferta me vlerë më të lartë ekonomike e paraqitur. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. P. M. në cilësinë e kryetarit të KVO, zj. E. K. dhe zj. D. T., në cilësinë e anëtarëve të KVO.

KVO ka vepruar në kundërshtim me pikën 5, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”, si dhe pikës 2 të nenit 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, ku citohet “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit”. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, z. P. M. në cilësinë e kryetarit të KVO, zj. E. K. dhe zj. D. T., në cilësinë e anëtarëve të KVO.

Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për anullim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti Kontraktor anullon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. P. M. në cilësinë e kryetarit të KVO, zj. E. K. dhe zj. D. T., në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. N. R.

Mos plotësimi i kushteve nga OE i shpallur fitues, ka sjell për pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet për vlerën prej **3,898,480 lekë pa tvsh**, (vlera e shpallur fituese e cila përkon edhe me ofertën ekonomike më të lartë të paraqitur), veprime në papajtueshmëri me nenet 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797 datë 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Procedurat e prokurimit të konstatuara më shkelje e parregullsi gjatë vitit 2018, si vijon:

Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Lagjia Drita faza II”.

Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në përcaktimin e kriterëve dhe përzgjedhjen e ofertës fituese
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik u konstatua vendosja e kriterëve kualifikuesë jo plotësisht në përputhje me natyrën e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

	investimit, dhe në vlerësimin e ofertës fituese u konstatua se OE i shpallur fitues nuk i përmbush plotësisht ato, dhe pavarësisht mangësive është vlerësuar dhe shpallur fitues.
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I Lartë.
Rekomandime:	Të merren masa për analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përzgjedhjen e OE fitues, vendimmarrje e cila ka sjell si pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, efencë dhe efektivitet në vlerën prej 13,098,531 lekë (vlerë e barabartë me ofertën e shpallur fituese).

Në mënyrë të përmbledhur të dhëna për tenderin jepen në tabelën e mëposhtme:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Punimerrgore "Lagjia Drita”		
1. Urdhër Prokurimi NR. 250. DATE 03.08.2018	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit A. Gj. Kryetar/ Arkitekt E. Ll. Anetar/ing. Ndertimi A.P. Anetar/ekonomist	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.249 dt. 03.08.2018 P. M. KRYETAR Ing. A. N. anetar Jurist D. T. anetare Ekonomiste.
2. Lloji I Procedurës së Prokurimit “Hapur ”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) : 13 190 233 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 13 098 531 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 91 702 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 14.09.2018	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit/ financim i huaj Bashkisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE a) Kualifikuar E. b) Kualifikuar A.-K.
11. Ankimime AK- ska; APP-s’ka; KPP-ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr datë ____	13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga z. E. Ll., Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës, z. A. Gj., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës (Arkitekt), z. A. P., me detyrë Specialist i Sektorit të Infrastrukturës, Emergjencave dhe Pronave (Ekonomist).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerësimit të kontratës realizuar nëpërmjet kontratave të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogaritjen e fondit.

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kriterëve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike (KLLFLST) dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerësimit të kontratës realizuar nëpërmjet kontratave të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogaritjen e fondit.

a- Llogaritja e fondit limit: Në dosjen e prokurimit nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se si ka proceduar AK për të llogaritur fondin limit të prokuruar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 2, “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, në të cilën përcaktohet se: “Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato”.

Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.

Vihet re se, në të gjitha kriteret e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

”Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

2.Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës, për kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 B (Punime gërmimi toke)
- NP-2 B (Ndërtime civile dhe Industriale)
- NP-3 B (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje Godinash civile e industriale, veshje fasada)
- NP- 4 A (Rrugë, autostrada, mbikalime ,hekurudha, tramvai, metro, pista aeroporte)
- NP-5 A (Punime nëntokësore, ura, vepra arti).
- NP – 12 B (Punime te inxhinierisë se mjedisit)
- NP – 17 A (Ndërtimi i impianteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane)
- NS 1 A-(Punime për prishjen e ndërtimeve)
- NP-7 B (Ujësjiellësa, Gazsjiellësa, Vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje)
- NS -8 A (Ndërtime parafabrikat beton arme ,struktura metalike dhe druri)
- NS-18 B (Punime topogjeodezike)
- NS-19 B (Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë)
- NS-20 A (Shpime gjeologo-inxhinierike ,puse e shpime për ujë) sipas modelit të lëshuar nga MPPT.

Për operoret e huaj të bëhet njësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale te kërkuara për ekzekutimin e kontratës

3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë të cilësisë së punimeve për ndërtime civile, punime në rrugë etj **ISO 9001-2008 (e vlefshme),**

3.2 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë e menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2004 (e vlefshme)**

3.3 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë mbi kushtet e sigurisë dhe shendetit të punonjësve **OHSAS 18001-2007 (e vlefshme),** në rast bashkimi operatorësh çdo operator duhet të paraqesë ISO.

3.4 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 39001:2012,** mbi sigurinë rrugore. Në rast bashkimi operatorësh çdo operatore duhet të paraqesë ISO, në rast bashkimi operatorësh çdo operator duhet të paraqesë ISO.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën **ISO 3834-2:2006** për sistemin e menaxhimit të cilësisë së saldimit.

3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën **ISO 27001:2013** për menaxhimin e sigurisë së informacionit në rast bashkimi operatorësh çdo operator duhet të paraqesë ISO.

3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën **ISO 28001:2007** për sistemin e menaxhimit të sigurisë në zinxhirin e furnizimit në rast bashkimi operatorësh çdo operator duhet të paraqesë ISO.

3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën **CEN/TR 1452-1:2009** për sistemimin e tubacioneve plastike për furnizimin me ujë, kullimet dhe kanalizimet nëntokësore dhe mbitokësore nën presion. Në rast bashkimi operatorësh çdo operator duhet të paraqesë ISO.

3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën **CEN/TR 13331-1 : 2002** për sistemin e veshjes së kanaleve

4.1 Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë drejtues teknik të punësuar të vërtetuar me kontratë pune me kohe të plotë të përfshirë në listpagesa për dy vitet e fundit.

- Inxhinier Ndërtimi (1)
- Inxhinier Hidroteknik (1)
- Inxhinier Mjedisi (1)
- Inxhinier Topograf (1)
- Inxhinier Mekanik (1)
- Inxhinier Gjeolog (1)

Pika 4.5 Shoqëria duhet të ketë kontraktuar një Ekspert Zjarrfikës i pajisur me licencë dhe i regjistruar si subjekt në QKR (eksperti), kontrata e lidhur ndërmjet OE dhe Ekspertit zjarrfikës e nënshkruar ndërmjet palëve duhet të përfshijë në kohëzgjatjen e saj të gjithë periudhen e vlefshmërisë së kontratës e cila prokurohet në këtë procedurë.

Pika 4.6 Operoret ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë Kontrate Furnizimi për materialet Hidraulike dhe Elektrike që do të përdoren për Rikonstruksionin e Objektit duke përfshirë Autorizim Prodhuesi Certifikatat Iso përkatëse Contact etj.

7. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojitet për ekzekutimin e kontratës.

LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA Minimumi
Kamiona me kapacitetmbi 10 ton	Nëpronësiose me qera	3 cope
Kamioncinembi 5 ton	Nëpronësiose me qera	3 cope
Eskavator me goma	Nëpronësiose me qera	2 cope
Eskavator me zinxhirë	Nëpronësiose me qera	2 cope
Betoniere (stacionerembi 2 m3)	Nëpronësiose me qera	2 cope
Motogjenerator	Nëpronësiose me qera	2 cope
Vibrator Betoni	Nëpronësiose me qera	2 cope
Autobot	Nëpronësiose me qera	1 cope
AutopompëBetoni	Nëpronësiose me qera	1 cope
AutobetoniereBetoni	Nëpronësiose me qera	1 cope
Motobetoniere 0.5 m3	Nëpronësiose me qera	5 cope
Fadromë me goma	Nëpronësiose me qera	2 cope
Kamionautovinç	Nëpronësiose me qera	2 cope
Armaturë	Nëpronësiose me qera	150 m ²
Nyje Inerte (Kodi Pajisur me kodin 3IB QKL)	Nëpronësiose me qera (KontratëFurnizimi)	1 cope



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Në lidhje me kriteret e sipërcituara, në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kriterë kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç sine qua non për hartimin dhe vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimeve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar, ditëve të punës të kërkuara për realizimin e kontratës si edhe kategorizimit të pikave të licencës, mjeteve dhe kontratave paraprake të furnizimit, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e shumë prej tyre.

Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1, 2, 20 dhe 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP si hartues të tyre si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor si miratuesi i kriterëve.

Përsa më sipër NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhe nenin 26 të VKM 797 nr. 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi kërkesa të tilla sjellin si pasojë ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskriminim të kandidateve. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht z. E. L., z. A. Gj. dhe z. A. P..

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z. P. M., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, z. A. N., me detyrë Specialist i Sektorit të Prokurimeve (Jurist), në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj. D. T., me detyrë Specialiste e Sektorit të Financës (ekonomiste), në cilësinë e anëtarit të KVO.

KVO ka nënshkruar formularin e deklaramentit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.

Nga vlerësimi rezulton se janë s’kualifikuar 1 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 2 operator, OE “A.-K.” dhe “E.” Shpk i cili është shpallur fitues.

Kualifikimet dhe s’kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Ofertanëlekëpa TVSH	Kualifikuar/s’kualifikuar	Klasifikimi
1	E.	13 098 531	Kualifikohet	13 098 531
2	A.-K.	13 177 960	Kualifikohet	

OE të kualifikuar.

OE “E.” shpk është kualifikuar dhe shpallur fitues. Nga auditimi i dokumentacionit të operatorit të shpallur fitues rezultojnë këto mangësi:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

1. **Pika 4.4** e kërkesës së Njesisë së Prokurimit për Operoret ekonomike pjesëmarës të cilët duhet të kenë të punësuar minimalisht **3 (tre)manovrator** si dhe **2 (dy) shoferë kamionash** si dhe **1 (një)Automakinist** të pajisur me dëshmitë e drejtimit si dhe Certifikatë e Aftësisimit Profesional sipas kategorive. Kontrata e punës e vlefshme, librezë pune si dhe të figurojë në listë pagesat e shoqërisë.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se Automekanistit të shoqërisë “E.” shpk P. M., i ka skaduar dëshmia e aftësisë profesionale me datë 08.12.2015.

2. **Pika 7** e kërkesave të Njesisë së Prokurimit kërkon nga Operatoridëshmi për mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojitet për ekzekutimin e kontratës.

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA Minimumi
1.	Eskavator me zinxhirë	Nëpronesiose me qera	2 Cope

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se operatori fitues ka paraqitur vetëm 1 ekskavator me zinxhirë, ndërkohë që janë kërkuar dy të tillë nga njësia. Ekskavatori tjetër i paraqitur është me goma.

-Gjithashtu rezulton se kamioni me targa AA417JS i paraqitur nga subjekti “E.” shpk, ka certifikatën për transport mallrash brenda vendit jashtë afateve të vlefshmërisë, pasi ky dokument ka qenë i vlefshëm deri me datë 18.07.2018, ose 2 muaj përpara hedhjes së dokumenteve në sistem. Gjithashtu, i njëjti mjet transporti ka edhe policën për sigurimin e detyrueshëm jashtë afateve të vlefshmërisë, pasi afati i saj skadonte me 12.07.2018.

Dokumentet që ka paraqitur BOE “E.” Shpk nuk plotësojnë kërkesat e DST dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “N” Shpk, edhe pse është edhe oferta me vlerë më të ulët ekonomike e paraqitur. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. P. M. në cilësinë e kryetarit të KVO, z. A. N. dhe zj. D. T., në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor z. N. R.

KVO ka vepruar në kundërshtim me pikën 5, të nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”, si dhe pikës 2 të nenit 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, ku citohet “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit”. Moskryerja e këtij veprimi e ngarkon me përgjegjësi KVO, z. P. M. në cilësinë e kryetarit të KVO, z. A. N. dhe zj. D. T., në cilësinë e anëtarëve të KVO.

Gjithashtu KVO pas vlerësimit të ofertave, për arsye se asnjëra prej tyre nuk përputhet me kriteret e vendosura në DT, në raportin përmbledhës drejtuar Titullarit duhet të propozonte për shpalljen fitues të operatorit tjetër pjesëmarrës ose anulim të procedurës së prokurimit. Mos kryerja e këtij veprimi është në kundërshtim me nenin 24 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku citohet “Autoriteti Kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm ...nëse asnjëra nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit” dhe ngarkon me përgjegjësi KVO të përbërë nga z. P. M. në cilësinë e kryetarit të KVO, z. A. N. dhe zj. D. T., në cilësinë e anëtarëve të KVO.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

Mos plotësimi i kushteve nga OE i shpallur fitues përbën veprime në papajtueshmëri me nenet 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797 datë 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Mbizbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “Ujësjellësi i fshatit German (rrjeti i shpërndarjes fshati Muzhake”.

Titulli i Gjetjes:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në përcaktimin e kriterëve dhe përzgjedhjen e ofertës fituese
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik u konstatua vendosja e kriterëve kualifikuese jo plotësisht në përputhje me natyrën e investimit, dhe në vlerësimin e ofertës fituese u konstatua se OE i shpallur fitues nuk i përmbush plotësisht ato, dhe pavarësisht mangësive është vlerësuar dhe shpallur fitues.
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për PP dhe urdhrat e Titullarit të AK për ngritjen e NJP, KVO etj.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në koston financiare të investimeve (në vlera maksimale) pa garantuar cilësinë e tyre
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatim i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	I Lartë.
Rekomandime:	Të merren masa për analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përzgjedhjen e OE fitues, vendimmarrje e cila ka sjell si pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet në vlerën prej 8,834,175 lekë (vlerë e barabartë me ofertën e shpallur fituese).

Në mënyrë të përmbledhur të dhëna për tenderin jepen në tabelën e mëposhtme:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Ujësjellësi fshati German (rrjeti i shpërndarjes fshatit Muzhake)”		
1.Urdhër Prokurimi NR. 316 . DATE 04.10.2018	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër Nr. 31 , dt.24.01.2018	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.233 dt. 18.07.2018
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “ k.propozim ”	A. N. Kryetar/ Jurist A. Gj. Anetar/Arkitekt D. N. Anetar/ekonomist	P. M. kryetar Ing. E. B. anetar Jurist D. T. anetare Ekonomiste.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 8 956 950 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 8 834 175 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 122 775lekë
8. Data e hapjes së tenderit 08.10.2018	9.Burimi Financimit Buxheti i shtetit/ financim i huaj Bashkise	10.Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrësnë tender 1 OE a) Kualifikuar N.
11.Ankimime AK- Ska; APP-s’ka; KPP-ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP Shkresa nr..... datë

Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Mat është përcaktuar njësia e prokurimit (NJP), e përbërë nga z. A. N., Specialist i Sektorit të Prokurimeve (Jurist), z. A. Gj., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës (Arkitekt), z. D. N., me detyrë Specialist i Sektorit të Financës (Ekonomist).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerësimit të kontratës realizuar nëpërmjet kontratave të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogaritjen e fondit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

Hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vendosja e kritereve nga Komisioni për Llogaritjen e Fondit Limit dhe Specifikimeve Teknike (KLLFLST) dhe Njësia e Prokurimit (NJP).

Nuk ka analizë mbi çmimin për njësi për to zëra që nuk janë të parashikuara në manual, si dhe nuk ka referenca dhe llogaritje të vlerës limit të kontratës realizuar nëpërmjet kontrata të ngjashme të autoriteteve kontraktore, si dhe preventivi nuk është i shoqëruar me analizë për përlllogritjen e fondit.

a- Llogaritja e fondit limit: Në dosjen e prokurimit nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se si ka proceduar AK për të llogaritur fondin limit të prokuruar.

b- Hartimi i dokumenteve të tenderit: DT janë hartuar me procesverbal. DST janë firmosur nga NJHDT, në përputhje me Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, pika 2, “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, në të cilën përcaktohet se: “Dokumentet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, që i kanë hartuar ato”.

Në këtë procesverbal nuk ka argumentim për kërkesat për kualifikim të hartuara nga NJHDT.

Vihet re se, në të gjitha kritereve e vendosura NJHDT nuk ka argumentuar arsyet e vendosjes së tyre, siç kërkohet shprehimisht nga pika 2 e nenit 61 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

”Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Nga auditimi i DT rezultoi se janë kërkuar:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

2.3.2 Të ketë të punësuar minimalisht 30 (tridhjetë) persona për periudhën Janar 2017 – Shtator 2018, të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për kete periudhë, shoqeruar me formularët e listepagesave E-SIG.

2.3.2.1 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës si më poshtë:

- 2 (dy) punonjësteknikndërtimi
- 2 (dy) punonjësmekanik
- 2 (dy) punonjëshidraulik
- 2 (dy) punonjësmurator
- 2 (dy) punonjëssaldator
- 2 (dy) punonjësmontator

2.3.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht

- 2 (dy) punonjës Ekskavatorist me goma
- 1 (një) punonjës Automakinist

Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit nga DPSHTRR (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse .

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues perkates per kryerjen e të gjitha punimeve në kete objekt. Per kete operatori ekonomik duhet të paraqese propozimin e tij (sipas tabelës së mëposhtme) me emrin e inxhinierit për secilin post, shoqeruar me diplomë, kontratë pune të vlefshme dhe CV për secilin inxhinier, për:

1 (një) inxhinier ndërtimi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

1 (një) inxhinier hidroteknik

1 (dy) inxhinier gjeodet

1 (një) Inxhinier Gjeolog

1 (një) inxhinier Mjedisi (i pajisur me certifikate (e vlefshme) lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis)

Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve të kontrates duhet të përmbajë kategorite e mëposhtme:

a) Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licensat e mëposhtme:

N.P – 1. A Punime gjurmimi në tokë.

N.P - 7. A Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje.

N.P–12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit

• Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë licensat e mëposhtme:

N.S – 9. A Punime strukturore speciale

N.S - 16 A Ndërtimi I impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij

N.S - 18 A Punime topogjeodezike

N.S - 19 A Shpime gjeolog-inxhinierike , puse e shpime për ujë .

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontrates. Për këto duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Kerkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamiona vetëshkarkues kapacitet mbajtës (mbi 20 ton)	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 copë	Pronësi ose me qera
Auto vinç me goma me krahe mbi 14 m dhe kapacitet ngrites 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhëre	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetonjere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot naftë	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues me goma minimumi 7.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Kostibator ngjeshes	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	2 copë	Pronësi ose me qera
Rimorkio për levizjen e mjeteve	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparatura për bashkim tubacionesh me metodën “BUTT FUSION JOINT” PE nga DN 25- DN 315	2 copë	Pronësi ose me qera
Aparature bashkimi në nyje dhe në zona të vecanta me “Elektrofuzion”	4 copë	Pronësi ose me qera
Aparature elektronike për kontrollin e presionit , Pompe presioni deri 40 bare për të realizuar procedurën e testeve të presionit sipas EN 805.	2 copë	Pronësi ose me qera
Instrument Topogjeodezim	1 copë	Pronësi ose me qera



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

-Sa i përket përgjegjësi të Njesisë së Prokurimit, rezulton se në njërin nga pikat e kërkesave të DST, konkretisht pika 2.3.7, është kërkuar edhe 1 Autobot naftë. Ky kriter është i pa argumentuar, pasi nuk kuptohet qëllimi i autobotit me kontratën objekt prokurimi.

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të disponoje certifikatat:

ISO 9001:2015 Çertifikate të cilësisë së punimeve për ndërtime civile .

ISO 14001:2015 Certifikatë e menaxhimit të mjedisit .

OHSAS 18001:2007 Shëndetin dhe sigurimin në punë “ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim .

DS CEN/TR 15128:2005 “Realizimin eriparimevetesistemevekanalizuese për shkarkimmedhekullimetëujërave.

ISO 1452 – 1 : 2009 mbi “Ndërtimin e sistemeve të tubacioneve për transportimin e ujit, mbi dhe nëntokësore”

BS EN 13331-1:200 i referohet sistemeve të rregullimit të llogrove/kanaleve ...

2.3.11 Operatoret ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin për materialet si me poshte:

Tuba PE 100 RC HDPE sipas dimensioneve të preventivit dhe specifikimeve .

- Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar
- Autorizimin nga distributori për ofertuesin
- Certifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO ISO 9001 , ISO 14001 , ISO 50001 , PAS 1075 Type 2 ,
- Standardi DIN 8074
- Miratimet PAS 1075 , DIN 8075 , DVGË GË 335 A2 , EN 12201
- Certifikatat e testimit
- Testet e miratimit të materialit në përputhje me PAS 1031 dhe PAS 1075
- Testet e sigurimit të cilësisë së materialit në përputhje me PAS 1075
- Testet e miratimit të tubave në përputhje me PAS 1075
- Testet e kontrollit të cilësisë së tubave në përputhje me PAS 1075

Kërkesat shënimi i tubave me shenja lazer duke përfshirë gjurmimin e tipit barkod të tipit 128-C në përputhje me ISO 12176-4 të shtypur direkt në tub.

Pajisje elektrofuzioni për nyje të tubave PE 100 RC HDPE sipas dimensioneve të preventivit dhe specifikimeve .

- Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar
- Autorizimin nga distributori për ofertuesin
- Certifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO ISO 9001 , ISO 14001
- Miratimet DVGË , EN 12201
- Kërkesat
- Materiali: PE 100
- Vlerësimi i presionit: SDR 11

Kompensimi i temperaturës (koha e fuzionit përshtatet automatikisht me temperaturën e ambientit)

Barkodi për procesin e shkrirjes automatike

Saraçineska sipas dimensioneve të preventivit dhe specifikimeve

- Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar
- Autorizimin nga distributori për ofertuesin
- Certifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO 9001
- Standardi EN 1074 (1-2) , ISO 5996



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV "Bashkia Mat"

- Certifikuar për ujë të pijshëm për DVGË
- Kërkesat
Përmasat ballë për ballë në EN 558-1: 2017 seri F14 (DIN 3202, F4)
Dimensionet e flanaxhave dhe shpimet e EN 1092-2
Trupi dhe mbulesa e hekurit EN 1563
Epoxy veshura brenda dhe jashtë DIN 30677-2 dhe GSK "mbrojtje korrozioni të rëndë"
(trashësia e veshjes > 250µm)
Projektuar për temperatura të shërbimit nga 0 ° C (duke përjashtuar acar) deri në 40 ° C

Ajrues sipas dimensioneve te preventivit dhe specifikimeve

- Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar
- Autorizimin nga distributori për ofertuesin
- Certifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO 9001
- Standardi EN 1074-4
- Certifikuar për ujë të pijshëm për DVGË
- Kërkesat
Valvul automatik me ajër të dyfishtë
Flanaxha EN1092-2
Rondele gome EPDM
Shkarkimi i vëllimeve të mëdha të ajrit gjatë fillimit dhe zbrazjes së tubacioneve
Shkarkimi i vëllimeve të vogla të ajrit ndërsa tubacionet janë nën presion
Veshje epoxy të brendshme dhe të jashtme

Matës uji sipas dimensioneve te preventivit dhe specifikimeve

- Autorizimin nga prodhuesit për distributorin e autorizuar
- Autorizimin nga distributori për ofertuesin
- Certifikatë për prodhuesin/ distributorin ISO 9001 ISO 14001
- Standardi EN 1074-4, ISO 4064 , EN 14154 OIML R49
- Certifikuar për ujë të pijshëm (p.sh: ACS ose ERAS) Miratimi i MID

Për materialet e rafinuarës:

a).Për mallrat e mësipërme, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratë furnizimi nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi, ose autorizim nga prodhuesi/distributor i autorizuar, me të cilin prodhuesi/distributor i autorizuar autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto material në këtë procedure prokurimi. Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributor i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin: Kontratë partneriteti që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin e shoqëruar me:

- Certifikatë ISO 9001:2008 të prodhuesit
- Te paraqiten dhe kataloget për të gjitha materialet sipas tabelës. Në katalog duhet markohet produkti që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kerkuara për keto produkt.

b).Krahas dorëzimit të dokumentacionit të sipërcituar, ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuar nga institucione të autorizuar (laboratorë) që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike dhe konkretisht

c).Për produktin:

- **Suva** (Llaç mbushës)- certifikim ku të vërtetohet se produkti përmbush specifikimet teknike në përputhje me Standardin SSH: EN 998-1. Në rast se është produkt jo i gatshëm



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

të deklarohet receptura përkatëse e çertifikuar nga laboratorë të akredituar që vërteton se produkti përmbush specifikimet teknike të kërkuara edhe sipas SSH: EN 998-1.

Në lidhje me kriteret e sipërcituara, në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kriterë kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç sine qua non për hartimin dhe vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimeve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar, ditëve të punës të kërkuara për realizimin e kontratës si edhe kategorizimit të pikave të licencës, mjeteve dhe kontratave paraprake të furnizimit, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e shumë prej tyre.

Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Po ashtu, lidhur me kërkesat për kontrata furnizimi dhe certifikata konformiteti, Njësia e hartimit të DST, nuk ka kërkuar që OE i cili do të shpallet fitues të paraqes në përfundim të objektit jo vetëm kontratat por edhe certifikatat e konformitetit, çka tregon se kriteret janë vendosur vetëm për të kufizuar pjesëmarrjen në prokurim dhe jo për të garantuar cilësinë e objektit. Nëse nga NJP, do të ishte vlerësuar maksimalisht kjo gjë, atëherë detyrimisht në DST duhet të ishte vendosur dhe përcaktimi i detyrimit të OE të shpallur fitues që pjesë të dosjes së prokurimit (krahas dokumenteve shoqëruese të kontratës) duhet të paraqesë dhe detyrimisht kontratat e furnizimit dhe certifikatat përkatëse të cilësisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1, 2, 20 dhe 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP si hartues të tyre.

Përsa më sipër NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhe nenin 26 të VKM 797 nr. 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi kërkesa të tilla sjellin si pasojë ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskriminim të kandidatëve. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht z. A. N., z. A. Gj. dhe z. D. N.

Kriteret e mësipërme nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik dhe konkurrencën ndërmjet tyre, krijojnë diskriminim të tyre, shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Kërkesat për kualifikim nuk janë hartuar në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, janë të paargumentuara dhe jo në përpjesëtimie me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe ngarkojnë me përgjegjësi NJP si hartues të tyre si dhe Titullarin e autoritetit kontraktor si miratuesi i kriterëve.

Përsa më sipër NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhe nenin 26 të VKM 797 nr. 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi kërkesa të tilla sjellin si pasojë ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskriminim të kandidatëve. Mos argumentimi i kërkesave për kualifikim dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “Bashkia Mat”

specifikimeve ngarkon me përgjegjësi NJHDT e përbërë nga NJP dhe konkretisht z. A. N., z. A. Gj. dhe z. D. N.

Vlerësimi i ofertave nga KVO

Me urdhër e titullarit të AK është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) i përbërë nga z. P. M., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, z. E. B., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të KVO dhe zj. D. T., me detyrë Specialiste e Sektorit të Financës (ekonomiste), në cilësinë e anëtarit të KVO.

KVO ka nënshkruar formularin e deklaramentit se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Është mbajtur procesverbali i hapjes dhe procesverbali i vlerësimit të ofertave nga KVO, e cila ka marrë në shqyrtim vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomik.

Nga vlerësimi rezulton se janë s’kualifikuar 0 operatorë ekonomik dhe kualifikuar 1 operator, OE “N” Shpk i cili është shpallur fitues.

Kualifikimet dhe s’kualifikimet jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Subjekti	Ofertanëlekëpa TVSH	Kualifikuar/s’kualifikuar	Klasifikimi
1	N	8 834 175	Kualifikohet	2 305 720

Për këtë procedurë rezulton se OE i shpallur fitues nuk paraqet mangësi në dokumentacion dhe vendimmarrja e KVO për shpalljen e tij fitues të procedurës është në përputhje me LPP.

Konstatime të përgjithshme

Vihet re që procesverbalet e NjP-së nuk janë protokolluar. Sjellim në vëmendje se, në përputhje me nenin 18 të “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, duhet të bëhet protokollimi i të gjithë procesverbaleve. Gjithashtu, mungon edhe procesverbali/ procesverbalët e KVO-së (siç kërkohet shprehimisht në pikën 5 të nenit 64 të VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar).

Vlen të theksohet se AK-ja ka mjaft mangësi në administrimin e dosjes së procedurës. Së pari, me faktin se dosja/et nuk është/janë të inventarizuar. Së dyti, mungesa e procesverbaleve të KVO-së, si edhe mungesa e një numër protokollit për procesverbalin e NjP-së, janë të meta serioze të dosjes.

Gjithashtu, vihet re se nuk është respektuar gjithmonë radha kronologjike e dokumentacionit, çka e bën më të vështirë kontrollin e tij.

Në lidhje me disponueshmërinë e inxhinierëve apo arkitektëve, e në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kriterë kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Parakushti kyç sine qua non për hartimin dhe vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimeve. Sa më sipër, referuar dhe natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar, si edhe kategorizimit të pikave të licencës, shpesh nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e profesionistëve të ndryshëm si pjesë e stafit teknik.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

KVO

Referuar raportit përmbledhës të vënë në dispozicion nga AK dhe të administruar në dosjet e prokurimit konstatohet se në kundërshtim me nenin 68 të VKM 914, datë 29.12.2014, raporti përmbledhës nuk përmban numrin e referencës së procedurës së prokurimit si dhe ky raport është hartuar nga Kryetari i KVO dhe jo nga të gjithë anëtarët e KVO, në kushtet e mësipërme titullari i AK nuk duhet të kishte bërë miratimin e këtij raportit përmbledhës dhe AK duhet të kishte anuluar procedurën e prokurimit.

Komente nga subjekti i audituar: Në kundërshtimet e paraqitura nga Bashkia MAT, shoqëruar me shkresën përcjellëse nr. 08/4, datë 07.05.2019, të administruara nga KLSH me nr. 1434/4, datë 13.05.2019, janë paraqitur observacionet për aktkonstatimet nr. 6 “Mbi procedurat e prokurimit për vitin 2017”, dhe aktkonstatimin nr. 7 “Mbi procedurat e prokurimit për vitin 2018”. Më poshtë paraqiten observacionet për secilën procedurë të kundërshtuar nga subjekti dhe rast pas rasti dhe qëndrimi i grupit të auditimit:

Mbi zbatimin e procedurave ligjore në tenderin me objekt “**Rikonstruksion i kanalit vadites fshati Derjan (i pjesshem)**”, për të cilën është observuar nga z. **Nezir Rizvani, me detyrë Kryetar i Bashkisë, z. P. M., zj. E. K., zj. D. T., z. E. Ç. dhe z. J. K., si dhe nga hartuesit e dokumenteve E. Ll., A. P. dhe A. N..**

Ne lidhje me OE e Kualifikuar dhe të shpallur fituese “V. N. I.S & N” sh.p.k nga auditimi rezulton se ky BOE ka keto mangesi:

Ne dst eshte kerkuar:

1- Pika 2.3.2/3 e kerkeses se DST ne te cilen kerkohet qe subjektet te paraqesin certifikaten ISO 1452-1:2009, per sistemet e tubacioneve plastike per furnizimin me uje, kullimet dhe kanalizimet nentokesore dhe mbi tokesore nen presion sipas kerkeses se DST.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se operatori fitues e ka paraqitur kete certifikate te paperkthyer ne gjuhen shqipe, ne kundërshtim me kerkesat e DST.

Per sa me sipër ne argumentojme:

“V. N. I.S & N” sh.p.k kane paraqitur qe te dyja ISO 1452-1:2009 te leshuara nga kompania A, . Ku mund te verifikohen letesisht ne adresën: <http://aqscert.org/>

2-Pika 2.3.4 e kerkeses se DST e cila kerkon qe Operatori ekonomik ofertues duhet te kete 1 (nje) mjek te pergjithshem te punesuar dhe te rezultoje ne listepagesat e shoqerise per te pakten 6 (Gjashte) muajt e fundit. Kjo te vertetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontrate pune te vlefshme, Urdher Mjeku, CV, libreze pune, diplomen perkatese. (Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike, secili prej anetareve te bashkimit duhet te kete pjese te stafit 1 (nje) mjek te pergjith shem te punesuar dhe te rezultoje ne listepagesat e shoqerise per te pakten 6 (Gjashte) muajt e fundit. Kjo te vertetohet me paraqitjen e dokumentave si me lart.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se mjeku i kontratuar nga operatori V. N. shpk, ka lejen individuale per ushtrimin e profesionit me date te paverifikushme, pra nuk verteton afatin e fillimit te vlefshmerise se saj.

Per sa me sipër ne argumentojme :

Shoqeria V. N. I.S ka paraqitur Kontraten Individuale date 15.07.2016 me Dr. Sh. I. shoqeruar me Diplome dhe me leje individuale per ushtrimin e profesionit .

3-Pika 2.3.4 e kerkeses se DST kerkon qe Operatoret ekonomik pjesemarres duhet te kene ne staf teknik te punesuar, te vertetuar me kontrate noteriale pune me afat vlefshmerie brenda afatit te



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

zbatimit te punimeve per kete objekt si dhe, diplome, CV, Librezat e punes, Deshmi kualifikimi te sigurimit teknik dhe te figurojne ne listepagesa (per vitin e fundit) si me poshte:

Inxhinier ndërtimi, (2 dy)

Inxhinier hidroteknik, (1 nje)

Inxhinier mekanik,(1 nje)

Inxhinier topograf, (1 nje)

Në rast bashkimi operatorësh çdo operator duhet të paraqesë nje koordinator për realizimin e punimeve qe do realizoj. Çertifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se inxhinieri i ndertimit i operatorit N shpk G. D. ka deshmie e sigurimit teknik jashte afateve te vlefshmerise pasi afati i saj skadon me 17.02.2017 pra 3 muaj para hapjes se tenderit.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se inxhinieri topograf i operatorit N shpk Sh. L. ka deshmie e sigurimit teknik jashte afateve te vlefshmerise pasi afati i saj skadon me 11.05.2017, pra 3 jave para hapjes se tenderit.

-Per inxhinierit e tjere te kerkuar nga DST, mungon deshmia e sigurimit teknik ne dokumentacionin e dorezuar nga operatori fitues.

Per sa i perket pikes 3:

Per sa me siper ne argumentojme si inxhinieri i ndertimit i operatorit N shpk G. D. eshte rinovuar dhe skadon me date 18.05.2018 .

4-Pika 12.3.8 e DST e cila kerkon nga operatori te paraqesi makineri per shtrimin me beton, rezulton te jete kerkese e argumentuar dhe e trajtuar ne menyre te pasakte pasi ky kriter eshte perdorur per skualifikimin e thuaje gjithë operatoreve, nderkohe qe edhe operatori fitues nuk ka paraqitur nje makineri te tille dhe njekohesisht edhe termi i perdorur eshte i gabuar pasi ato jane me shume pajisje ose armatura per shtrimin e betonit.

Per sa me siper ne argumentojme se shoqeria V. N. IS Shpk ka lidhur kontrate qiraje me Nr.1557.Rep dhe Nr.626.Kol me shoqerin C. S. I. Shpk per Makinerin e veshjeve te kanalit me beton (Te shoqerohet me foto).





KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“Bashkia Mat”

5-Pika 2.3.3 e DST qe kerkon nga operatorët qe te jene mesatarisht 75 punonjes nga Janari 2014 deri Shkurt 2017, rezulton te jete kriter i vendosur ne menyre te padrejte tek kapaciteti teknik pasi numri i punonjesve i shtrire ne kohe nuk percakton kapacitetin dhe eksperiencen e operatorit, dhe njekohesisht operatorët fitues nuk e plotesojne asnjeri kete kriter pasi ne vitin 2014 e ne vijim asnjeri prej tyre nuk ka pasur mesatarisht 75 punonjes ne vit por vetem se bashku, dhe ky kriter duhej te konsiderohej i paplotesuar nga KVO pasi qellimi i bashkimit te operatoreve eshte bashkimi i kapaciteteve dhe eksperiencave per te plotesuar kushtet dhe kriteret dhe jo bashkimin e fuqise punetore e ne te shkuaren.

Argumentojmë se ne baze te Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar bashkimi i operatoerve ekonomik duhet te paraqes Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht dhe ne raport me % duhet të plotësojn Kapaciteti ekonomik , financiar dhe teknik:

referuar marreveshjen noteriale te bashkepunimit perqindja ndahet :

V. N. 51 % (Duhet te kete 38 punonjes)

N 49 % (Duhet te kete 37 punonjes)

Bazuar ne Lispagesat dhe vertetimet mbi numrin e punonjeseve BO “ V. N. IS & N” Shpk kan te punzuar :

Per periudhen Janar 2014 - Dhjetor 2014 ka te punesuar mesatarisht 82 Punetore

(V. N. IS 37 te punesuar dhe N Shpk 45 te punesuar),

per periudhen Janar 2015 - Dhjetor 2015 ka te punesuar mesatarisht 106 Punetore ,

(V. N. IS 49 te punesuar dhe N Shpk 57 te punesuar),

per periudhen Janar 2016- Dhjetor 2016 ka te punesuar mesatarisht 117 Punetore ,

(V. N. IS 63 te punesuar dhe N Shpk 54 te punesuar),

si dhe per periudhen Janar 2017 - Shkurt 2017, ka te punesuar jo me pak se 138 Punetore ,

(V. N. IS 64 te punesuar dhe N Shpk 74 te punesuar),

Pamje e numrit te punësuarve sipas lispageses dhe Vertetimeve

Muaj	V. N. IS				N Shpk			
	Vitet				Vitet			
	2014	2015	2016	2017	2014	2015	2016	2017
1	31	37	53	59	35	57	51	76
2	31	37	43	69	35	56	49	71
3	33	38	53		33	65	51	
4	34	35	55		34	67	52	
5	35	36	57		32	67	56	
6	38	45	69		51	67	52	
7	40	40	73		51	67	51	
8	33	50	72		51	69	51	
9	33	47	73		54	43	53	
10	34	66	70		54	42	52	
11	43	76	71		55	41	60	
12	60	78	70		55	40	71	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
"Bashkia Mat"

Mesatarja

37

49

63

64

45

57

54

74

Pretendimet e Auditit nuk qendrojnë.

Lidhur me këte procedure prokurimi, nga dokumentacioni i paraqitur ne SEP nga BOE e shpallur fitues ka rezultuar se:

Lidhur mbi disponueshmerine e certifikates ISO 28000:2007, nga auditimi i dokumentacionit te ngarkuar ne sistem SEP, rezulton se te dy operatoret ekonomik "N" shpk dhe "V. N. I.S" shpk disponojne certifikaten ISO 28000:2007 "Certificate of conformity" per "Ndertim dhe rinovim i ndertimeve civile dhe industriale, infrastrukture rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nentokesore, ura e vepra arti, punime ne diga, hidrocentrale, sistemeve te ujesjellesave dhe ujerave te zeza. Mirembajtje rrugeshe rutine dhe ndertesash civile dhe industrial".

Për këtë konstatim argumentojmë se:

Ne lidhje me Certifikata ISO 28000:2007, arsyja pse nuk shfaqet ne sistemin e AQSCERT eshte per faktin qe shoqeria V. N. IS Shpk me date 13.06.2017 eshte paishur me standartin e ri te per sistemin e manaxhimit te sigurise ne zinxhirin e furnizimit konkretisht ISO 28001:2007 per per pasoj ISO 28000:2007 qe ju kontrolloni momentalisht ne system eshte e pavlefshme.

Pra shoqeria V. N. IS Shpk e ploteson standartin e kerkuar ne DST dhe sot .

Sa sipër veprimet e Njësisë së Prokurimit, Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe Kryetarit të Vlerësimit të Ofertave dhe Kryetarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Mat, janë në përputhje të plotë me nenet, 12,23,36,38,46,53,55 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenet 8,9,10, 58,66,67 dhe 68 të VKM nr.914, datë.29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"8402, date 10.9.1998 "per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", VKM-së nr 629 datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, si dhe qëllimin dhe frymën e legjislacionit të sipërcituar.



Emri i Kompanisë: "VLLAZNIA NDERTIM I.S" SHPK NIPT: K77524909Q

Adresa: Lagjia Pjeter Budi, Burrel, Diber, Albania

Nr. i Certifikatës: AQS/SSC/19642017

Standarti: ISO 28001:2007

Fusha EN: Construction and renovation civil and industrial constructions, road infrastructure, highways, overpasses, railways, underground works, bridges, works of art, the works on the dams, hydropower, systems of the water supply and sewage water. Routine maintenance of road and civil and industrial building.

Fusha AL: Ndërtim dhe rinovim i ndërtimeve civile dhe industriale, infrastrukturë rrugore, autostrada, mbikalime, hekurudha, punime nëntokësore, ura e vepra arti, punime në diga, hidrocentrale, sistemeve të ujësjellësave dhe ujerave të zeza. Mirëmbajtje rrugeshe rutinë dhe ndertesash civile dhe industriale.

First Issue Date: 13/06/2017

Data e Modifikimit: 18/02/2019

Vlefshmëria: Valid

Data e Skadencës: 12/6/2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

Sqarimi i bërë nga hartuesit e dokumenteve: E. Ll., A. P. dhe A. N..

Hartimi i kërkesave të vecanta është kryer në përputhje me nenin 46 pika 1 të ligjit 9643 datë 20.11.2016 “për prokurimin publik”, pasi referuar natyrës së kontratës, volumeve të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kerkuara, kategorizimi i licensave, mjeteve dhe pajisjeve mendojmë se për të verifikuar një aftësi teknike sa më lartë të operatoreve ekonomikë këto specifikime janë në përputhje të plote me natyrën e prokurimit që kryhet dhe në përputhje me nenin 46 pika 1 të ligjit 9643 datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” ku specifikohet pika b) aftësia teknike:operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimete nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetetë tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Theksojmë se për këto kritere nuk ka ankim nga asnjë operator dhe këto kritere nuk kanë sjelle ulje të konkurrencës dhe diskriminim të kandidateve dhe janë në përputhje me LPP.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit merren pjesërisht në konsideratë dhe më konkretisht: janë marrë në konsideratë kriteret e vendosura nga NJP lidhur me Makinerin e veshjeve të kanalit me beton, si dhe është marrë në konsideratë vendimmarja e KVO për plotësimi në kriterit nga "V. N. I.S & N" sh.p.k lidhur me certifikatën ISO 1452-1:2009 të leshuara nga kompania AQSCERT si dhe dokumeti i ushtrimit të profesionit si inxhinier ndertimi i operatorit N shpk G. D. e cila rezulton e rinovuar dhe skadon më datë 18.05.2018.*

Nga grupi i auditimit nuk është marrë në konsideratë sqarimi lidhur me mjekun e kontraktuar nga operatori “V. N.” shpk, i cili ka lejen individuale për ushtrimin e profesionit me datë të paverifikueshme, çka nuk vërteton afatin e fillimit të vlefshmërisë së saj; inxhinierin topograf i operatorit N shpk Sh. L. ka dëshminë e sigurimit teknik jashtë afateve të vlefshmërisë pasi afati i saj skadon me 11.05.2017, pra 3 javë para hapjes së tenderit; si dhe për inxhinierit e tjerë të kërkuar nga DST, të cilëve u mungon dëshmia e sigurimit teknik në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori fitues, pasi nuk është dhënë apo paraqitur asnjë dokument sqarues për këto mangësi.

Nuk është marrë parasysh gjithashtu edhe mos plotësimi i pikës 12.3.8 të DST sipas të cilës është kërkuar nga OE që të paraqesë makineri për shtrimin me beton, pasi edhe pse keni paraqitur foto të makinerisë, në SEP nuk rezulton të jetë ngarkuar nga operatori fitues makineria.

Lidhur me mosplotësimin e pikës 2.3.3 të DST sipas të cilës është kërkuar nga operatorët që të kenë mesatarisht 75 punonjës nga Janari 2014 deri Shkurt 2017, nuk merret në konsideratë duke mbajtur të njëjtin qëndrim sipas të cilit kriterifillimisht është vendosur në mënyrë të padrejtë tek kapaciteti teknik pasi numri i punonjësve i shtrirë në kohë nuk përcakton kapacitetin dhe eksperiencën e operatorit, dhe njëkohësisht operatorët fitues nuk e plotësojnë asnjëri këtu kriter pasi në vitin 2014 e në vijim asnjëri prej tyre nuk ka pasur mesatarisht 75 punonjës në vit por vetëm se bashku, dhe ky kriter duhej të konsiderohej i paplotësuar nga KVO pasi qëllimi i bashkimit të operatorëve është bashkimi i kapaciteteve dhe eksperiencave për të plotësuar kushtet dhe kriteret dhe jo bashkimin e fuqisë punëtore në të shkuarën.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“BashkiaMat”

Në lidhje me Certifikatën ISO 28000:2007, sipas të cilës sipas jush arsya pse nuk shfaqet në sistemin e AQSCERT është për faktin se shoqëria “V. N. IS” Shpk më datë 13.06.2017 është paisur me standartin e ri për sistemin e manaxhimit të sigurisë në zinxhirin e furnizimit konkretisht ISO 28001:2007 për pasojë ISO 28000:2007 që ju kontrolloni momentalisht në sëstem është e pavlefshme, nuk merret në konsideratë.

Ky argumentim nuk qëndron, për më tepër nuk është dhënë nga subjekti kompetent (shkresë apo vërtetim e lëshuar nga shoqëria AQSCERT) si dhe është kontradiktor përse ky dokument shfaqet në sistem për OE tjetër pjesëmarrës në BOE, “N” shpk.

Komente nga subjekti i audituar: Në kundërshtimet e paraqitura nga Bashkia MAT, shoqëruar me shkresën përcjellëse nr. 08/4, datë 07.05.2019, të administruara nga KLSH me nr. 1434/4, datë 13.05.2019, janë paraqitur observacionet nga KVO P. M., A. N. dhe D. T., për procedurën me objekt “Lagja Drita Faza II”

NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtimi me nenet 1,2,20,23 dhe piken 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhe nenin 26 të VKM 797 date 29.12.2017 “ Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi kërkesat e tilla sjellin si pasojë ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskriminim të kandidatëve.

Hartimi I kërkesave të vecanta është kryer në përputhje me nenin 46 pika 1 të ligjit 9643 date 20.11.2016 “Per prokurimin publik”, pasi referuar natyrës së kontratës, volumeve të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kerkuara, kategorizimi i licensave, mjeteve dhe pajisjeve mendojme se për të verifikuar një aftësi teknike sa me lartë të operatoreve ekonomik keto specifikime janë në përputhjet e plote me natyrën e prokurimit që kryhet dhe në përputhje me nenin 46 pika 1 të ligjit 9643 date 20.11.2016 “ Per prokurimin publik “ ku specifikohet pika b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Theksojme se për keto kritere nuk ka ankim nga asnjë operator dhe keto kritere nuk kanë sjelle ulje të konkurrencës dhe diskriminim të kandidatëve dhe janë në përputhje me LPP.

OE i shpallur fitues ka përmbushur kriterin pasi ka paraqitur dy eskavatorë me zinxhirë, ndërkohë që sipas grupit të auditimit është paraqitur vetëm një mjet i tillë.

Automakinistit të shoqërisë “E”, P. M. i ka skaduar dëshmia e aftësisë profesionale më datë 09.12.2015, sqarojmë se kjo shoqëri është me ofertën më të ulët në konkurrim dhe se në referim të nenit 53 mangësia është kostatuar si devijim i vogël, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat.

Lidhur me certifikatën e transportit të mallarave brenda dhe jashtë vendit jashtë afateve të vlefshmërisë për mjetin AA417JS (deri më 18.07.2018), sqarojmë se OE për të plotësuar këtë kërkesë ka paraqitur dokumentet përkatëse për 7 kamiona të cilat e plotësojnë atë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit merren pjesërisht në konsideratë dhe më konkretisht: janë marrë në konsideratë kriteret e vendosura nga NJP edhe pse janë të pa argumentuara ato, po ashtu janë marrë në konsideratë sqarimet e KVO për sa i përket kriterit për paraqitjen e dy mjeteve eskavator me zinxhir.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

Nuk është marrë në konsideratë mosplotëimi i kriterit për një Automakinistit të shoqërisë “E.”, z. P. M. të cilit i ka skaduar dëshmia e aftësisë profesionale më datë 09.12.2015, pasi kjo mangësi nuk është konstatuar nga ana juaj, por nga grupi i auditimit, për rrjedhojë konsiderimi i saj si devijim i vogël, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat duhet të ishte bërë në momentin e vlerësimit të ofertave nga KVO dhe jo pas auditimit të KLSH-së. Po ashtu nuk është marrë në konsideratë sqarimi mbi kriterin për certifikatën e mjeteve të transportit të mallarave brenda dhe jashtë vendit, për mjetin me targa AA417JS (deri më 18.07.2018), pasi edhe pse keni sqaruar se OE për të plotësuar këtë kërkesë ka paraqitur dokumentet përkatëse për 7 kamiona të cilat e plotësojnë atë, rezulton se numri i mjeteve të kërkuara (kamiona) është 6, por kapaciteti i tyre është ndarë në dy kategori dhe pavarësisht numrit në total të tyre (+1) nuk plotëson kriterin për kategorinë e mjeteve sipas DST mbi 5 ton dhe mbi 10 ton.

Komente nga subjekti i audituar: *Në kundërshtimet e paraqitura nga Bashkia MAT, shoqëruar me shkresën përcjellëse nr. 08/4, datë 07.05.2019, të administruara nga KLSH me nr. 1434/4, datë 13.05.2019, janë paraqitur observacionet nga KVO P. M., D. T. dhe E. K. për procedurën me object “Mirembajtje kanale vaditese”.*

Në faqen 92. 1 pika 2 iii e kriterëve të vecanta të kualifikimit thuhet që Operatorët ekonomik ofertues të kenë të punësuarve vertetur me kontrata pune të vlefshme dhe staf Teknik të meposhtem

1. Inxhinier ndertimi

2. Inxhinier hidroteknik

Ku rezulton që dy inxhinieret e mesiperm kanë paraqitur dëshmitë e kualifikimit të sigurimit Teknik jashtë afatit të vlefshmerisë së tyre.

Ky argument bie poshtë:

Per Inxhinierat nuk janë kërkuar fare dëshmitë e kualifikimit të sigurimit Teknik jashtë afatit të vlefshmerisë së tyre.

Në faqen 92. 2 pika 4 e kriterëve të vecanta të kualifikimit thuhet që Operatorët pjesëmarrës të posedojnë mjetet e nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate dhe konkretisht midis të tjerash dy kamione me kapacitet deri në 15 ton.

Ky argument bie poshtë:

Pasi Bazuar në ligjin nr 9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar nëni 53 4 ku thuhet që Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

Edhe pse dy kamionat e paraqitur kanë kapacitet mbi 18 ton ato nuk përbenin një shkak madhor për skualifikimin e operatorit ekonomik, kjo duke marrë parasysh edhe afatet për kryerjen e këtyre punimeve që ishin emergjente pasi në rast se kjo procedure do të anulohet do shkaktonte shumë vonesa të cilat do krijonin probleme sociale në fshatrat që ishin parashikuar që të kryheshin punimet.

Lidhur me OE e shpallur fitues, sipas të cilës është konstatuar nga ana juaj se dy inxhinierët (teknik ndërtimi dhe inxhinier hidroteknik) kanë paraqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik jashtë afateve të vlefshmerisë së tyre, sqarojmë se në DST faqe 92.2, pika 2 iii, nuk është kërkuar dëshmi kualifikuese e sigurimit teknik.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

Lidhur me konstatimin se mungojnë mjetet kamiona me kapacitet deri në 15 ton, sqarojmë se sipas pikës 92.2, pika 4, kjo mangësi është konsideruar si devijim i vogël, përse subjekti ka paraqitur dy kamiona me kapacitet pak më shumë se ato të kërkuar (mbi 18 ton) pasi nuk përbëjnë shkak madhor për skualifikim, duke marrë parasysh edhe afatet për kryerjen e punimeve që ishin emergjente

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit merren pjesërisht në konsideratë dhe më konkretisht tsqarimet e KVO për sa i përket Pika 2.iii e kriterëve të veçanta të kualifikimit ku kërkohet nga Operatorët ekonomik ofertues që të ketë të punësuar të vërtetuar me kontrata pune të vlefshme dhe stafi teknik të mëposhtëm: Inxhinier ndërtimi dhe Inxhinier hidroteknik, edhe pse duhet të kishit kërkuar sqarim nga subjekti për dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik jashtë afateve të vlefshmërisë së tyre.

Lidhur me mosplotësimin e Pikës 4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit sipas të cilës është kërkuar nga operatorët pjesëmarrës që të posedojnë mjetet e nevojshme për zbatimin e kësaj kontratë, dhe konkretisht 2 kamionë me kapacitet deri në 15 ton, për të cilën subjekti fitues ka paraqitur 2 kamionë me kapacitet mbi 18 ton, ndryshe nga kërkesat e përcaktuara nga NJP në DST. Ky kriter mbetet i pa plotësuar. Po ashtu konsiderimi nga ana juaj si një devijim i vogël, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat, duhet të ishte bërë në momentin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës dhe dokumetacionit të subjektit, veprim të cilin KVO nuk reulton ta ketë kryer. Konstatimi i mangësisë dhe konsiderimi i saj si devijim i vogël, apo jo, duhet të ishte bërë në kohën e vlerësimit të saj nga KVO dhe jo pas konstatimit të bërë nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Komente nga subjekti i audituar: Në kundërshtimet e paraqitura nga Bashkia MAT, shoqëruar me shkresën përcjellëse nr. 08/4, datë 07.05.2019, të administruara nga KLSH me nr. 1434/4, datë 13.05.2019, janë paraqitur observacionet nga KVO P. M., D. T. dhe E. K., dhe NJP E. Ll., A. P. dhe A. N. për procedurën me objekt “Rehabilitim vepra e marrjes kanali Ujitës Batër e madhe”.

NJP ka hartuar kërkesa për kualifikim në kundërshtimi me nenet 1,2,20,23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46 të LPP, dhenenit 26 të VKM 797 datë 29.12.2017 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pasi kërkesa të tilla sjellin si pasoje ulje të konkurrencës në prokurim dhe diskriminim të kandidatëve.

Hartimi i kërkesave të veçanta është kryer në përputhje me nenin 46 pika 1 të ligjit 9643 datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik, pasi referuar natyrës së kontratës, volumeve të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuara, kategorizimi I licensave, mjeteve dhe pajisjeve mendojme se për të verifikuar një aftësi teknike sa me lartë të operatoreve ekonomik keto specifikime janë në përputhje të plote me natyrën e prokurimit që kryhet dhe në përputhje me nenin 46 pika 1 të ligjit 9643 datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” ku specifikohet pika b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikime të nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisje të asetatit tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelinë nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Theksojme se keto kritere nuk kanë sjelle ulje të konkurrencës dhe diskriminim të kandidatëve dhe janë në përputhje me LPP.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“BashkiaMat”

Gjithashtu për këtë procedurë ka ankim në AK me shkresë nr 464 prot date 28.02.2017 për të cilën është ngritur një komision i 2 për rivlerësimin e kritereve dhe kthim përgjigje me shkresën nr. 464/1 prot, date 03.03.2017, gjithashtu ka ankim në APP me shkresë nr. 644/1 prot, date 20.03.2017 për të cilën APP ka kthyer përgjigjen me shkresë nr.174/1, date 28.03.2017 dhe kriteret e vendosura janë çësuar në përputhje me LPP.

1. Në faqen 88 të projekt raportit pika 1.2.3 thuhet që krahas të tjerave Operatorët pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre punonjës të kualifikuar me kontratë pune të vlefshme të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik nga IQT si dhe nga shqyrtimi I dokumentacionit Operatori ekonomik ka paraqitur një listë punonjësish me kualifikimet e nevojshme nga një trupë tjetër certifikuese dhe jo nga IQT.

Ky argument bie poshtë :Bazuar në ligjin nr 9643 date 20.11.2006 I ndryshuar neni 53 4 ku thuhet që Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

2. Në faqen 89 të projekt raportit pika 2.3.5 thuhet që Operatori ekonomik ka paraqitur makineritë e kërkuara si kamiona, kamioncina etj vetëm me lejet e qarkullimit dhe pa dokumentacion të tjera shtesë si fotot e mjetit , siguracioni etj, për autobetonieret kanë lidhur dy kontrata qeraje me dokumentacion të shtetit të Kosovës por pa vulë apostile, gjithashtu thuhet që eskavatori me zinxhirë nuk është më çekic pneumatic

Ky argument bie poshtë:

Pasi në dst thuhet që Makineritë dhe Pajisjet të jenë në pronësi ose me qira.

Pronësia e mjeteve të mësipërme të vërtetohet si më poshtë :

Ofertuesi duhet të paraqesë për makineritë të cilat janë në pronësi, lejet e qarkullimit të tyre (të cilat duhet të jenë në emer të shoqërisë), Për mjetet dhe pajisjet e tjera që nuk kanë leje qarkullimi Ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes, ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit.

Pranohet marrja me qira ose huapërdorje e mjeteve të mesiperme, me kusht që kontratat e qiramarrjes ose të huapërdorjes të jenë të lidhura para noterit, me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

Vlen të përmendet se për disa kamion janë hedhur edhe fotot dhe të dhëna të tjera shtesë edhe pse në dst nuk janë kërkuar

Gjithashtu çekici pneumatic është paraqitur me faturën tatimore nr 24 datë 10.06.2006.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit merren pjesërisht në konsideratë dhe më konkretisht: janë marrë në konsideratë kriteret e vendosura nga NJP. Lidhur me mangësitë e subjektit, për mjetet e kërkuara, sqarimi i bërë nga ana juaj nuk merret në konsideratë, kjo referur kritereve dhe përcaktimeve të DST dhe dokumentacionit të ngarkuar në SEP nga operatori, dokumentacion sipas të cilit është kosntatuar se mungojnë mjetet dhe konkretisht:

Nuk kanë paraqitur fadromën me goma; Eskavatori i kërkuar me zinxhir me çekic pneumatik, nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton të jetë pa çekicin pneumatik dhe mungojnë edhe fotografitë provuese. Lidhur me sa pretenduar se çekici pneumatik është pjesë e faturave tatimore të ngarkuara nga subjekti, sqarohet se çekici pneumatik nuk është kërkuar si mjet i vecuar por si aksesorë bazë i eskavatorit me zinxhir. Nëse do ishte kërkuar ndryshe në DST,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

atëherë sqarimi do përbënte shkak të vlefshëm për tu marrë parasysh. Po ashtu sqarojmë se nuk keni këkuar për asnjë rast sqarim nga NJP lidhur me paqartësi që mund të keni pasur gjatë vlerëimit, pasi keni konsideruar sa ngarkuar nga subjekti në përputhje me DST.

Për 2 kamionët e kërkuar si dhe kamionçinën, janë hedhur në sistem vetëm disa leje qarkullimi, por mungojnë materiale të tjera shtesë provuese për posedimin e tyre si dhe fotot përkatëse.

Për kamionin me vinç, operatorët kanë paraqitur një kontratë qiraje të këtij mjeti, por mungojnë dokumentet shtesë bashkëlidhur, fotot e mjetit, siguracioni etj.

Për autobetonieret, BOE fitues kanë lidhur një kontratë qiraje për dy mjete me targa dhe dokumentacion të shtetit të Kosovës, por atyre u mungon vula apostile sipas kërkesave të ligjit për dokumentet të cilat nuk janë të lëshuara nga organet e Shqipërisë.

Komente nga subjekti i audituar: Në kundërshtimet e paraqitura nga Bashkia MAT, shoqëruar me shkresën përcjellëse nr. 08/4, datë 07.05.2019, të administruara nga KLSH me nr. 1434/4, datë 13.05.2019, janë paraqitur observacionet nga NJP A. N., A.Gj. dhe A. P.

Mbi zbatimin e procedurave ligjore ne tenderin me objekt “Punime Rrugore Lagjia “Drita”
Konstatimi i Grupit Auditues të KLSH-së, është i pa bazuar në ligje dhe prova pasi, Fondi limit për këtë prokurim është parashikuar në projektin e hartuar, projekti gjithashtu ka në mënyrë të detajuar dhe specifikimet teknike, preventivat me dhe pa cmime, theksojmë se ky projekt ku ka të përcaktuar dhe fondin limit i është nënshtruar procedurave ligjore, dhe se cmimi është në përputhje të plote me VKM-në nr 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, Theksojmë se referuar nenit 46 të VKM nr.914, datë.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku thuhet... Titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Në kuptim të kësaj dispozite del qartë se Kryetari i Autoritetit Kontraktor është përgjegjës për nxjerrjen e urdhërave për zbatimin e procedurave të prokurimit, detyrim ligjor të cilën e ka ezauruar, referuar pretendimit tuaj se nuk është përcaktuar fondin limit, është i pa bazuar në ligje dhe prova pasi në projektin e hartuar nga Bashkia Mat ka përcaktuar qartë fondin limit specifikimet teknike, si dhe të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me hartimin e projektit, theksojmë se projekti është hartuar në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 8402, date 10.9.1998 “për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, gjithashtu në dosjen e këtij prokurimi ka qenë dhe një kopje e projektit, me preventivat përkatës me shënimin se cmimet janë përlllogaritur në bazë të VKM-së nr 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, përveç projektit në DST e hartuar nga njësia e prokurimit kanë qenë pjesë integrale dhe specifikimet teknike detyra e projektimit, skicat dhe planimetrit, pra në tërësinë e tij, jemi para një prokurimi të realizuar në përputhje të plotë me ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, në VKM nr.914, datë.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe VKM-në nr 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

Në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e njësisë së prokurimit në lidhje me Punime Rrugore Lagjia “Drita”, me fond limit: 13.190.233 (trembëdhjet milion njëqind e nëntëdhjet mijë e dyqind e tridhjet e tre) lek pa Tvsh. Nga ana Jonë referuar sa sipër del qartë se njësia e prokurimit ka zbatuar me korrektësi kërkesat ligjore sic edhe parashikohen në ligjin e sipërcituar.

Argumenti i përdorur nga Grupit Auditues të KLSH-së, është i pa bazuar në ligje dhe prova e si i tillë duhet të merret në konsideratë nga grupi auditues, për ta hequr si përgjegjësi në këtë fazë ankimimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit merren pjesërisht në konsideratë dhe më konkretisht: janë marrë në konsideratë përsa i përket përgjegjësi të Titullarit të AK, lidhur me ngritjen e strukturave përkatëse për realizimin e prokurimit (NJP dhe KVO), por nuk është marrë në konsideratë përsa i përket detyrimit për ngritjen e komisionit për llogaritjen apo vlerësimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike.*

Komente nga subjekti i audituar: *Në kundërshtimet e paraqitura nga Bashkia MAT, shoqëruar me shkresën përcjellëse nr. 08/4, datë 07.05.2019, të administruara nga KLSH me nr. 1434/4, datë 13.05.2019, janë paraqitur observacionet nga N. R., Titullar i Ak, KVO, P. M., D. T. dhe E. B., NJP, A. N., D. N. dhe A. Gj., për procedurën e prokurimit me objekt Ujësjetllësi i fshatit Gërman (rrjeti i shpërndarjes fshati Muzhak).*

Për këtë procedurë prokurimi nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mat janë zbatuar me korrektësi parimet kryesore si dhe fryma e ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, meVKM nr.914, datë.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Nga AK Bashkia Mat, para se të nis procedura janë hartuar projekti, preventivat, specifikimet teknike si dhe detyra e projektimi, gjithashtu refruar nenit 56 të VKM nr.914, datë.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nga titullari i Autoritetit Kontraktor janë ndërmarrë të gjitha hapat ligjor dhe konkretisht janë ngritur grupet e punës sic edhe parashikon kjo dispozitëTitullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrit të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të autoritetit kontraktor, zakonisht zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit.

Gjithashtu refruar nenit 57të VKM nr.914, datë.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku thuhet me lejoni të citoj dispozitën..... Titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, cakton me urdhër të veçantë personin/personat përgjegjës për prokurimin dhe dërgon emrin/emrat respektivë në Agjencinë e Prokurimit Publik. Personi/at përgjegjës për prokurimin duhet të administrojë/jnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e prokurimit. Në varësi të numrit të procedurave të prokurimit të parashikuara për t’u zhvilluar, autoriteti kontraktor mund të caktojë më shumë se një person përgjegjës për prokurimin.

Sic edhe refrohet sa sipër del qartë se nga ana Titullarit të AK Bashkia Mat, janë zbatuar me korrektësi parimet dhe fryma e VKM-së së sipërcituar, e thënë ndryshë veprimet dhe mosveprimet e titullarit të AK Bashkia Mat janë të bazuara në ligje dhe prova.

Në lidhje me njësië e prokurimit përlllogaritjen e fondit limit dhe specifikimet teknike, analizë mbi cmimin. Duhet theksuar se për këtë prokurim është hartuar projekti teknik, projekt i cili është hartuar në përputhje të plotë me ligjin nr. 8402, date 10.9.1998 “per kontrollin dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

disiplinimin e punimeve te ndertimit”, gjithashtu në dosjen e këtij prokurimi ka qenë dhe një kopje e projektit, me preventivat përkatës me shënimin se cmimet janë për llogaritur në bazë të VKM-së nr 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, përveç projektit në DST e hartuar nga njësia e prokurimit kanë qenë pjesë integrale dhe specifikimet teknike detyra e projektimit, skicat dhe planimetrit, pra në tërsinë e tij, jemi para një prokurimitë realizuar në përputhjet plotë me ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, meVKM nr.914, datë.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe VKM-në nr 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave te knike të tyre”.

Ky prokurim i është nënshtruar të gjitha procedurave standarte që para shikon ligji, dhe është miratuar pa vrejte nga aorganet eprore teknike dhe financiare se APP-ja dhe Dega e Thesarit, ky prokurim ka qenë elektronik, dhe se ka qenë i aksesueshëm nga të gjithë operatorët ekonomik të interesuar për pjesmarrje në këtë procedure prokurimi.

Vendosja e kërkesave për kualifikim dhe argumentimi i kërkesave për kualifikim, dhe konkretisht autoboti i naftës.

Vendosja e kërkesave për kualifikim është hartuar nga njësia e prokurimit ku kjo e fundit ka patuar specialist të fushave për hartimin e këtyre kërkesave, dhe se kërkesat për kualifikim janë vendosur në përputhje të plotë me ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, me VKM nr.914, datë.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe ligjin 8402, date 10.9.1998 “per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, gjithashtu në dosjen e këtij prokurimi ka qenë dhe një kopje e projektit, me preventivat përkatës me shënimin se cmimet janë përlllogaritur në bazë të VKM-së nr 629 datë 15.07.2015 “Përmiratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave te knike të tyre.

Vendosja në kërkesa për kualifikim e këtij kriteri është në përputhje me ligjet e sipërcituar dhe me dinamikën e punë venë këtë kontratë, ky object në grafikon e realizimit të punimeve ka patur afat të shkurtër përpërmbylljen e punëve, gjithashtu ky object është larg qendrave të banuara dhe se kantieri ku punohej nuk kishte afër pike karburanti në këtë kuptim është e domosdoshme patja e një cisternoje tip bot për realizimin në kohë të kësaj kontrate.

Në lidhje me: konstatimin se KVO ka kualifikuar operatorin ekonomik N pasi: Materjali dokumentar ligjor dhe teknik i paraqitur nga subjekti N për Tuba PE 100RC HDPE, dokumetacioni dhe materialet janë të papërkthyer.

Në lidhje me këtë pretendim Ju bëjmë më dije se KVO, në përbërje të cilit ka specialist të fushës si dhe te tre antarët e KVO-së janë njohës të gjuhës Angleze, ndërkohë nga logimi në sistemin e leshimit të ISO, nga institucione vendas dhe të huaja rezulton se operatori ekonomik N shpk, i përbush të gjitha kërkesat për kualifikim dhe se veprimet dhe mosveprimet e Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, janë në përputhje të plotë me nenin 53,55 të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 58,66,67,dhe 68 të VKM nr.914, datë.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në këtë kuptim duhet rishikuar dhe ky rekomandim i grupit auditues.

Sa sipër veprimet dhe mosveprimet e Njësisë së Prokurimit, Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe Kryetarit të Vlerësimit të Ofertave dhe Kryetarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Mat, janë në përputhje të plotë me nenet, 12,23,36,38,46,53.55 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenet 8,9,10, 58,66,67,dhe 68 të VKM nr.914, datë.29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”8402, date



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

10.9.1998 “per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve tendertimit”, VKM-së nr 629 datë 15.07.2015 “Përmiratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, si dhe qëllimin dhe frymën e legjislacionit të sipërcituar.

Sa sipër kërkojmë rishikimin e project raportit në lidhje me prokurimin e objektit: Ujësjetllësi i fshatit Gërman (rrjeti i shpërndarjes fshati Muzhak) me fond limit 8.956.950 (tetëmiljon nëntëqind e pesëdhjet e gjashtëmijë e nëntëqind e pesëdhjet) lek.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit merren pjesërisht në konsideratë dhe më konkretisht: janë marrë në konsideratë përsa i përket përgjegjësi të Titullarit të AK, lidhur me ngritjen e strukturave përkatëse për realizimin e prokurimit (NJP dhe KVO), por nuk është marrë në konsideratë përsa i përket detyrimit për ngritjen e komisionit për llogaritjen apo vlerësimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike. Po ashtu është marrë në konsideratë vlerësimi i kryer nga KVO.

Komente nga subjekti i audituar: Në kundërshtimet e paraqitura nga Bashkia MAT, shoqëruar me shkresën përcjellëse nr. 08/4, datë 07.05.2019, të administruara nga KLSH me nr. 1434/4, datë 13.05.2019, janë paraqitur observacionet nga KVO P. M., D. T. dhe E. K. dhe NJP A. N., D. N. dhe L. K., për procedurën e prokurimit me objekt “**Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Mat**”.

Me urdhërin nr. 590, datë 29.09.2016 “Për ngritjen e komisionit për llogaritje e kostos së pastrimit” është ngritur dhe ka funksionuar komisioni për llogaritjen e kostos për shërbimin e pastrimit dhe ka analizuar dhe hartuar fondin limit në bazë të secilit zë preventivi dhe ka analizuar koston për cdo element.

Në vendosjen e kriterëve nga NJP jemi bazuar në nenin 26 të VKM nr. 797, datë 29.12.2017 si dhe LPP.

Nga auditimit thuhet në mënyrë të përgjithshme se kriteret e vendosura nga NJP janë diskriminuese dhe nuk nxisin konkurrencën, konstatim i cili nuk qëndron. NJP është bauer në nenin 46 të LPP, duke mos ardhur në kundërshtim me bazën ligjore të sipërcituar dhe duke mos krijuar pengesa për OE të interesuar pëe këtë procedurë konkurruese. Sa më lart NJP vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve, të cilër nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetit ekonomike etj. Në varësi të kontratës dhe volumit të punimeve AK përcakton dhe kërkesat e vecanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përacaktuar në rregullat e PP. Në këtë kuptim, për AK është e rëndësishme të provohet se që OE zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumenteve të tilla si certifikata ISO.

Titullari i AK nuk ka përgjegjësi për ngritjen e komisionit të “vlerësimin të fondit limit” dhe specifikimeve teknike, pasi në fillim të vitit cakton me urdhër të vecantë personat përgjegjës dhe ja dërgon APP dhe në varësi të numrit të procedurave mund të shtojë edhe numrin e personave përgjegjës për prokurimin.

Lidhur me konstatimin se vlerësimi i KVO është marrë në mungesë të dokumentacionit dhe konkretisht:

Lidhur me inxhinierin Kimist, sqarojmë se ky kriter është hequr nga KPP me vendimin nr. 748/2017 dhe është bërë modifikimi me shtojcën përkatëse ne sistem dhe subjekti nuk ka pasur detyrim që të paraqesë dokumente për këtë kriter.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

Lidhur me kriterin e mjekut të përgjithshëm, po ashtu ky kriter është hequr nga KPP me vendimin nr. 748/2017 dhe është bërë modifikimi me shtojcën përkatëse në sistem dhe subjekti nuk ka pasur detyrim që të paraqesë dokumente për këtë kriter.

Lidhur me mos paraqitjen e certifikatave ISO 50001-2012 dhe ISO3834-2;2015, ky kriter është hequr nga komisioni i shqyrtimit të ankesës në Bashkinë Mat dhe është bërë modifikimi me shtojcën përkatëse në sistem dhe subjekti nuk ka pasur detyrim që të paraqesë dokumente për këtë kriter.

Lidhur me kriterin e 100 kontenierëve, sqarojmë se po ashtu ky kriter është hequr nga komisioni i shqyrtimit të ankesës në Bashkinë Mat dhe është bërë modifikimi me shtojcën përkatëse në sistem dhe subjekti nuk ka pasur detyrim që të paraqesë dokumente për këtë kriter. Për procedurën e negocimit ku citohet se disa nga vërtetimet mbajnë datën 24.10.2017 pra 1 ditë pas zhvillimit të procedurës së negocimit sqarojmë se subjekti “K.” shpk si dokument justifikues për detyrimet ndaj administratës tatimore ka paraqitur marrëveshje me DRT Dibër për pagesën me këste e cila mban datë 04.10.2017, pas kësaj i kemi kërkuar dokumente shtesë nga administrata tatimore edhe pse nuk ishte e nevojshme pasi ky kriter ishte përmbushur dhe duke u udhëhequr nga nevoja ekstreme për këtë shërbim si dhe cmimi më i ulët u kualifikua subjekti.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Nga grupi i auditimit kundërshtimet e subjektit merren pjesërisht në konsideratë dhe më konkretisht: janë marrë në konsideratë kriteret e vendosura nga NJP dhe të hequra pas vendimit të KPP lidhur me inxhinierin kimist dhe mjekun e përgjithshëm, qëndrim i cili vlen edhe për vendimarrjen e KVO-së, edhe pse vendimi i KPP nr. 748/2017 nuk ishte pjesë e dosjes së prokurimit.*

Lidhur me procedurën e prokurimit me negocim pa shpallje, grupi i auditimit i qëndron konstatimit lidhur me subjektin fitues “K.” shpk, i cili si dokument justifikues për detyrimet ndaj administratës tatimore ka paraqitur marrëveshje me DRT Dibër për pagesën me këste e cila mban datë 04.10.2017, dokument i cili vërteton se subjekti ka detyrime ndaj administratës tatimore dhe jo të kundërtën e saj.

Komente nga subjekti i audituar: *Në kundërshtimet e paraqitura nga Bashkia MAT, shoqëruar me shkresën përcjellëse nr. 08/4, datë 07.05.2019, të administruara nga KLSH me nr. 1434/4, datë 13.05.2019, janë paraqitur observacionet nga NJP, A. N., B. H. dhe D. N., për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës 9-vjecare 31 Korriku”.*

Projekti i “Rikonstruksion i Shkollës 9-vjecare 31 Korriku” është blerë nga Bashkia Mat sipas procedurave të prokurimit të vitit 2016, ku pjesë e të cilit ka qenë preventivi i investimit. Zërat e punimeve janë ose me analizë cmimi ose me cmim manuali, sipas VKM nr. 629, datë 15.7.2015.

Nuk është e nevojshme ngritja e një komisioni të posaçëm për të përlllogaritur fondin limit pasi kjo është bërë nga projektuesi, si dhe se në referim të nenit 57/4 nuk është detyrë e NJP llogaritja e fondit limit, përse kjo detyrë nuk i është ngarkuar.

Kërkesat për kualifikim janë hartuar nga NJP dhe se të gjitha kriteret e vendosura janë të arsyetuara si dhe të bazuara në VKM nr. 914, vendimet dhe udhëzimet që kanë të bëjnë me procedurat e PP. Kriteret janë vendosur në përputhje me preventivin e punimeve si dhe me specifikimet teknike për objektin.

Lidhur me kriterin e fuqisë punëtore 2014-2016, të shtrirë në kohë, në referim të nenit 26/8, pika b te VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ky kriter nuk është pjesë e kriterëve të cilat shërbejnë për të vërtetuar eksperiencën të sukseseshme pune të ngjashme apo besueshmërinë ekonomike



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

financiare të OE, pasi janë kritere të tjera të cilat mundësojnë këto. Nga NJP është vendosur ky kriter pasi në kryerjen e punimit konkret është e nevojshme fuqi punëtore dhe shtritja në kohe tregon besueshmëri, garanci dhe efikasitet në kryerjen e punimeve por edhe në mënyrë që të krijohet besueshmëria për të ardhmen (bazuar në të kaluarën) e subjektit fitues ër ekzekutimin e objektit të prokurimit por në asnjë moment vendosja e këtij kriteri i cili është parashikuar në VKM nuk i diskriminon EO e rinj ekonomik që të marrin pjesë në procedura prokurimi.

Për vendosjen e kritereve NJP është bazuar në nenin 46 të VKM nr. 797, datë 29.12.2017 si dhe nenin 46 të LPP.

Nga auditimit thuhet në mënyrë të përgjithshme se kriteret e vendosura nga NJP janë diskriminuese dhe nuk nxisin konkurrencën, konstatim i cili nuk qëndron. NJP është bauer në nenin 46 të LPP, duke mos ardhur në kundërshtim me bazën ligjore të sipërcituar dhe duke mos krijuar pengesa për OE të interesuar pëe këtë procedurë konkurruese. Sa më lart NJP vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve, të cilër nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetit ekonomike etj. Në varësi të kontratës dhe volumit të punimeve AK përcakton dhe kërkesat e vecanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përacaktuar në rregullat e PP. Në këtë kuptim, për AK është e rëndësishme të provohet se që OE zotëron kapacitetin teknik lidhur me përvojën e duhur, vërtetuar kjo edhe nëpërmjet dokumenteve të tilla si certifikata ISO.

Titullari i AK nuk ka përgjegjësi për ngritjen e komisionit të “vlerësimit të fondit limit” dhe specifikimeve teknike, pasi në fillim të vitit cakton me urdhër të vecantë personat përgjegjës dhe ja dërgon APP dhe në varësi të numrit të procedurave mund të shtojë edhe numrin e personave përgjegjës për prokurimin.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga grupi i auditimit merret në konsideratë sqarimi lidhur me përcaktimin e bëra nga neni 12 i Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe neni 56 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik” i ndryshuar, lidhur me përcaktimin e përgjegjësisë të Titullarit të Autoritetit Kontraktoro se zyrtarit të autorizuar prej tij lidhur me përgjegjësinë për organizimin dhe realizimin e procedurës së prokurimit, dispozitë e cila ka theksuar se: “Nuk lejohet që titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar të drejtojë një komision ose të marrë pjesë në fazën e procedurës së përzgjedhjes së fituesit, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Në çdo rast, detyrat që përcaktohen në këto rregulla për titullarin e autoritetit kontraktor ose zyrtarin e autorizuar prej tij duhet të kryhen në përputhje me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar”.

C/1Hartimi, zbatimi i kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimit i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve.

Nga auditimi i zbatimit të punimeve u konstatua:

I. Zbatimi i kontratës me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku”, ku rezultoi:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës, i dokumentacionit të administruar në dosjen teknike me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 31



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

Korriku”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Z. N. R. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V. N. I.S” & “N” SHPK përfaqësuar nga Z. A. Ç. administrator i OE “V. N.” shpk dhe nga Z. Xh. N administrator i OE “N” SHPK, u konstatua se:

- Për zërin “Furnizim dhe instalim kaldajë për ngrohje me ujë me lendë djegëse pelletkomplet me instrumentat matës dhe të kontrollit të parametrave të ujit të ngrohtë, Q nimore 250,000 kilokalori/orë, përfshirë montimin e të gjithë tubacioneve dhe pajisjeve deri në dalje nga dhoma e djegjes” është llogaritur me TVSH, duke i konsideruar punime ndërtimi punimet e furnizimit dhe instalimit të pajisjeve dhe për pasojë, janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve në vlerën **480,000 lekë** si rrjedhojë e përfshirjes së TVSH-së së pajisjeve në situacionin e punimeve për kontratën bazë, vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me UKM Nr. 2, datë 08.05.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I, me UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit dhe me VKM Nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8.

Titulli i Gjetjes 1:	Dëm ekonomik duke i konsideruar punime ndërtimi, punimet e furnizimit dhe instalimit të pajisjeve dhe si rrjedhojë e përfshirjes së TVSH-së së pajisjeve në situacionin e punimeve për kontratën bazë.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit teknik të pagesës, situacionit preventivit dhe faturës tatimore..
Kriteri:	Kontrata, preventivi, situacioni dhe krahasimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi.
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik duke rritur vlerën e kontratës.
Shkaku:	Përfshirjes së TVSH-së së pajisjeve në situacionin e punimeve për kontratën bazë.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Të merren masa nga Bashkia Mat, që t’i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V. N. I.S” & “N” SHPK përfaqësuar nga Z. A. Ç. administrator i OE “V. N.” shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e shumës 480,000 lekë pa TVSH , të përfituar tepër si rrjedhojë e përfshirjes së TVSH-së së pajisjeve në situacionin e punimeve për kontratën me objekt “ Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku ”.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “**Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku**”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Z. N. R. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V. N. I.S” & “N” SHPK përfaqësuar nga Z. A. Ç. administrator i OE “V. N.” shpk u konstatua se zëri i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

punimeve “(3.620) Shtresë pllaka betoni C 16/20 t=6 cm, oborri” është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **350,496 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Titulli i Gjetjes 2:	Dëm ekonomik për diferenca në volume për punime të kryera
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt.
Kriteri:	Kontrata, preventivi, situacioni dhe krahasimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi.
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik duke rritur vlerën e kontratës.
Shkaku:	Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Të merren masa nga Bashkia Mat, që t'i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V. N. I.S” & “N” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit arkëtimin e shumës 350,496 lekë pa TVSH , të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “ Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku ”.

Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve si dhe realizimit të grafikut të punimeve.

- Kontrata e zbatimit me objekt “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku”, është lidhur me datë **22.09.2017** dhe nr. prot. 2340, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, përfaqësuar nga **Z. N. R.** dhe Bashkimit të Operatorëve “V. N. I.S & N” SHPK përfaqësuar nga **Z. A. Ç.** administrator i OE “V. N.” shpk dhe nga **Z. Xh. N** administrator i OE “N” shpk. Vlera e kontratës është 61,580,780 lekë pa TVSH. Sipas nenit 4 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 120 (treqind e njëzet) ditë kalendarikë nga data e dorëzimit të sheshit. Periudha e garancisë do të jetë 18 muaj kalendarik nga data e kolaudit të objektit.

Për kontratën me objekt “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku” janë bërë tre amendamente dhe konkretisht: (Amendamet nr. 1, me datë 06.02.2018 palët bien dakord të shtyjnë aftin e përfundimit të punimeve me 45 ditë deri me datë 22.03.2018; Amendamet nr. 2, me datë 29.03.2018 palët bien dakord të shtyjnë aftin e përfundimit të punimeve me 30 ditë deri me datë 21.04.2018 dhe Amendamet nr. 3, me datë 27.06.2018 palët bien dakord të shtyjnë aftin e përfundimit të punimeve me 72 ditë deri me datë 02.07.2018. Amendamentet e mësipërme janë nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Mat përfaqësuar nga **z. N. R.** dhe përfaqësuesi i BOE “V. N. I.S” SHPK).

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 2571, datë 16.10.2017, me OE “G & L” me licencë NR. MK 1015/10 me drejtues ligjor **Z. G. I.** Objekti i kësaj kontrate është drejtimi i punimeve të zbatimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin”. Vlera e kontratës është 725,000 lekë pa TVSH.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

- Për kryerjen e shërbimit të kolaudimit të punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 2786, datë 01.11.2018, me OE “G & L” me Nr. MK 2928/5 përfaqësuar nga z. G. S. Objekti i kësaj kontrate është kryerja e shërbimit të kolaudimit të punimeve të zbatimit të kontratës me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin”. Vlera e kontratës është 69,248 lekë pa TVSH.

Projekti është hartuar nga shoqëria “K” SHPK.

Lirimi i sheshit dhe akti i piketimit në objekt kanë filluar me datë 25.10.2017. Punimet e ndërtimit kanë filluar me datë 25.10.2017 sipas procesverbalit me datë 25.10.2017 dhe pas 3(tre) amendamenteve kanë përfunduar datë 02.07.2018.

Preventivi bazë, nga azhurnimi i kryer ka pësuar ndryshime në volume që zbriten në shumën 2,932,932 lekë dhe volume që shtohen në shumën 2,922,620 lekë dhe miratuar nga investitori sipërmarrësi i punimeve dhe nga mbikëqyrësi i punimeve.

Mbi kolaudimin e punimeve të objektit “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku” është mbajtur procesverbal me datë 08.11.2018 dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i BOE “V. N. I.S” SHPK, nga Mbikëqyrësi i punimeve OE “E.-G” SHPK, nga Kolaudatori “G-L” SHPK dhe nga Kryetari i Bashkisë Mat, z. N. R.

Mbi marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve për objektin “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku” është mbajtur procesverbal me datë 27.12.2018 dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i BOE “V. N. I.S” SHPK përfaqësuar nga z. A. Ç., nga Mbikëqyrësi i punimeve OE “E.-G” SHPK përfaqësuar nga z. G. I., si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga z. K. K.; z. A. M. dhe z. A. N. (sipas urdhrin nr. 408, datë 26.12.2018).

Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.

Punimet e kryera në objekt janë paraqitur në situacionet pjesore si vijon:

Situacioni pjesor nr. 1, me vlerë 17,632,008 lekë me TVSH.

Situacioni pjesor nr. 2, me vlerë 11,880,000 lekë me TVSH.

Situacioni pjesor nr. 3, me vlerë 24,743,136 lekë me TVSH, ose në masën 73% të punimeve të objektit. Situacioni pjesor nr. 4, me vlerë 15,431,872 lekë me TVSH, ose në masën 94% të punimeve të objektit. Situacioni përfundimtar, me vlerë 4,197,270 lekë me TVSH, ose në masën 100 % të punimeve të objektit. Sipas situacioneve punimet e objektit “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku” janë kryer në shumën 61,570,238 lekë pa TVSH ose 73,884,286 lekë me TVSH. Nga situacioni i mësipërm është mbajtur 5% (2,712,757 lekë me TVSH) e shumës për garancinë e punimeve për një periudhë 12 muaj.

Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera deri në periudhën e auditimit, rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera në vlerën prej **830,496** lekë pa TVSH, argumentuar si vijon:

Zëri i punimeve “Furnizim dhe instalim kaldajë për ngrohje me ujë me lëndë djegëse...”

Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjen teknike rezulton se “Furnizim dhe instalim kaldajë për ngrohje me ujë me lëndë djegëse peletkomplet me instrumentat matës dhe të kontrollit të parametrave të ujit të ngrohtë, Q niminale 250,000 kilokalori/orë, përfshirë montimin e të gjithë tubacioneve dhe pajisjeve deri në dalje nga



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

dhoma e djegjes” është llogaritur me TVSH, duke i konsideruar punime ndërtimi punimet e furnizimit dhe instalimit të pajisjeve.

Kjo lloj strukture e preventiv-ofertës dhe situacionit përfundimtar në këtë formë bie ndesh me legjislacionin në fuqi, konkretisht me:

i) UKM Nr. 2, datë 08.05.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa “A”, paragrafi i fundit, pasi të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat në përfshirjen e punimeve të ndërtimit, ku përcaktohet se: “Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat”;

ii) VKM Nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8, ku përcaktohet se: “Analizat teknike do të përgatiten në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Kreun I të udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 të Këshillit të Ministrave,”.

iii) UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit, ku përcaktohet se: “Preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha vëllimet e punimeve të projekteve të lartpërmendura, hartuar nga projektuesit në përputhje me pikën 3.1 (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi);

Ky format i miratuar nga Këshilli i Ministrave me udhëzimin e lartpërmendur parashikon emërtimin e zërave të punimeve, sasi, çmim, vlerë si dhe shuma e tyre, duke i shtuar TVSH-në, pastaj kësaj shume i shtohen vetëm pajisjet. Pra nuk ka më TVSH për pajisjet, pasi si rubrikë për efekt të llogaritjes së kostos janë zë më vete, duke u përfshirë mbrapa TVSH-së. Po me këtë udhëzim është miratuar edhe paraqitja e zërave të punimeve dhe pajisjeve në miratimin e strukturës së situacionit që paraqitet për likuidim.

- Për kontratën bazë, si pasojë e përfshirjes në situacion të TVSH-së janë likuiduar tepër në vlerën **480,000 lekë** [2,400,000 x 20 % TVSH-ja].

Si përfundim, janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve në vlerën **480,000 lekë** si rrjedhojë e përfshirjes së TVSH-së së pajisjeve në situacionin e punimeve për kontratën bazë, vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.

Punime sistemimi të jashtëm

Zëri (3.620) Shtresë pllaka betoni C 16/20 t=6 cm, oborri.

Nga kontrolli i punimeve në objekt mbi realizimin e zërit 3.620 “Trotuar 6 cm beton me pllaka” rezultoi se paketa e oborrit është realizuar me këtë paketë: (Pllaka betoni; Shtresë rëre nën pllaka 4 cm; Shtresë stabilizanti 15 cm dhe Shtresë çakull gurore 20 cm).

Ndërkohë po t’i referohemi VKM Nr. 629, date 15.07.201 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” mbi analizën për zërin konkret me nr. Analize 3.620 është parashikuar që brenda çmimit 1305 lekë të realizohej edhe shtresa e betonit me përbërsit e parashikuar në analyze. Mos realizimi i shtresës së betonit, ndërkohë që në preventiv janë parashikuar shtresë rëre, çimento dhe shtresë zhavorri, krijon një diferencë prej 240 lekë për m² të përfituar në mënyrë të padrejtë nga sipërmarrësi “V. N.” SHPK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV
“BashkiaMat”

Sa më sipër diferenca në volumin prej 1460.40 m² pllaka trotuari është librezuar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi “V. N.” SHPK, në vlerën **350,496 lekë me TVSH**[1460.40 m² x 240 lekë].

Si përfundimngauauditimirezulton se:

Në mënyrë të përmbledhur për objektin “**Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku**” rezultoi se sipërmarrësit të punimeve janë likuiduar tepër për punime të pakryera në vlerën **830,496 lekë pa TVSH, vlerë që përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve “V. N. I.S” SHPK.

Për sa më sipër trajtuar ngarkohen me përgjegjësi:

- Nga ana e zbatuesit të punimeve, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: **Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8; në Kontratën e zbatimit të punimeve me objekt “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, dhe BOE “V. N. I.S & N” SHPK; në Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I.**

- Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE “E.-G” SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: **Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7; Kontratën për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku” të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Mat dhe shoqërisë “E.-G” SHPK dhe në UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.**

II. Zbatimi i kontratës me objekt: “Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës Derjan”, ku rezultoi:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “**Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës Derjan**”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Z. N. R. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V. N. I.S & N” SHPK përfaqësuar nga Z. A. Ç. administrator i OE “V. N.” shpk u konstatua se zërat e punimeve: “**7(2.278) Shtresë zhavorri nën kanal t = 10 cm**” dhe “**Punime në kalimin këmbësorësh Hd = 2 m B = 2 m**” janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **315,525 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Titulli i Gjetjes 2:	Dëm ekonomik për diferenca në volume për punime të kryera
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt.
Kriteri:	Kontrata, preventivi, situacioni dhe krahasimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi.
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik duke rritur vlerën e kontratës.
Shkaku:	Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara.
Rëndësia:	I lartë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

Rekomandime:

Të merren masa nga Bashkia Mat, që t'i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V.N. I.S” & “N” SHPK, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **315,525 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt **“Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës Derjan”**.

Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve si dhe realizimit të grafikut të punimeve.

- Kontrata e zbatimit me objekt “Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës Derjan”, është lidhur me datë 29.09.2017 dhe nr. prot. 139, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Z. N. R. dhe Bashkimit të Operatorëve “V.N. I.S & N” SHPK përfaqësuar nga Z. A. Ç. administrator i OE “V.N.” shpk dhe nga Z. Xh, N administrator i OE “N” shpk me vlerë 16,458,763 lekë pa TVSH. Sipas nenit 4 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 50 (pesëdhjetë) ditë kalendarikë nga data e dorëzimit të sheshit. Periudha e garancisë do të jetë 12 muaj pas datës së kolaudit të objektit.

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës, Fshati Derjan” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 2571, datë 16.10.2017, me OE “D.-E” përfaqësuar nga z. B. D. me NR. MK 1713/5. Objekti i kësaj kontrate është drejtimi i punimeve të zbatimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin”. Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 89,000 lekë pa TVSH.

- Për kryerjen e shërbimit të kolaudit të punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës Derjan” është ngarkuar personi fizik z. Z. M. me Liçencë me Nr. MK. 1151/1. Projekti është hartuar nga shoqëria “I.” SHPK dhe është miratuar nga titullari i bashkisë Mat z. N. R.

Lirimi i sheshit dhe akti i piketimit në objekt kanë filluar me datë 04.09.2017. Punimet e ndërtimit kanë filluar me datë 04.09.2017 sipas procesverbalit me datë 04.09.2017 dhe kanë përfunduar datë 23.10.2017.

Preventivi bazë, nga azhurnimi i kryer ka pësuar ndryshime në volume që zbriten në shumën 2,566,003 lekë dhe volume që shtohen në shumën 2,566,003 lekë dhe miratuar nga investitori sipërmarrësi i punimeve dhe nga mbikëqyrësi i punimeve.

Mbi kolaudit të punimeve të objektit “Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës, fshati Derjan” është mbajtur procesverbal me datë 05.12.2017 dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i OE “V.N.I.S” SHPK, nga Mbikëqyrësi i punimeve OE “D.-E” SHPK, nga Kolaudatori personi fizik “Ing. Z. M.” dhe nga Kryetari i Bashkisë Mat, z. N. R.

Mbi marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve për objektin “Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës, Fshati Derjan” është mbajtur procesverbal me datë 14.12.2017 dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i OE “V.N. I.S” SHPK përfaqësuar nga z. A. Ç., nga Mbikëqyrësi i punimeve OE “D.-E” SHPK përfaqësuar nga z. B. D., si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga z. A. Q.; z. B. K. dhe z. A. N. (sipas urdhrorit nr. 620, datë 12.12.2017).

Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.

Punimet e kryera në objekt janë paraqitur në situacionet pjesore si vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

Situacioni pjesor nr. 1, me vlerë 8,338,320 lekë me TVSH. Realizimi i punimeve të ndërtimit në masën 42 %. Situacioni pjesor nr. 2, me vlerë 7,202,826 lekë me TVSH. Realizimi i punimeve të ndërtimit në masën 79 %. Situacioni përfundimtar, me vlerë 4,209,369 lekë me TVSH. (Fatura Tatimore Nr. 40, 01.12.2017) ose në masën 100 % të punimeve të objektit.

Nga situacioni i mësipërm është mbajtur 5% e shumës për garancinë e punimeve për një x

Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera deri në periudhën e auditimit, rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera në vlerën prej **315,525** lekë pa TVSH, argumentuar si më poshtë vijon:

Zëri 7(2.278) Shtresë zhavorri nën kanal t = 10 cm.

Preventivi i ripunuar pasqyron sasinë 417.6 m³ shtresë zhavorri me çmim 1700 lekë.

Situacioni pasqyron sasinë 417.6 m³ shtresë zhavorri me çmim 1700 lekë. Libri i masave pasqyron në mënyrë analitike, sasinë 417.6 m³ shtresë zhavorrime.

Nga auditimi në objekt mbi realizimin e këtij zëri, rezultoi se është realizuar vetëm bazën e vogël të kanalit me seksion trapezoidal, ndërsa në skarpatat e kanalit nuk është vendosur. Nga llogaritja e bërë, rezulton se zëri i shtresës së zhavorrit është realizuar në volumin 240 m³ dhe jo në volumin 417.6 m³.

Për pasojë, diferenca e volumit prej 177.6 m³, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve në shumën **301,920 lekë pa TVSH** (177.6 m³ x 1700 lekë) .

Punime në kalimin këmbësorësh Hd = 2 m B = 2 m.

Nga auditimi në objekt mbi realizimin e këtij zëri, rezultoi se koston për kalim këmbësorësh është përfshirë vetëm vlera 5600 lekë për nënzërin |Soletë betoni arme C 16/20 e parapregatitur“ dhe nuk rezulton të jenë kryer zërat: (Germim dheu për uren me vlerë 85 lekë; F.V Fe betoni d < 10 mm me vlerë 1150 lekë; F.V Fe betoni d > 10 mm me vlerë 3300 lekë).

Nga llogaritja e bërë, rezulton se kostoja për 1(një) kalim këmbësorësh është realizuar në shumën 5600 lekë dhe jo në shumën 10,135 lekë.

Për pasojë, diferenca prej 4535 lekë për një kalim këmbësorësh, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve në shumën **13,605 lekë pa TVSH** (3 copë x 4535 lekë) .

Problematika të konstatuara nga auditimi në objekt:

- Nga mos bërja e fugave terthore dhe gjatësore (difekt i PZ), ishin plasaritur dhe dëmtuar rreth 32 m³ beton C 16/20 që i përkasin punimeve në kanalet e betonit me vlerë 336,000 lekë pa TVSH (32 m³ x 10500 lekë). Ky volum betoni u zëvendësua nga zbatuesi i punimeve shoqëria “V.N. I.S” SHPK deri në përfundim të auditimit nga KLSH.
- Zëri i punimeve “Hidroizolim me dy duar bitum” që i përket punimeve në kanal kalimet me tub çeliku dhe sifonin e ri, me vlerë 102,500 lekë pa TVSH (410 m² x 250 lekë), nuk ishte kryer. Punimet e këtij zëri punimesh u kryen deri në përfundim të auditimit nga KLSH.

Si përfundim në mënyrë të përmbledhur për objektin “Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës, fshati Derjan” rezulton se:

Sipërmarrësit të punimeve, BOE “V.N. I.S” & “N” SHPKi janë likuiduar tepër për punime të pakryera në vlerën **315,525 lekë pa TVSH, vlerë që përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

shtetit dhe njësisë vendore, dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve “V.N. I.S” SHPK.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: *Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8; Kontratën e zbatimit të punimeve me objekt “Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës Derjan”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Mat, dhe Operatorit Ekonomik “V.N. I.S & N” SHPK, Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3.*
- Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE “D.-E” SHPK, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: *Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7; Kontratën për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Mat dhe shoqërisë “D.-E” SHPK; UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*

III. Zbatimi i kontratës me objekt: “Rikonstruksion “Lagjia Drita”, ku rezultoi:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rikonstruksion “Lagjia Drita”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Z. N. R. dhe Operatorit Ekonomik “E.” SHPK përfaqësuar nga Z. R. D., u konstatua se zërat e punimeve: **“Beton C 16/20 për fiksion bordure”, “Bordurë betoni C 16/20 20x35 cm”** janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **211,960 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Titulli i Gjetjes 2:	Dëm ekonomik për diferenca në volume për punime të kryera
Situata:	Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt.
Kriteri:	Kontrata, preventivi, situacioni dhe krahasimi me faktin kundrejt së cilës krahasohet situata e cila paraqet këtë parregullsi.
Ndikimi/Efekti:	Dëm ekonomik duke rritur vlerën e kontratës.
Shkaku:	Mos kryerje punimesh në volumet e përcaktuara.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandime:	Të merren masa nga Bashkia Mat, që t’i kërkojë Operatorit Ekonomik “E.” SHPK përfaqësuar nga Z. R. D., duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit arkëtimin e shumës 211,960 lekë pa TVSH , të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion “Lagjia Drita”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve si dhe realizimit të grafikut të punimeve.

- Kontrata e zbatimit me objekt “Rikonstruksion Lagjia Drita”, është lidhur me datë 14.11.2017 dhe nr. prot. 2883, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Z. N. R. dhe Operatorit Ekonomik “E” SHPK përfaqësuar nga Z. R. D.. Vlera e kontratës është 11,904,319 lekë pa TVSH. Sipas nenit 4 (Afati i kontratës) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 40 (dyzet) ditë kalendarikë nga data e dorëzimit të sheshit. Periudha e garancisë do të jetë 12 muaj kalendarik nga data e kolaudimit të objektit.

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksion “Lagjia Drita” është lidhur kontrata ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Z. N. R. dhe OE “E.-G” me licencë NR. MK 1015/10 me drejtues ligjor Z. G. I.

- Për kryerjen e shërbimit të kolaudimit të punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksion “Lagjia Drita”” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 1534, datë 14.06.2018, me OE “XH & M.” me Nr. MK 1322/6 përfaqësuar nga Zj. Xh. D. Objekti i kësaj kontrate është kryerja e shërbimit të kolaudimit të punimeve të zbatimit të kontratës me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin, Rikonstruksion “Lagjia Drita”. Vlera e kontratës është 27,000 lekë pa TVSH.

Projekti është hartuar nga shoqëria “K.” SHPK. Projekti është i pa nënshkruar dhe vulosur nga projektuesi si dhe nga autoriteti kontraktor.

Lirimi i sheshit dhe akti i piketimit në objekt kanë filluar me datë 22.11.2017. Punimet e ndërtimit kanë përfunduar me datë 31.01.2018 sipas procesverbalit nënshkruar nga AK, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi.

Mbikëqyrësi i punimeve me datë 26.12.2017 ka paraqitur në Bashkinë Mat kërkesën për shtyrje afati të përfundimit të punimeve, për arsye të motit shumë të keq, me 30 ditë, deri me datë 30.01.2018.

Preventivi bazë, nga azhurnimi i kryer ka pësuar ndryshime në volume që zbriten në shumën 2,323,163 lekë me TVSH dhe volume që shtohen në shumën 2,321,994 lekë me TVSH dhe këto ndryshime janë miratuar nga investitori Bashkia Mat, nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria “E.” SHPK si dhe nga mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “E.-D” SHPK. Preventivi i ripunuar paraqitet në shumën 14,284,014 lekë me TVSH.

Për kolaudimin e punimeve të objektit “Rikonstruksion Lagjia Drita”” është mbajtur procesverbal me datë 20.06.2018 dhe është nënshkruar nga OE “E.” SHPK, nga Mbikëqyrësi i punimeve OE “E.-G” SHPK, nga Kolaudatori “XH & M.” SHPK dhe nga Kryetari i Bashkisë Mat, z. N. R.

Mbi marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve për objektin “Rikonstruksion Lagjia Drita” është mbajtur procesverbal me datë 21.06.2018 dhe është nënshkruar nga OE “E.” SHPK përfaqësuar nga z. R. D., nga Mbikëqyrësi i punimeve OE “E.-G” SHPK përfaqësuar nga z. G. I., si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga z. E. Ll.; z. A. M. dhe z. A. N. (sipas urdhrin nr. 194, datë 21.06.2018).

Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.

Punimet e kryera në objekt janë paraqitur në situacionet pjesore si vijon: Situacioni pjesor nr. 1, me vlerë 4,212,000 lekë me TVSH. Situacioni përfundimtar, me vlerë 14,284,014 lekë me



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

TVSH, ose në masën 100 % të punimeve të objektit. Nga situacioni i mësipërm është mbajtur 5% (714,201 lekë me TVSH) e shumës për garancinë e punimeve për një periudhë 12 muaj.

Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera, rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera në vlerën prej **211,960** lekë pa TVSH, argumentuar si më poshtë vijon:

1. Punime në trotuarë

Zëri 9 Beton C 16/20 për fiksion bordure.

Preventivi i ripunuar pasqyron volumin 60 m^3 beton C 16/20 me çmim 9500 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 60 m^3 beton C 16/20 me çmim 9500 lekë. Libreza e masave pasqyron volumin 60 m^3 beton C 16/20, detajuar në mënyrë analitike dhe konkretisht:

- Beton për fiksion bordure $632 \text{ ml} * 0.058 = 36.66 \text{ m}^3$.
- Kuneta majtas $240 * 0.5 * 0.1 = 12 \text{ m}^3$.
- Kuneta djathtas $240 * 0.5 * 0.1 = 12 \text{ m}^3$.

Nga verifikimi i objektit si dhe i fotografive konstatohet se:

- Beton për fiksion bordure $632 \text{ ml} * 0.038 = 24 \text{ m}^3$.
- Kuneta majtas $240 * 0.5 * 0.1 = 12 \text{ m}^3$.
- Kuneta djathtas $240 * 0.5 * 0.1 = 12 \text{ m}^3$.

Pra në total është realizuar beton C 16/20 në volumin 48 m^3 ($24 + 12 + 12$) dhe jo 60 m^3 .

Sa më sipër nga sipërmarrësi i punimeve Operatori Ekonomik “E.” SHPK janë situacionuar më tepër 17.68 m^3 beton, duke përfituar më tepër në mënyrë të padrejtë shumën prej **114,000 lekë pa TVSH** ($12 \text{ m}^3 \times 9500$ lekë).

2. Zëri Bordurë betoni C 16/20 20x35 cm.

Preventivi i ripunuar pasqyron sasinë 632 ml (480 ml preventivi bazë + 152 ml shtohen në preventivin e ripunuar) me çmim 1800 lekë. Situacioni përfundimtar, pasqyron sasinë 632 ml me çmim 1800 lekë. Libreza e masave, pasqyron pasqyron sasinë 632 ml bordura betoni të zbrërthyer në mënyrë analitike si vijon: (Bordura majtas 392 ml; Bordura 240 ml)

Në fakt nga auditimi i realizimit të këtij zëri punimesh në objekt rezultoi se, bordurat e betonit janë $20 \times 25 \text{ cm}$ dhe jo $20 \times 35 \text{ cm}$, pra vendosja e tyre është bërë në kundërshtim me specifikimet teknike dhe kërkesat teknike të projektit të zbatimit.

Referuar analizës së çmimeve nr. 3.618 për zërin “Bordura betoni parafabrikat, C 16/20 $20 \times 35 \text{ cm}$ ” çmimi total i këtij zëri është 1515 lekë, kurse zëri “material” i bordurës $20 \times 35 \text{ cm}$ është 900 lekë. Pra bordura përbën 60 % ($900/1515 \times 100$) të çmimit total të zërit.

- Referuar çmimit të zërit “F.V Bordura betoni parafabrikat, $20 \times 35 \text{ cm}$ ” në ofertën ekonomike dhe situacionin përfundimtar, çmimi total i këtij zëri është 1,800 lekë, kurse çmimi i vetë bordurës $20 \times 35 \text{ cm}$, duke konsideruar peshën e bordurës sipas analizës së manualit (në masën 60%) është 1080 lekë ($60\% \times 1800$ lekë).

Nisur nga fakti që sipërmarrësi ka përdorur bordura $20 \times 30 \text{ cm}$, çmimi real i bordurës së përdorur duhet të ishte 925 lekë ($1080 / 35 \text{ cm} \times 30 \text{ cm}$) dhe diferenca e çmimit e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi është 155 lekë ($1080 - 925$).

Sa më sipër realizimi i zërit “F.V Bordura betoni C 16/20, $20 \times 30 \text{ cm}$ ”, sipas përllogaritjes me interpolim linear është libëruar dhe situacionuar më tepër dhe është përfituar në mënyrë ta



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

parregullt nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria “E.” SHPK., në vlerën **97,960 lekë pa TVSH** [155 lekë x 632 ml bordurë].

Problematika të konstatuara nga auditimi:

- Për kryerjen e shërbimit të kolaudimit të punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksion Lagjia Drita” është lidhur kontrata e shërbimit me OE “XH & M.” dhe kolaudimi është bërë me datë 20.06.2018, pra konstatohet se grupi i kolaudimit është ngritur rreth 4 (katër) muaj me vonese (punimet kanë përfunduar datë 31.01.2018), në kundërshtim me *nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* ku përcaktohet se: “...Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t’ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rretheve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit...” Ky veprim dhe mosveprim ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK.
- Sipërmarrësi i punimeve shoqëria “E.” SHPK dhe mbikëqyrësi i punimeve nuk kanë paraqitur projektin e azhurnuar.
- Për materialet e ndërtimit të përdorura në vepër, nuk janë paraqitur certifikatë cilësie/raporte testimi të kryera në laboratorë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), në zbatim në nenin 14, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Si përfundim në mënyrë të përmbledhur për objektin “Rikonstruksion Lagjia Drita” rezulton se:

- Sipërmarrësit të punimeve “E.” SHPK, i janë likuiduar tepër për punime të pakryera në vlerën **211,960 lekë pa TVSH, vlerë që përbën dëm ekonomik** ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve OE “E.” SHPK.

Për sa më sipër trajtuar ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

- Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: *Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8; Kontratën e zbatimit të punimeve ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë së Mat, dhe Operatorit “E.” SHPK; Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3.*
- Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE “E.-G” SHPK, me licencë “Për mbikëqyrje dhe kolaudin punimesh” me MK. 1015/10, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në: *Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7; Kontratën për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të kontratës me objekt “Rikonstruksion Lagjia Drita” të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Mat dhe shoqërisë “E.-G” SHPK dhe UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2.*

IV. Zbatimi i kontratës me objekt: “Rehabilitim i fasadave dhe sheshit të Qytetit Ulëz (faza e përmbyllëse”, ku rezultoi:

Mbi kontratën e zbatimit të punimeve, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve si dhe realizimit të grafikut të punimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

- Kontrata e zbatimit me objekt “Rehabilitim i fasadave dhe sheshit të Qytetit Ulëz (faza e përmbyllëse”, është lidhur me datë 20.09.2016 dhe nr. prot. 2448, ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Z. N. R. dhe Operatorit Ekonomik “U. N.” SHPK me licencë me NZ.1718/13, përfaqësuar nga Z. N. Sh. Vlera e kontratës është 24,819,181 lekë pa TVSH. Sipas nenit 4 (Afati i kontratës, KVK) të kontratës, afati i realizimit të punimeve do të jetë 6 (gjashtë) muaj nga data e fillimit të punimeve. Periudha e garancisë do të jetë 12 muaj pas datës së kolaudimit të objektit.

- Për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes të punimeve të kontratës me objekt “Rehabilitim i fasadave dhe sheshit të Qytetit Ulëz (faza e përmbyllëse” është lidhur kontrata e shërbimit me nr. prot. 2318, datë 07.09.2016, me OE “D.-E” me NR. MK 1713/5, përfaqësuar z. B. D. Objekti i kësaj kontrate është drejtimi i punimeve të zbatimit me objekt “Mbikëqyrja e punimeve për objektin ”.

- Për kryerjen e shërbimit të kolaudimit të punimeve të kontratës me objekt “Rehabilitim i fasadave dhe sheshit të Qytetit Ulëz (faza e përmbyllëse” është ngarkuar OE “H. C.” SHPK përfaqësuar nga z. H. H. me Liçencë me Nr. MK. 2720/1.

Projekti është hartuar nga personi fizik “B. M.” em licencë MK. 1127 dhe është miratuar nga titullari i bashkisë Mat z. N. R.

Lirimi i sheshit dhe akti i piketimit në objekt kanë filluar me datë 21.09.2016. Punimet e ndërtimit kanë filluar me datë 21.09.2016 dhe sipas procesverbalit kanë përfunduar datë 07.02.2017.

Mbi kolaudimin e punimeve të objektit “Rehabilitim i fasadave dhe sheshit të Qytetit Ulëz (faza e përmbyllëse” është mbajtur procesverbal me datë 27.04.2017 dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i OE “U.N.” SHPK, nga Mbikëqyrësi i punimeve OE “D.-E” SHPK, nga Kolaudatori “H. C.” SHPK dhe nga Kryetari i Bashkisë Mat, z. N. R.

Mbi marrjen në dorëzim të përkohshëm të punimeve për objektin “Rehabilitim i fasadave dhe sheshit të Qytetit Ulëz (faza e përmbyllëse” është mbajtur procesverbal me datë 07.06.2017 dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i OE “U.N.” SHPK përfaqësuar nga Z. N. Sh., nga Mbikëqyrësi i punimeve OE “D.-E” SHPK përfaqësuar nga z. B. D., si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga z. E. Ll.; z. A. Gj. dhe z. E. Ç.

Likuidimi i situacioneve për punimet e kryera, rezulton.

Punimet e kryera në objekt janë paraqitur në situacionet pjesore si vijon:

Situacioni pjesor nr. 1, me vlerë 14,991,640 lekë me TVSH. Situacioni përmbledhës, me vlerë 29,782,792 lekë me TVSH. Nga situacioni i mësipërm është mbajtur 5% e shumës për garancinë e punimeve për një periudhë 12 muaj.

Mbi auditimin e realizimit të punimeve në terren.

Nga auditimi në terren për verifikimin e zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të administruara në dosjen teknike të zbatimit të vënë në dispozicion grupit të auditimit për punimet e kryera, nuk rezultojnë diferenca në volume për punime të kryera.

Punimet e ndërtimit sipas zërave të preventivit janë të njëjta me ato të specifikuara në kushtet e kontratës të miratuara nga projektuesi, mbikëqyrësi si dhe Autoriteti Kontraktor Bashkia Mat.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

Konstatohet se projekti është konformë dokumentacionit të hartuar dhe përputhet me planimetrinë e përgjithshme, me lejen e ndërtimit dhe vendndodhjen e objektit.

IV GJETJET DHE REKOMANDIMET

Në përfundim të trajtimit të çështjeve sa në sipër për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi; Në aktivi i pasqyrave financiare Llog.(202) “*Studime e projekte*” me vlerë kontabile prej 32,577,436 lekë e analizuar për 35 projekte ndërtimore dhe 3 studime të financuara në vite, të mbartuara nga (ish/Komunat) të administruara në njësi publike bashkia Mat u konstatua se, administrimi projekteve e studimeve të investuara nuk janë të dokumentuara nëpërmjet procesit të inventarizimit fizik të tyre, në mospërputhje me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar, neni 7, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kap (III), pikat 26, 35/b, 35/c dhe Kap (IV), pika 73 dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”, Kap (II), pika 1.

Në aktivi i pasqyrave financiare llog.(209) “*Amortizimi aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*” me vlerë akumuluar kontabile (-5,875,991 lekë) me rritje (-3,257,743 lekë) dhe llog.(219) “*Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*” me vlerë akumuluar kontabile (-614,577,386 lekë) me rritje (-92,489,153 lekë). Nga të dhënat kontabile në aktiv të pasqyrës financiare rezulton se; amortizimi vjetor i përlllogaritur aktive (të trupëzuara dhe patrupëzuara) është rritur me -95,746,896 lekë (-3,257,743); (-92,489,153), ndërsa në PSH (Formati nr.3/1) Klasa (68).III-“*Kuota e amortizimit dhe shuma të parashikuara*” kjo llogari pasqyrohet me gjendje vlere 0 (Zero), në këto kushte shumat e amortizimit vjetor e përlllogaritur nuk janë të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

kontabilizuara dhe nuk janë të evidentuara në PSH (*Formati nr.3/1*), ndërsa në se kontabilizimi i shpenzimeve të amortizimit do të bëhej në mënyre korrekte edhe rezultati nga funksionimi duhet të jetë me diferencë ndërmjet kësaj shumës së rezultatit dhe vlerës së përlllogaritur të kuotës së amortizimit për periudhën raportuese (-95,746,896 lekë) me diferencën prej -8,159,591 lekë (+87587305 -95746896). Njësia publike bashkia Mat në pasqyrat financiare ka përlllogaritur, rregjistruar, kontabilizuar norma për amortizimin e aktiveve të evidentuara në (*Formati nr.7*), ndërsa nuk ka testuar në se normat e amortizimi janë të sakta, njëkohësisht nuk janë evidentuar humbjet e rezultuara nga zhvlerësimi aktiveve, në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015; neni 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “*Për kontabilitetin e pasqyrat financiare*” i ndryshuar; UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kap (II), pika 1 dhe Kap (III) (*trajtuar më hollësisht në faqet 33-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Njësia publike bashkia Mat, Sektori i Finacës dhe Kontabilitetit të marrë masa me qëllim që të verifikohet saktësia e llog.(202) “*Studime e projekteve*” dhe të administrohet nëpërmjet procesit të inventarizimit fizik gjendja dhe vlera e projekteve e studimeve të financuara në vite.

Njësia publike bashkia Mat, Sektori i Finacës dhe Kontabilitetit të marrë masa me qëllim që të verifikohet saktësia e llog.(209) “*Amortizimi aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara*” dhe llog.(219) “*Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara*” dhe të administrohet nëpërmjet procesit të përlllogaritjes së saktë të testimit e normës së amortizimi, si dhe duke evidentuar humbjet e rezultuara nga zhvlerësimi i aktiveve në vite.

Brenda viti 2019.

2. Gjetje nga auditimi; Në aktiv të pasqyrave financiare llog.(211) “*Pyje, kullota, plantacione*”, me vlerën kontabile 12,303,824 lekë me gjendje të pa ndryshuar, përfaqëson vlerën e ekonomive (*pyllëzime arvore, pyje e kullota, sisteme gjelbërimi*) të transferuara në pronësi të bashkisë nga (*ish/Komuna*) në kuadër të reformës administrative, ndërsa për këto ekonomi zyra e finacës nuk disponon dokumente kontabël, regjistra e kartela llogarie me dokumente justifikues me të dhëna mbi përmbajtjen e cdo ekonomie. Në këto kushte evidentimi dhe administrimi në aktiv të pasqyrave financiare pa dokumente të nevojshëm justifikues, në mospërputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*” dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”, Kreu (V); (VI) pika 2, Kreu (VII) pika 1; 2 dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar, neni 7, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kap (III), pikat 26, 35/b, 35/c dhe Kap (IV), pika 73 dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*” Kap (II), pika 1.

Në aktiv të pasqyrave financiare llog.(212) “*Ndërtime konstruksione*” me vlerë kontabël 975,556,334 lekë, përfaqëson vlerën e objekteve ndërtimore që administrohen nga Bashkia Mat të transferuara nga (*ish/Komunat*), të cilat për periudhën raportuese vitit 2017 janë shtuar me vlerën 57,593,376 lekë, ndërsa për këto objekte zyra e finacës nuk disponon regjistra, kartela llogarie e dokumentat kontabile me të dhëna të domosdoshme mbi objektet me qëllim të evidentohen të dhënat e nevojshme si; (*viti krijimit të asetit, amortizimi në vite, planimetria dhe projekti objektit ndërtimor, etj*). Këto asete nuk janë të regjistruara në ZRPP Burrel në pronësi të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

Bashkisë Mat, ndërsa për periudhën raportuese nuk është kryer inventarizimi fizik dhe në këto kushte pasqyrimi në aktiv të bilancit pa të dhëna kontabile dhe dokumenta justifikuese, në mospërputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, neni 7, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kap (II), pika 1, Kap (III), pikat 26, 35/b, 35/c dhe Kap (IV), pika 73 dhe VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap (II), pika 1 (trajtuar më hollësisht në faqet 33-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Njësia publike Bashkia Mat, Sektori i Finacës dhe Kontabilitetit të marrë masa me qëllim të saktësohet llog.(211) me qëllim justifikimin e veprimeve kontabël me dokumenta të nevojshme justifikuese tekniko-ligjore për pasqyrimin me dokumenta ligjor. Njësia publike Bashkia Mat, Sektori i Finacës dhe Kontabilitetit të marrë masa për saktësimin e llog.(212) “Ndërtime konstruksione” me qëllim përcaktimin e statusit juridik të tyre dhe përgatitjen e dokumentacionit tekniko ligjor të nevojshme për regjistrimin në pronësi të saj si aktiveve të qëndrueshme të kontabilizuar.

Brenda vitit 2019.

3. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e aktivitetit të pasqyrave financiare llog.(401-408) “Furnitor e llogari të lidhura me to” e cila përfaqëson detyrime të pa likuiduara në kohë për furnizime, shërbime e punime, detyrime të cilat duhet të likujdohen për efekt dhe brenda periudhës raportuese buxhetore 2018 për 56 subjekte kreditore në vlerën **13,581,247 lekë**, si dhe llog.(467) “Kreditor të ndryshëm” e cila përfaqëson detyrime të lindura për 9 subjekte të cilët kanë fituar vendimet e gjykatave në vite me formë të prerë deri në datë 31.12.2018 vlera **48,587,939 lekë**, në mospërputhje me UMF (plotësues) nr.02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe UMF (plotësues) nr.01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106 deri 110 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” dhe pika 116 deri 117 “Raportimi detyrimeve të prapambetura në njësitet e qeverisjes vendore” (trajtuar më hollësisht në faqet 33-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Njësia publike Bashkia Mat, Sektori i Finacës dhe Kontabilitetit bazuar për këto detyrime të pa likuiduara, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkisë një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **48,587,939 lekë** e rakorduar kjo shumë me pasqyrën e dërguar në Ministrinë e Financave me shkresën përkatëse.

Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak.

4. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi mbi administrimin e aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese të njësive publike bashkia Mat u konstatuan shkelje e mangësi të procedurave në realizimin e procesit të inventarizimit fizik i kryer në fund të periudhës raportuese 2017:

-Në përfundim të procesit të inventarizimit, komisionet e ngritur me urdhër të titullarit nuk kanë përgatitur raport informues lidhur me rezultatet e inventarizimit dhe sistemimin e diferencave për nëpunësin autorizues, në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kap. IV, pika 85.

Në përfundim të procesit të inventarizimit, bazuar në rezultatet e pasqyruara në fletë inventarët, megjithëse komisionet nuk kanë evidentuar diferencë, ndërsa nga krahasimi me vlerat e aktiveve në pasqyrat financiare rezultojnë diferencë, të cilat nuk rezultojnë të sistemuara dhe nuk është hartuar listë e inventarëve të vlerësuar, në mospërputhje me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kap (IV), pika 102 (trajtuar më hollësisht në faqet 33-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

4.1 Rekomandimi: Njësia publike Bashkia Mat, të analizojë të gjitha shkeljet dhe mangësitë e konstatuara të trajtuara më sipër duke nxirrjerr përgjegjësitë për mos zbatimin e procedurave ligjore për inventarizimin fizik të aktiveve, pasurisë, asetëve e vlerave materiale. Njëkohësisht të analizohen shkeljet e mangësitë e konstatuara për diferencat në mungesë, apo më tepër duke marr masat e nevojshme me qëllim që rezultatet e inventarëve të vlerësohen, sistemohen dhe të evidentohen shkaqet, duke nxirrjerrë përgjegjësitë përkatëse.

Brenda vitit 2019.

5. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Mat, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregojnë se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen deri në një farë mase. Nuk ka konsolidim të tërësisë së rregullave, procedurave për çdo aktivitet të veprimtarisë, pavarësisht se këtë e realizon referuar kompetencave dhe akteve nënligjore në fuqi, duke reflektuar kështu nivel mesatar të riskut të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Është hartuar Rregullorja e funksionimit të Njesisë, pjesë e së cilës është edhe kodi i etikës. Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nga ku rezultoi se:

-Në lidhje me mjedisin e kontrollit. Nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh.

-Në lidhje me menaxhimin e riskut: Nuk ka të miratuar një strategji të risqeve e përcaktim të kordinatorit të riskut sipas nenit 21.

- Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

-Në lidhje me informacionin dhe komunikimin: Në Rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprime me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë (trajtuar më hollësisht në faqet 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, nëpërmjet Njësimit Autorizues dhe strukturës së Auditit të Brendshëm, të marren masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi i institucionit i MFK-së dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve e përcaktim të kordinatorit të riskut me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Nga ana e titullarit të njësisë vendore të miratohen aktet e nevojshme për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe të monitorohet funksionimi i GMS në vazhdimësi.

Në vijimësi.

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Mat, ka dërguar në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësorin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, pa informacionin e Drejtorive vartëse, ndërsa sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, në kundërshtim me pikën 15, germa b, të UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike” (trajtuar më hollësisht në faqet 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

6.1. Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, të dërgoj në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësorin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe informacionin e Drejtorive vartëse.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës, sistemin kompjuterik nuk e ka të certifikuar nga kompani e licencuara për ruajtjen e të dhënave, pasi sistemi kompjuterik nuk mbron asetet dhe nuk ruan integritetin e të dhënave. Mos certifikimi i sistemit kompjuterik për mbrojtjen e të dhënave dhe të integritetit të tyre, vjen në papajtueshmëri me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik” (trajtuar më hollësisht në faqet 26-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa, të certifikoj sistemin kompjuterik nga kompani të licencuara për ruajtjen e të dhënave, të mbroj sistemin kompjuterik dhe asetet duke ruajtur integritetin e të dhënave, financiar dhe çdo informacion origjinal, plotësues dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike.

Brenda vitit 2019

8. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Mat, nuk ka hapur regjistra për abonentët familjarë, mungojnë njoftim detyrimi për taksat dhe tarifave vendore, për evidentimin e numrit të familjeve që duhet të paguajnë, veprim në papajtueshmëri me pikën 7 neni 3, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar (trajtuar më hollësisht në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Mat të marrë masa, për krijimin e regjistrit elektronik me të dhëna, për hapjen e kartelave individuale të abonentëve familjarë, hartimin e regjistrit themelorë të abonentët familjarë për taksat e tarifave vendore, duke evidentuar detyrimet për çdo taksë.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Mat në fund të vitit 2018 janë debitorë për taksa dhe tarifa vendore për 51 subjekte (biznes i Madh) në vlerën 11,355,573 lekë dhe 287 subjekte (biznes i Vogël) në vlerën 12,319,845 lekë. Drejtoria e Tatim Taksave për arkëtimin e debitorëve nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenet 90, 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve (trajtuar më hollësisht në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Mat të marrë masat, për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 51 subjekte (biznes i Madh) në vlerën 11,355,573 lekë dhe 287 subjekte (biznes i Vogël) në vlerën 12,319,845 lekë bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a - Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b - Të dërgojë në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

d-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, të vendosen masa administrative për dënimin me gjobë deri në kallëzim penal.

Menjëherë

10. Gjetjet nga auditimi: Në Bashkinë Mat, kanë ushtruar aktivitet 16 subjekte të cilët nuk janë të regjistruar në QKR, duke sjellë mos arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifave vendore në vlerën 185,238 lekë, që përbëjnë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, veprime në papajtueshmëri me nenin 40 e 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Mat të marrë masa, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore duke kërkuar regjistrimin e 16 subjekteve në QKR dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e detyrimeve në vlerën 185,238 lekë, të cilët kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar.

Menjëherë

11. Gjetjet nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se kanë kryer aktivitet 7 (shtatë) subjekte private për “shfrytëzim fondi pyjor dhe kullor” dhe nuk kanë paguar detyrimet në shumën 2,947,905 lekë, e cila do të konsiderohet mungesë të ardhurash me efekt negativ. Konkretisht:

1. Subjekti “T. A. Sha (Ulëz)”, për kontratën e Qerasë nr.618 rep dhe nr. 44 kol, datë 04.09.2009, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullor publik në pronësi të ish-Komunës Ulëz për ndërtim të stacionit të antenave, nga ku ka rezultuar se nuk ka likuiduar detyrimet e vitit që ka lenë KLSH në shumën prej, gjithsej në vlerën **78,445 lekë**.

2. Subjekti “A. Sha (Ulëz)” për Kontratën e Qerasë nr ska, datë 19.12.2008, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullor publik në pronësi të ish-Komunës Ulëz për ndërtim të stacionit të antenave, nga ku ka rezultuar se nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2017-2018 në shumën prej, gjithsej në vlerën **560,000 lekë**.

3. Subjekti “A. Sha (Lis)” për Kontratën e Qerasë nr.3029 rep dhe nr.1024 kol, datë 07.09.2009, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullor publik në pronësi të ish-Komunës Lis, për ndërtim të stacionit të antenave, nga ku ka rezultuar se nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2018, në shumën prej, gjithsej në vlerën **170,000 lekë**.

4. Subjekti “K. I. Sha (Ulëz)” për Kontratën e Qerasë nr. ska, datë 05.08.2012, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullor publik në pronësi të ish-Komunës Ulëz për ndërtim të linjave të tensionit të lartë, nga ku ka rezultuar se nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2018-2019 në shumën prej, gjithsej në vlerën **300,000 lekë**.

5. Subjekti “V. A. Sha (Lis)” për Kontratën e Qerasë nr.1865 Prot, datë 23.07.2018, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullor publik në pronësi të ish-Komunës Lis për ndërtim të stacionit të antenave, nga ku ka rezultuar se nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2018 në shumën prej, gjithsej në vlerën **300,000 lekë**.

6. Subjekti “P. E. Shpk” për Kontratën e Qerasë nr. ska, datë 06.05.2013, 16.05.2013, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullor publik në pronësi të ish-Komunës Rukaj, për ndërtim hidrocentrali, nga ku ka rezultuar se subjekti “P. E. shpk” nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2018, në shumën prej, gjithsej në vlerën **830,500 lekë**.

7. Subjekti “S.G.-M. Shpk” për Kontratën e Qerasë nr.ska, datë 22.08.2014, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullor publik në pronësi të ish-Komunës Koms, për ndërtim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

hidrocentrali, nga ku ka rezultuar se subjekti “S.G.-M. “ shpk” nuk ka likuiduar detyrimet e vitin 2017, 2018, në shumën prej, gjithsej në vlerën **708,960 lekë** (*trajtuar më hollësisht në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktor ku kanë kryer aktivitet subjekte private për “shfrytëzim fondi pyjor dhe kullor ” dhe nuk kanë paguar detyrimet në shumën **2,947,905 lekë**.

Menjëherë

12. Gjetjet nga auditimi: Nga auditimi i vjeljes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimit e reja (të legalizuara) për vitet 2017-2018 është konstatuar se objektet ndërtimore të pajisura me leje legalizimi nga Drejtoria Rajonale ALUIZNI Mat, për të cilat është përlllogaritur taksa ndikimit në infrastrukturë nga DPTSHIP janë; 119 objekte banimi, 26 objekte social-ekonomike dhe 6 objekte të kombinuara.

Për vitin 2017, kanë rezultuar 46 shkresa për ndërtimet informale nga të cilat për vitin 2017 kanë paguar 27 persona në vlerën 858,170 lekë. Diferenca prej 19 personave janë njoftuar me shkresë zyrtare por nuk kanë bërë pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Për vitin 2018 kanë rezultuar 105 shkresa dhe është përlllogaritur taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi për ndërtimet informale nga të cilat kanë paguar 32 persona në vlerën 985,331 lekë. Diferenca prej 73 personave janë njoftuar me shkresë zyrtare por nuk kanë bërë pagesat e TNI, si dhe nuk ka përlllogaritje të vlerës së taksës.

Kjo taksë ka prioritet dhe ndikim të ulët në pasqyrat financiare pasi nuk është përfshirë në llogaritë debitore dhe nuk është pasqyruar në bilancin e viteve ushtrimore 2017 e 2018 (*trajtuar më hollësisht në faqet 39-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, nëpërmjet Drejtorisë së Urbanistikës dhe Zhvillimit të Territorit dhe Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore si dhe në bashkëpunim me ALUIZNI Mat dhe ZVRPP Mat të merren masa për zgjidhjen e situatës të krijuar duke ndjekur procedurat administrative-ligjore për evidentimin dhe saktësimin e vlerës së detyrimit dhe arkëtimin e taksës së infrastrukturës.

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: NJAB në ushtrimin dhe realizimin e funksionit të saj është bazuar në ligjin organik të AB, në MAB dhe në standardet e auditimit, por pavarësisht kësaj në auditimet e ushtruara nuk ka vlerësuar si duhet riskun në fushat e auditimit që janë me risk më të lartë si fusha e prokurimeve, planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, e planifikim-zhvillimit të territorit dhe e administrim-menaxhim i aseteve pronë e bashkisë për të cilat nuk janë zhvilluar auditime të thelluara. Gjithashtu nuk ka nxjerrje përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit, duke bërë që NJAB të mos e realizojë plotësisht misionin e saj për kryerjen e monitorimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Në të gjitha rastet, nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me UMF nr. 100, datë 25.10.2016, Kap. II, pika 10 (*trajtuar më hollësisht në faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mat dhe veçanërisht nga Titullari i Njësisë të Vetqeverisjes Vendore, të merren masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të bëjë planifikimin e angazhimeve të auditimit në bazë risku si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për cdo auditim.

Në vijimësi.

14. Gjetje nga auditimi: Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” pika 40, dhe ligjit nr.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

10296, datë 8.07.2010, neni 4 pika 19 dhe neni 16 pika 2. Në këtë Njësi të Qeverisjes Vendore, nuk aplikohen programe elektronike të licencuara lidhur me mbajtjen e kontabilitetit financiar. Nuk ka urdhër nga titullari i njësisë së qeverisjes vendore për të caktuar koordinatorin e riskut. Nuk ka akt të titullarit të njësisë për miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut për bashkinë Mat, veprim që bie në kundërshtim me nenin 21 pika 2, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, i ndryshuar.

Nuk rezulton asnjë akt tjetër nxjerr nga titullari i njësisë për përgatitjen dhe ndjekjen në vazhdimësi të manualit të proceseve të punës për njësinë vendore, për miratimin e gjurmëve të auditimit, veprim që bie në kundërshtim me nenin 16 pika 2, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, i ndryshuar.

Nga ana e titullarit të Bashkisë Mat, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit, por njësitë organizative kanë të përcaktuar detyrat e tyre në rregulloren e funksionimit të brendshëm të institucionit.

GMS, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, kërkesë e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr 8 dt. 29.3.2012 “Procedurat e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V *(trajtuar më hollësisht në faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

14.1. Rekomandim: Titullari i njësisë së qeverisjes vendore, ose nëpërmjet nëpunësit autorizues, të hartojë dhe miratojë akte të brendshme administrative të nevojshme për funksionimin normal të menaxhimit financiar dhe kontrollit, brenda kuadrit rregullator të Ministrisë së Financave, si dhe të monitorohet funksionimi i GMS në vazhdimësi.

Nga Grupi Menaxhimit Strategjik, të hartohet e miratohet Plani Strategjik në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr 8 dt. 29.3.2012 “Procedurat e përgatitjes të Buxhetit afatmesëm”, Kap. V.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Karta e Auditimit të NjAB nuk është përgatitur dhe miratuar tek titullari i Bashkisë Mat, në kundërshtim me nenin nr. 4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015, si dhe në kundërshtim me pikën 2.5, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm. *(trajtuar më hollësisht në faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

15.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, strukturat përgjegjëse, të hartohet “Karta e Auditit”, nga përgjegjësi i NjAB, dhe të miratohet ajo tek Kryetari i Bashkisë Mat.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Plani Strategjik edhe pse është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2017-2019, ai nuk është përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.1.6

Planifikimet vjetore të auditimeve për vitin 2017, dhe 2018 edhe pse janë përgatitur rregullisht, ata nuk janë përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në MAB, Kapitulli III, pika 3.2

Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2017 dhe 2018, dhe pasqyrat shoqëruese, janë dërguar në afat, por pjesa përshkruese e raportit nuk është përgatitur sipas standardeve që përcakton MAB, Kapitulli III, pika 3.6

Struktura e projektraportit dhe e raportit përfundimtar të auditimit nuk është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur nga MAB në Kapitullin IV, pika 4.1.12, Hapi 11 *(trajtuar më hollësisht në faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

16.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, Plani strategjik, planifikimi vjetor, raportimi vjetor, projekt raporti dhe raporti përfundimtar, si dhe gjithë dokumentacioni tjetër i nevojshëm në procesin auditues të NjAB, të përpilohen në përputhje me MAB.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nuk janë çelur dosjet e përhershme për çdo njësi publike të audituar, për ti shërbyer auditimit pasardhës, veprim që bie në kundërshtim me MAB, Kapitulli nr. VI, pika 6.3.

Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësive vendore, në kundërshtim me ligjin 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” (*trajtuar më hollësisht në faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Mat, NJAB të çelen dosjet e përhershme për çdo subjekt të audituar, duke i pasuruar ato me materiale nga auditimet e reja, me qëllim që kjo ti shërbej auditimeve pasardhëse të cilat do të realizohen në secilin subjekt (historiku i auditimeve).

Nga NjAB pas përfundimit të auditimit të brendshëm të subjekteve publike, të kryhet inventarizimi i dosjes koherente për çdo auditim, dhe të arkivohen ato në zyrë arkivin e bashkisë Mat, në përputhje me ligjin 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

Menjëherë dhe Vijmësi

18. Gjetje nga auditimi: nga auditimi i procedurave të emërimit të audituesve të NjAB është konstatuar se Z. L. Xh., me arsim të lartë, i diplomuar në Universitetin Bujqësor Tirane në vitin 1981, në degën “Ekonomist Kontabël”, është rekrutuar me Vendimin nr. 327, datë 01.06.2016, dhe është “komanduar” në detyrën e Audituesit pranë Sektorit të Auditit të Brendshëm, pa ju nënshtruar procesit të konkurrimit, dhe pas kësaj me Vendim të kryetarit të bashkisë nr. 576, datë 26.09.2016 është komanduar (transferuar përkohësisht) në detyrën e Përgjegjës të Njësive AB Bashkia Mat, pa qenë i pajisur me certifikatën e audituesit, (edhe aktualisht rezulton pa certifikatë), në kundërshtim me nenin 22, pika 1, të ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 i ndryshuar, si dhe duke mos respektuar nenin 48, pika 1, germën “a”, të po këtij ligji, si dhe në kundërshtim me pikën 3, paragrafi II, të VKM nr. 83, datë 03.02.2016.

Zj. F. Th., me arsim të lartë, diplomuar në Universitetin e Tiranës në vitin 1984, në specialitetin Financë, është emëruar në detyrën e audituesit të NJAB në bashkinë Mat me Vendim të kryetarit të bashkisë nr. 407, datë 06.07.2016, duke qenë e pajisur me certifikatën e audituesit, dhe brenda periudhës 2 vjeçare nuk është pajisur me të, veprim ky që bie në kundërshtim me nenin nr. 11, pika 2, germa “ç”, e Ligjit nr. 114/2015, “Për Auditin e Brendshëm Publik” (*trajtuar më hollësisht në faqet 28-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Mat dhe Përgjegjësi i Personelit, të merren masa për rekrutimin konform procedurave ligjore për auditin e brendshëm publik pranë NJAB të z. L. Xh., i caktuar përkohësisht me detyrën e Shefit të Sektorit të Auditit të Brendshëm dhe zj. F. Th. aktualisht me detyrën e audituesit në NjAB, pasi në emërimin e tyre nuk kanë ndjekur procedurat ligjore, në të kundërt të procedohet me largimin e tyre nga detyra e audituesve të NJQV-së.

Menjëherë

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e ankandit publik e zhvilluar me objekt “Shitje mjet transporti” me vlerë fillestare ankandi sipas gjendjes kontabile administruar në llog.(215) “Mjete transporti” në shumën 105,360 lekë e cila përbën vlerën e kontratës së lidhur dhe likuiduar pas dorëzimit të mjetit tipi (ZIS); viti prodhimit (1978), targa (MT1120A), pa plotësuar kërkesat e përlllogaritjes së vlerës fillestare të hapjes së ankandit me diferencë shuma 127,800 lekë pa tvsh,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

për pasojë kontrata me fituesin e ankandit publik, në mospërputhje me neni 16, ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandit Publik”, Kreu (II) “Rregullat e përgjithshme të ankandit”; pika 2.1; 2.2/1 të VKM nr.1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik” i ndyshuar me VKM Nr. 308 datë 10.04.2013, gërma (c) dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu (IV) “Sistemi kontrollit periodik aktiveve”, pika 104 “Procesverbali vlerësimit”, gërmat (a); (b); (c), përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të njësisë publike Bashkia Mat (trajtuar më hollësisht në faqet 33-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Titullari i Njësisë publike bashkia Mat të analizojë vlerën **127,800 lekë pa tvsh e cila përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të njësisë publike bashkia Mat**, si rezultat i mos llogaritjes së vlerës fillestare të hapjes së ankandit në lidhje me realizimin e kontratës për shitjen e mjetit tipi (ZIS) me targa (MT1120A), dorëzuar fituesit të ankandit pa përlllogaritur vlerë fillestare të hapjes së ankandit.

Menjëherë.

2. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e pakësimit të aktiveve me vlerë gjendja kontabile e administruar në llog.(215) “Mjete transporti” në shumën **1,286,000 lekë** ndërsa procedura e nxjerrjes jashtë përdorimi dhe pakësimi aktivitet me këtë dokumentacion justifikues, ndërkohë që komisioni ka pasqyruar mungesën në inventarizimin fizik të aktivitet, nuk ka sistemuar diferencën, por ka marr në konsideratë dokumentat justifikuese të pa argumentuara që i përkasin njësisë publike (ish/Komuna Derjan), të cilat i përkasin periudhës përpara konsolidimit të pasqyrave financiare deri në datën 30.07.2015 dhe për faktin tjetër se ky aktiv “mjet transporti” nuk pasqyron vlerë kontabile, apo vlerësim me komision për “mjeti transportit, targa MT2548A; tipi autoveturë; marka Mitsubishi; nr.shasi (JMBONV440MJ304101)” pa përlllogaritur vlerën e mjetit i shkarkuar nga kartela e llogarisë, në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu (IV) “Sistemi kontrollit periodik aktiveve”, pika 104 “Procesverbali vlerësimit”, gërmat (a); (b); (c), përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të njësisë publike bashkia Mat. (trajtuar më hollësisht në faqet 33-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Titullari i Njësisë publike bashkia Mat të analizojë vlerën **1,286,000 lekë pa tvsh e cila përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të njësisë publike bashkia Mat**, në lidhje me pakësimin e aktivitet “mjet transporti, targa MT2548A; tipi autoveturë; marka Mitsubishi; nr.shasi JMBONV440MJ304101” nëpërmjet dokumentave justifikuese të pa argumentuara që i përkasin njësisë publike (ish/Komuna Derjan), dokumenta të cilat i përkasin periudhës përpara konsolidimit të pasqyrave financiare deri në datën 30.07.2015.

Menjëherë.

3. Gjetje nga auditimi: Bazuar në likuidimin e faturave me analizë në të cilën është përfshirë dhe (OSHEE) konstatohet se, njësia publike bashkia Mat për periudhën raportuese (2017-2018), megjithëse ka likuiduar “OSHEE”sha faturat e konsumit të energjisë elektrike, për ndriçim rrugor të qytetit dhe njësit administrative, ku përveç vlerës së energjisë elektrike të konsumuar sipas aparatit matës dhe kushteve të kontratës, për çdo muaj është likuiduar edhe vlera prej **100 lekë/muaj**, si tarifë shërbimi për përdorim të aparatit televiziv për 9 kontrata në vlerën totale **20,500 lekë**, ndërkohë që ndriçimi rrugor nuk ka të instaluar aparate televiziv, shpenzimi i cili përbën **efekt negativ financiar për buxheti njësisë publike bashkia Mat**, në mospërputhje me pika 8, shkronja “b”, pika 9, Udhëzimi i përbashkët nr.29, datë 18.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv” (trajtuar më hollësisht në faqet 33-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

3.1. Rekomandimi: Njësia publike Bashkia Mat, Sektori Financës të marrë masa për ndërprerje të faturimit të tarifës së shërbimit për përdorimin e aparatit televiziv në kontratatat të cilat përjashtohen nga pagimi kësaj tarife, në përputhje me Udhëzimin e përbashkët nr.29, datë 18.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televiziv”. Për këtë brenda datës 15 janar të çdo periudhë raportuese dhe në vazhdim për gjatë vitit, njësia vendore ti përcjell “OSHEE”sha të gjitha kontratat për kategorit që përjashtohet nga pagimi i tarifës së shërbimit për përdorimin e aparatit televiziv, si dhe të kërkoj nga OSHEE vlerën e faturimit për 9-të kontrata për shumën prej 20,500 lekë, sipas shtojcës nr.1 bashkëlidhur me Udhëzimin e mësipërm.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “**Rikonstrukcion Shkolla 31 Korriku Burrel**”, me fond limit prej **61,819,333 lekë**, me BOE të shpallur fitues “**V. N. I.S. dhe “N shpk**”, për vlerën prej 61,580,780 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 238,500 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE dhe 1 BOE është shpallur fituese BOE e cila nuk plotësonte kriteret e veçantë, konkretisht pikën 5.3 të DST pasi nga dy teknikë ndërtimi vetëm njëri ka certifikatë të IQT dhe nga tre manovratëorë asnjëri nuk ka certifikatë të IQT; pikën 5.5 pasi nga 4 elektrikistë 2 nuk kanë certifikatë nga IQT, po ashtu nga 4 hidraulikë dy janë pa certifikatë nga IQT, dy saldatorët janë pa certifikatë nga IQT, një karpentier dhe 4 specialistë janë po ashtu pa certifikatë nga IQT; pikën 8.3 pasi nuk ka paraqitur certifikatën e normativitetit EN 13830:2003; pikën 9.3 për certifikatën EN 605981:2008+A11:2009, pasi rezulton në gjuhën franceze dhe e pa përkthyer si dhe me vulë të palexueshme noterimi; pikën 10.3 dhe 10.4 lidhur me plotësimin e dokumentit për kaldajën, direktiva 97/23/EC, si dhe për servisin e autorizuar, pasi dokumentet janë në gjuhën angleze, gjermane dhe turke, të pa përkthyer; pikën 12.4 nga ku rezulton se ka paraqitur kontratë për prova laboratorike dhe dokumente teknike në gjuhën italiane, të pa përkthyer; pikën 6 të DST lidhur me numrin e fuqisë punëtore për vitin 2014, 70, vitin 2015 90 dhe vitin 2016, 11, si dhe janar-qershor 2017 110 punonjës, pasi për vitet 2014-2016, asnjëri nga bashkimi i operatorëve nuk plotëson këtë kriter , por vetëm të bashkuar, kur kriter synon bashkimin e kapaciteteve dhe eksperiencave në punë dhe nuk mund të konsiderohet bashkimi i kapaciteteve njerëzore për vitet e shkuara, por vetëm për vitin 2017.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE “**V. N. I.S. dhe “N shpk**”, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën **61,580,780 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshua (*trajtuar më hollësisht në faqet 46-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **61,580,780 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “**Shërbimi i Patrimit në Bashkinë Mat**”, për 5 vjet dhe për vlerën prej **73,385,319 lekë**, me OE të shpallur fitues “**I. C.**” shpk, për vlerën prej 71,400,669 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 1.984,620 lekë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, konkretisht pikën 3 të DST pasi nuk ka paraqitur asnjë kontratë punësimi për inxhinier kimist; pikën 4 të DST pasi nuk ka paraqitur asnjë kontratë të vlefshme pune për mjekun e përgjithshëm; pikën 9 të DST pasi nuk ka paraqitur certifikatë ISO 50001:2012, pikën 10 të DST pasi nuk ka paraqitur certifikatën ISO 3834-2:2015; pikën 13/4 lidhur me mjetin teknologjik për pastrimin e rrugëve, pasi nga dokumenti fotografik mjetit i mungon fshesa qendrore rul; si dhe pikën 15 pasai nuk ka paraqitur dokumentacion mbi disponueshmërinë e 100 kontenierëve Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE “I.C.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën **71,400,669 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshua. (trajtuar më hollësisht në faqet 46-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **71,400,669 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Rehabilitimi i veprave të marrjes të kanalit ujitës batër e madhe*”, për vlerën prej **7,025,000 lekë**, me BOE të shpallur fitues “R. & F.” shpk, për vlerën prej 5,995,984 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 1.069,016 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 1 BOE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, konkretisht pikën 2.3.2 të DST pasi nuk ka paraqitur asnjë punonjës me dëshmi kualifikimi të lëshuar nga IQT; pikën 2.3.5 të DST, pasi nuk ka paraqitur mjetin fadromë me goma, eskavator i kukuar me çekiç pneumatik rezulton pa një të tillë, për 2 kamionat përveç lejeve të qarkullimit mungojnë dokumentet e tjera provuese; për dy autobetoniere është paraqitur kontratë qirajë për mjete të targuara në shtetin e Kosovës, por u mungon vula apostile.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE “R. & F.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën **5,995,984 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshua (trajtuar më hollësisht në faqet 46-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **5,995,984 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Mirëmbajtje kanale vaditëse*”, për vlerën prej **4,056,545 lekë**, me OE të shpallur fitues “N” shpk, për vlerën prej 3,898,480 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 158,065 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

marrë pjesë 1 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, konkretisht pikën 2.3 të DST pasi të dy inxhinierët nuk kanë dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik; pikën 4 të DST, pasi dy kamionat e paraqitur e kanë kapacitetin mbi 15 ton kur janë kërkuar deri në 15. Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE “N” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën **3,898,480 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshua (*trajtuar më hollësisht në faqet 46-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **3,898,480**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Punime rrugore Lagjia Drita*”, për vlerën prej **13,190,233 lekë**, me OE të shpallur fitues “E.” shpk, për vlerën prej 13,098,531 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 91,702 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 2 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, konkretisht pikën 4.4 të DST, pasi automakinistit i ka skaduar dëshmia e aftësisë profesionale; pikën 7 të DST pasi nuk është paraqitur një eskavator me zinxhirë nga dy të kërkuar, si dhe se kamioni me targa AA417IS i ka skaduar certifikata për transport mallrash si dhe polica e sigurimit.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE “E.” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën **13,098,531 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshua (*trajtuar më hollësisht në faqet 46-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **13,098,531 lekë**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: “*Ujësjellësi i fshatit German*”, për vlerën prej **8,956,950 lekë**, me OE të shpallur fitues “N” shpk, për vlerën prej 8,834,175 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën 122,775 lekë, procedurë në të cilën ka rezultuar se kanë marrë pjesë 1 OE, është shpallur fituese OE i cili nuk plotësonte kriteret e veçantë, konkretisht pikën 2.3.11 të DST, pasi ka dorëzuar dokumentacionin për PE 100 RC HDP, në gjuhë të huaj dhe të papërkthyer.

Mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e OE “N” shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DST ka shkaktuar përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, në vlerën **8,834,175 lekë**, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshua (*trajtuar më hollësisht në faqet 46-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën **13,098,531** lekë, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i Njësisë Publike Bashkia Mat, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,357,981** lekë, si më poshtë:*

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës, i dokumentacionit të administruar në dosjen teknike me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Z. N. R. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V.N. I.S” & “N” Shpk përfaqësuar nga Z. A. Ç. administrator i OE “V.N.” shpk dhe nga Z. Xh. N administrator i OE “N” Shpk, u konstatua se: Për zërin “Furnizim dhe instalim kaldajë për ngrohje me ujë me lëndë djegëse peletkomplet me instrumentat matës dhe të kontrollit të parametrave të ujit të ngrohtë, Q niminale 250,000 kilokalori/orë, përfshirë montimin e të gjithë tubacioneve dhe pajisjeve deri në dalje nga dhoma e djegjes” është llogaritur me TVSH, duke i konsideruar punime ndërtimi punimet e furnizimit dhe instalimit të pajisjeve dhe për pasojë, janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve në vlerën **480,000** lekë si rrjedhojë e përfshirjes së TVSH-së së pajisjeve në situacionin e punimeve për kontratën bazë, vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me UKM Nr. 2, datë 08.05.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I, me UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit dhe me VKM Nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8.

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit u konstatua se zëri i punimeve “(3.620) Shtresë pllaka betoni C 16/20 t=6 cm, oborri” është likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **350,496** lekë pa TVSH duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqet 119-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Mat, që t’i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V.N. I.S” & “N” Shpk përfaqësuar nga Z. A. Ç. administrator i OE “V. N.” shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **480,000 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër si rrjedhojë e përfshirjes së TVSH-së së pajisjeve në situacionin e punimeve për kontratën me objekt **“Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku”**.

Të merren masa nga Bashkia Mat, që t’i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V. N. I.S” & “N” Shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **350,496 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 31 Korriku”.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës Derjan”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Z. N. R. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V. N. I.S & N” Shpk përfaqësuar nga Z. A. Ç. administrator i OE “V.N.” Shpk u konstatua se zërat e punimeve: “7(2.278) Shtresë zhavorri nën kanal t = 10 cm” dhe “Punime në kalimin këmbësorësh Hd = 2 m B = 2 m” janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **315,525 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqet 119-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Mat, që t’i kërkojë Bashkimit të Operatorëve Ekonomik “V.N. I.S” & “N” Shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **315,525 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksioni i Kanalit Ujitës Derjan”.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit sipas kontratës me objekt: “Rikonstruksion “Lagjia Drita”, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mat, përfaqësuar nga Z. N. R. dhe Operatorit Ekonomik “E.” Shpk përfaqësuar nga Z. R. D., u konstatua se zërat e punimeve: “Beton C 16/20 për fiksion bordure”, “Bordurë betoni C 16/20 20x35 cm” janë likuiduar për punime të pakryera dhe diferenca në volume në shumën **211,960 lekë pa TVSH** duke shkaktuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit. Sa më sipër nuk është në përputhshmëri me paragrafin e tretë të nenit 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqet 119-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Mat, që t’i kërkojë Operatorit Ekonomik “E.” Shpk përfaqësuar nga Z. R. D., duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **211,960 lekë pa TVSH**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion “Lagjia Drita”.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i kanalit vaditës, fshati Derjan (i pjesshëm)”**, për vlerën prej **16,666,666 lekë**, me BOE të shpallur fitues **“V.N. I.S. dhe “N” Shpk**, për vlerën prej 16,458,763 lekë, ose më pak se fondi limit për shumën



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar Auditimi për Auditimin e ushtruar në NJQV “BashkiaMat”

207,903 lekë, procedurë në të cilën kanë marrë pjesë 4 OE dhe 2 BOE është s’kualifikuar me të drejtë për mungesë dokumentacioni OE me ofertë ekonomike më të ulët “Be-Is” shpk, për vlerën prej 12,515,490 lekë dhe është kualifikuar BOE që nuk plotëson po të njëjtin kriter si dhe OE i skualifikuar: Pika 2.3.3, për numrin mesatar të punonjësve prej 75 nga janar 2014 deri më shkurt 2017. Po ashtu kur BOE i shpallur fitues nuk plotëson as kriteret 2.3.2/3, pasi certifikata ISO 1452-1:2009 është e papërkthyer në gjyhën shqipe; Pika 2.3.4, lidhur me mjekun e përgjithshëm pasi mjeku i paraqitur ka leje individuale për ushtrim profesioni me datë të paverifikueshme duke mos vërtetuar afatin e fillimit dhe mbarimit të saj; Pika 2.3.4, lidhur me inxhinierin e ndërtimit i cili rezulton me dëshmi të sigurimit teknik jashtë afatit të vleshmërisë ndërsa për inxhinierët e tjerë u mungon dëshmia e sigurimit; Pika 12.3.8, lidhur me makinerinë për shtrim betoni, pasi nuk rezulton të ketë paraqitur një pajisje të tillë; si dhe pikën 2.3.3 pasi nuk plotëson numrin mesatar të punonjësve (75) Në këto kushte, KVO duhet ta kishte s’kualifikuar këtë operator ekonomik dhe duhet të kishte shpallur fitues OE “B.-I.” shpk

Mos shpallje fitues i OE me ofertë më të ulët apo edhe mos anulimi i procedurës dhe shpallja fitues e BOE “V.N. I.S. dhe “N” Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen Standarde të Tenderit, si dhe nga s’kualifikimi i OE “**B.-I.**” Shpk, me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën **13,715,229 lekë**, duke shkaktuar keqpërdorim të fondeve publike me dëm ekonomik në vlerën **2,743,534 lekë** (diferencë ndërmjet ofertës fituese dhe asaj të s’kualifikuar), veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën C, faqet 55-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mat, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **2,743,534 lekë**, ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, **“Rikonstruksion i kanalit vaditës, fshati Derjan (i pjesshëm)”**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike, ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve, të cilat nuk çënojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT